

Pjesa e dytë: Alternativa materialiste e qasjes historiko-letrare në veprën “Një pasqyrë e Shqipërisë letrare 1945-1961”

## Për një poetikë krahasimtare në studimet shqipe: PERSPEKTIVA HISTORIKO-LETRARE E ALI XHIKUT

Nga Blerina Suta

Ikconceptuar në tri blloqe të rëndësishme, ky vëllim i Ali Xhikut, botuar nga Akademia e Shkencave (Tiranë 2022), i qaset instalimit të realizmit socialist në tri këndvështrime: së pari si një rindërtim kronologjik dhe i problematizuar i sektorëve skajshmërisht të polarizuar të raportit letërsi-ideologji; së dyti, si një trajtim i çështjeve më të përgjithshme teorike me të cilat u mor mendimi letrar shqiptar; dhe së fundmi, si historishkrim në formën e një boce historiko-letrare të zhvillimit të gjinive në këtë periudhë.

### SHËNIME MBI LIBRAT

Parathënie për “Dëshmi dhe kujtesë” të ish gazetarit të VOA, Astrit Lulushi

#### SHKO NË PERËNDIM, RRITU DHE PROVO...

Nga Faruk Myrtaj (fq. 7)

Romani “Liria ime” i Mehmet Krajës  
NJË RRËFIM TRONDITËS PËR  
NJERËZ TË PALUMTUR

Nga Albana Beqiri (fq. 4)

Romani “Dëmtuar gjatë rrugës”, në arabisht  
BESNIK MUSTAJ, NJË  
SHQIPTAR QË E NJOHIM  
DHE NA NJEH

Nga Mahmoud Atef (fq. 6)

Poezia “Gjethi pagan”, e Niko Kacalidhës  
DISKURS MBI STRUKTURËN  
E NJË TEKSTI POETIK

Nga Vangjush Ziko (fq. 5)

“KËPUCA E AKTORIT”  
SHKON NË DALLAS, SHBA

Mozaik nga takimi  
i shkrimtarit Visar Zhiti (fq. 10)



Libri i prof.dr. Vaso Toles u promovua në Teatrin e Operas dhe Baletit

## Kompozitori Bojan Adamiç në Shqipëri

Nga Arian Leka

Botimi i këtij libri hapi një portë në studimet ndërkulturore ndaj, duke ndjekur metaforën e portës, bëhemi të vetëdijshëm edhe për pamundësinë e përfshirjes së gjithçkaje përmes saj. Vetë autori ka identifikuar zona të tilla studimi, si periudha e veprimtarisë së Adamiçit në Kosovë, mundësia e ekzistencës së veprave të tjera me temë a motive shqiptare, thellime rreth historikut të mbërritjes dhe ngulitjes së termave muzikore që konkuruan mes tyre asokohe...

(fq. 12)


### BILL KLINTON:

Besoj se “Njëqind vjet vetmi” është romani më i madh i shkruar që nga vdekja e Uiljam Folknerit

Përktheu Granit Zela (fq. 21)

### VETMIA E FJALËVE: NË MBROJTJE TË ROMANIT POSTUM TË G.G. MARQUEZ

Nga Gustavo Arango



Romani i panjohur i Markezit do të botohet në të gjithë botën, në të njëjtën ditë: 6 mars 2024

### BIBLIOTEKË

Xhelal Tosku (fq. 18)

Ah, pikëllimet e mia prej hëne

Namik Dokle (fq. 16)

Dy legjenda

Pablo Neruda (fq. 20)

Sonetet e dashurisë,  
përkthyer nga Roland Gjoza

Esmeralda Shpata (fq. 19)

Nuk e di

Preng Maca (fq. 17)

Dashuria është një lojë

Fragmente nga një intervistë e gjatë me  
kinooperatorin Faruk Basha

### KUJTIM SPAHIVOGLI FIGURË SA MADHËSHTORE, AQ EDHE TRAGJIKE

Nga Enver S. Morina (fq. 8)

FARUK BASHA: Në një shesh xhirimi, për herë të parë, jam ndodhur kur po realizohej filmi “Skënderbeu”. Isha rreth 12 vjeç. Nga ai çast nuk iu ndava më sheshxhirimeve kur kishte plane që bëheshin në Tiranë apo rrethinat e saj...

### VETA PROMETEIKE ESKILIANE

Nga Skënder Karriqi (fq. 15)

Ikonceptuar në tri blloqe të Irëndësishme, ky vëllim i Ali Xhikut, botuar nga Akademia e Shkencave (Tiranë 2022), i qaset instalimit të realizmit socialist në tri këndvështrime: së pari si një rindërtim kronologjik dhe i problematizuar i sektorëve skajshmërisht të polarizuar të raportit letërsi-ideologji; së dyti, si një trajtim i çështjeve më të përgjithshme teorike me të cilat u mor mendimi letrar shqiptar; dhe së fundmi, si historishkrim në formën e një boce historiko-letrare të zhvillimit të gjinive në këtë periudhë.

Duke ndjekur hullinë e metodologjisë kritiko-materialiste të konsoliduar edhe në sprovat e mëparshme, autori përvijon transformimin që “realizmi socialist” -jo rrymë, por “metodë”- (kategori e turbullt lidhur me “parapëlqime intuitive”), i bëri prodhimin letrar në Shqipërinë e pasluftës, si në pikëpamje të ‘vizionit’ mbi botën, të “rrafshët dhe të thjeshtëzuar”, ashtu dhe në pikëpamje të zhvillimit gjinor, krahasuar me trashëgiminë e viteve 1930.

I bindur se analiza e “ndryshimit të mënyrave të jetësimit të një gjinie të dhënë” është rruga e duhur e historianit për të mënjanuar “trysnitë e politikës dhe të shijeve të kohës së tij”, Ali Xhiku ka dëshmuar distancën e duhur emocionale nga epoka relativisht e afërt, për të rindërtuar hap pas hapi, me mjetet e kritikës historiko-letrare, faktin e imponimit të një metode “letrare” që do t’i shërbente “pushtetit politik”. (f. 111).

Nuk mungojnë në këtë histori letërsie deklaratat metakritike për metodën e historishkrimit, që duhet të synojë domethënien e tekstit, si përgjigje ndaj prirjes bashkëkohore të lulëzimit të pamjeve strukturaliste, të papranueshëm kur vëzhgimet mbi stilin e poetit “kujtojnë se mund të abstragojnë dhe kthejnë në skema teknikat e krijimit të së bukurës, duke kaluar shpejt dhe pa vëmendjen e duhur mbi fluksin e mendimeve dhe të ndjesive të tij [...\*]” (f. 171).

Ky pohim shkon në të njëjtin rrafsh me parimin se historia e letërsisë mund të shkruhet duke u nisur vetëm nga një parim bazik pune që shkon nga “lënda” të “përfundimi”, përdorur në metodën krahasimtare të veprës *Sprovë për një tjetër histori të letërsisë shqipe (1555-1944)*.

I ndërgjegjshëm që një studim i tillë mund të marrë domethënie vetëm në formën e një “grykimi kritik”, autori zbulon haptazi dhe me vetëdije intelektuale, qysh në parathënie, sfidën dhe natyrën delikate të studimit të një epoke, që përcjell konflikt të fortë dhe ndjeshmëri në një vend si Shqipëria ku motivet politike “për të jetësuar një doktrinë, refuzonin prerazi çdo pikëpamje dhe çdo krijimtari tjetër” dhe imponoheshin si i vetmi qëndrim “vërtet shkencor”.

**Rrafshi dokumentar** dhe sistematizues i këtij vëllimi, sendërton hap pas hapi itinerarin e instalimit të realizmit socialist në Shqipëri.

Njohja e lexuesit të sotëm me

# Për një poetikë krahasimtare në studimet shqipe: perspektiva historiko-letrare e Ali Xhikut.

**Pjesa e dytë: Alternativa materialiste e qasjes historiko-letrare në veprën “Një pasqyrë e Shqipërisë letrare 1945-1961”**

*Nga Blerina Suta*

përmasën që mori ashpërsia e censurës në raport me ndikimin që mund të kishin pasur “izmat” e letërsisë perëndimore tek autorët, qasje në thelb e ndryshme me atë të etërve të marksizmit- është një operacion i vazhdueshëm në këtë “pasqyrë” dhe njëherësh i nevojshëm.

Imitimi i prurjeve teorike të shkollës ruse, përndiqet nga Xhiku në radhë të parë në rrafsh të ‘gjuhës’ kritike, që shoqëroi vendosjen e metodës së

realizmit socialist, semantika e të cilës zhvendoset nga kategoritë burimore marksiste (të Marksit edhe Engelsit) drejt skajeve ideologjike të modelit sovjetik, i cili i “mekanizon hapur” ato.

Evidentimi në mënyrë të saktë i 1947, viti kur u përdor termi “realizëm socialist”, i përkthyer prej termit rus si tregues i “një letërsie tjetër” (f. 37), shoqërohet me përshtetimin e tjetërsimit në përdorim të termit “romantizëm” apo “letërsi klasike universale”, në funksion të një “letërsie



të standardizuar” e cila për Xhikun, “dëshmon qartë me vepra patetiko-entuziaste [...] dëmin që i bëhet cilësisë artistike të veprave”. (f. 44).

Materiali i pasur që shoqëron këtë historik, përfshin forumet dhe kongreset partiake, të cilat shoqëroheshin nga forume paralele dhe ndihmëse të organeve të krijuara për shkrimtarët.


Përdorimi i sloganeve të njohura të barazisë dhe lirisë, për të justifikuar instalimin e diktaturës së proletarietit, i ndryshuan kahje parimeve të realizmit dhe të vërtetës në art, duke mos qenë më në shërbim të natyrës së veçantë të artit.

Idetë e Hegelit për të bukurën në art, receptimi i tyre prej Engelesit, nuk penguan krerët e qeverisë të nisur prej pragmatizmit të “cenonin prirjen e natyrshme të letërsisë për t’u shfaqur dhe për të ekzistuar si realitet i së bukurës”. (f. 115).

Vendimet e Konferencës së III-të të Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, (1950), ku theksohet se “në qoftë se me gjithë përpjekjen t’onë, s’do mund të kuptojnë dhe, nënë këtë maskë, do përpiqen të pengojnë udhën t’onë, të jenë të sigurt se puna ose lufta jonë do t’i eliminojë”, (f. 28), shpërfaqin para lexuesit të sotëm përmasën e vërtetë të egërsisë që do të marrë pushteti, “shprehje të luftës së klasave”.

Lidhja e shkrimtarëve, nga një organizatë gjithëpërfshirëse e autorëve më të mirë do shndërrohet në një organizatë vegël e pushtetit të Partisë, me përjashtimin nga radhët e saj të figurave të demokratëve progresistë, si: V. Prennushi, E Haxhiademi, Dh Pasko.

Përshtetimi i klimës dyshuese, apo “kundërshtuese” ndaj pikëpamjeve partiake për letërsinë, duke iu referuar fatit të K. Trebeshinës, M. Ndojës dhe M. Myftiut, sqarojnë përfundimisht se ky i ashtuquajtur “grup i vogël”, i vënë në shënjestër të censurës dhe të organeve kontrolluese të partisë, nuk botoi asgjë nga pikëpamjet e tij (që me gjasë mund të gjendet në formë epistolaresh), duke mos mbërritur, në



fakt, të jenë disidentë në kuptimin e vërtetë të kësaj fjale.

**Rrafshi teoriko-estetik** i kategorive të prekura nga metoda e realizmit socialist përfshijnë të vërtetën dhe të bukurën në art, kanonin e së shkuarës, përdorimin në funksion të ideologjisë të gjinive letrare, poezisë, prozës, romanit dhe dramës, deri te përdorimi i metrit të vargut të lirë si poetikë.

“Vullneti jashtëletrar” dhe “thjeshtëzimi i së bukurës”, janë dy çështje që plotësojnë njëra-tjetrën nga pikëpamja e evoluimit historik dhe teorik të mendimit letrar shqiptar ndër vitet 1945-1961, kur u ndalua dhe në mënyrë të pandërgjegjshme çdo prodhim tjetër letrar që nuk ndiqte normat e realizmit socialist.

Së pari, raporti me traditën në Shqipëri u thjeshtëzua dhe krejt ndryshe nga koncepti leninist i dy kulturave (në vlerësimin që Lenini i bëri veprës së Tolstoit, përfaqësues i shtresës fisnike), marrëdhëniet midis trashëgimisë dhe letërsisë së paskëtaime u bënë “krejt politike”.

Ndonëse e sipërfaqshme, rindërtohet panorama letrare para viteve '44, me aftësinë e saj receptuese të modeleve dhe llojeve letrare (ndonëse shpesh me “ndjesi gjysmë të pavetëdijshme e të pavërejtura më parë”), të poezisë subjektive, të prozës që shfaqte në pak kohë tipare të lexueshme kompozicionale dhe modele gjinore nga më të ndryshmet.

Tradita letrare me autorë si Fishta e Konica, të vlerësuar deri në vitin 1945, filluan të përmbysen në '46, siç shënon një kronikë e “Botës së Re”, 1946, që i quan ata “tradhtarë”.

**Poezia lirike** shfaqet si më dinamika në këtë panoramë. Kur studiuesi Xhiku, veç përfundimit, jo të lodhshëm sipas tij, “për të provuar se poezia shqipe e asaj kohe ishte gati-gati një kantatë patetike të rinjsh të ekzaltuar”, hyn në specifika nënlojore të realizimit të saj, siç bëhet fjalë për parapëlqimin e metodës për poezinë rrëfyese (poemat epiko-lirike e baladat), ai, jo vetëm specifikon zhvillimin gjinor në funksion të receptimit evokativ të ndjesive të luftës, por përgatit edhe thyerjen e këtij modeli që do prodhohet në kushtet e burgut dhe internimit.

Braktisja e nivelit të poezisë lirike të traditës (Naimi, Lasgushi, Migjeni) e largoi në mënyrë të pariparueshme poezinë shqipe prej ‘unit’ subjektiv, duke krijuar një lirike “të pazakontë” të kolektivitetit, të ekzaltimit të përdorimit të shumës, me fjalor të ngushtuar e figura si: apostrofi, simboli, hiperbola - shënjeshtë e ideologjisë dhe moralit që po luftonte për një betejë tashmë të nisur.

Rasti i vargut të lirë, është rasti më ekstrem i atyre që Xhiku quan “paradigma të ideokracisë”: pamja politike e përqasjes midis vargjeve, pavarësisht shembullit të Majakovskit apo Migjenit, tregon qartë sa larg kishte shkuar paranoja e partisë në pushtet, në emër të frikës nga



“kozmpolitizmi që po kërcënonte thelbin kombëtar të poezisë shqipe.” (f. 93)

Interesante për brezat e rinj të lexuesve dhe studiuesve bëhet përfytyrimi i një realiteti, ku lirika e dashurisë i kishte lënë vendin një poezie të “ngjitur” aq shumë pas politikës së ditës, sa u kujtua vetëm pas 8-9 vjetësh se që “mashkullorizuar” ca si tepër (f. 138): u desh të vijë vitet '60 që poezisë shqipe t'i kthehet motivi i dashurisë me Kadarenë e të tjerë, vite që njohën gjithashtu edhe lirikën e unit meditativ.

Përshkrimi gjithashtu i dinamikës së debatit letrar të iniciuar nga politika për të disiplinuar

konfliktin mes të vjetërve dhe të rinjve, na sjell pamje mjaft interesante të rrugës se si letërsia shqipe, pavarësisht diktaturës, gjeti drejtimin e pakthyeshmë të shtratit të saj të natyrshëm, duke shfrytëzuar traditën migjeniane dhe modelin e Majakovskit (Kadare, Arapi, Agolli, Dh. Qiriazi), si dhe duke kultivuar figura të mendimit, si metafora, format moderne të poemës së thellë në mendim.

Rasti i poezisë shqipe është i rëndësishëm për të dëshmuar sesi fosilizimi dhe në funksion të vetë ideologjisë së partisë solli lindjen fill pas kësaj, të një letërsie që nuk i qëndronte raportit vasal letërsi-ideologji, tregues i vitalitetit të procesit letrar dhe gjallimit të saj jashtë grilave të natyrës jashtëletrare.

**Proza e shkurtër ashtu si ajo e gjatë** u sakrifikuara, pavarësisht ndonjë fenomeni të veçantë, siç ishte proza moderne e Petro Markos.

Objekt i rëndësishëm i arsyetimit të Xhikut për gjininë rrëfimtare është kategoria krijuese e heroit ideal, “tipikes” në letërsi, kategori mjaft e debatuar dhe në kritikën letrare post-

komuniste në Europë, si faktor që ngjyros tiparin letrar të veprës.

Kalimi nga letërsia e angazhuar në letërsi politike do të përfshijë, në radhë të parë, *personazhin*, të krijuar sipas një modeli moral e antropologjik të heroit të ri, model që synonte njësim të realitetit jashtë veprës me realitetin brenda saj, me pasojë dhunimin e natyrës së “veçanësishme” të veprës.

Duke ndërhyrë në specifikën e letërsisë, *vërtetësia* (besueshmëria) e personazhit, siç dihet në përputhje me gjasën dhe nevojën brenda veprës, do të kërkohet jashtë saj, dhe specifikisht ‘tipi’ do të gjendet te sasia e shfaqjes së një tipari, duke dëmtuar rëndë fantazinë e shkrimtarit.

**Pamundësia e dramës** për të ngritur kokë për shkak të ndërhyrjeve arbitrare, mbyllin panoramën e pasqyrës letrare shqiptare në vitet '45-'61, me përfundimin e rëndësishëm se në ato vite në Shqipëri ka munguar debati letrar publik, duke ftuar studiuesit të hulumtojnë arkivave të censurës (së shtëpive botuese dhe organeve partiake të kontrollit) për të kuptuar realisht panoramën e prodhimit letrar në atë periudhë, fenomen, jo vetëm shqiptar.

**Perspektiva e gjykimit kritik të historishkrimit**, tipar kryesor i kësaj vepre, është dhe veçantia që transmeton ajo në raport me vepra të tjera të vlefshme për instalimin e realizmit socialist, të botuara në këto vitet e fundit.

Autori dëshmon aftësi analitike të thella të historisë kulturore të Shqipërisë moderne dhe të shtresave të psikologjisë kolektive kur pranon se “ardhja e realizmit socialist ishte një proces jo fort i vështirë” për Shqipërinë, e cila pranoi menjëherë të kontrollohej nga diktatura e proletariatit.

Rasti i Shqipërisë, unik, jashtë çdo modeli, rezulton si goditje in extremis e “letërsisë si vetëqenie” prej “kontrollit dhe direktivave partiake me udhëzime, orientime e vendime të posaçme” të zhdanovizmit.

Ndryshe nga ç’ndodhi me letërsinë ruse, të cilës iu deshën 20 vjet ose me atë jugosllave, që e shmangi zhdanovizmin brenda pak kohësh, koncept leninist i diktaturës së proletariatit si “autoritet i papenguar nga ligjet, absolutisht i pakufizuar nga çfarëdo rregulloreje dhe i mbështetur drejtpërdrejt në forcë” (Lenin, *Shteti dhe Revolucioni*, 1917), u pranua pa filtra dhe mëdyshje të shumta në realitetin shqiptar; së dyti, sërish, vetëm shqiptar është fenomeni i “kohëzgjatjes së madhe të ndikimit shtetëror mbi letërsinë”.

Mungesa e disidencës në Shqipëri, ofron në këtë pikëvështrim, një lëndë që mund të analizohet për kohën e gjatë të ngurtësimit të metodës së realizmit socialist, larg stinëve të ‘shkrirjes’ që vetë modeli rus (dhe ai i vendeve fqinjë si Jugosllavia) pati njohur.

Shkruar pas tridhjetë vjetësh tranzicion, pikëmbërritje e një arsytimi dhe hezitimi të gjatë sistematizues, kjo veper karakterizohet nga një reflektim i thellë teorik për mënyrën se si funksioni letrar, cilësi e posaçme e veprës letrare, do të pësojë, në realitetin shqiptar të viteve '45-'61, një ngrirje e një denatrim të thelbit të saj të qenësishëm, natyrës semantike.

Kjo ‘pasqyrë’ përmbush një boshllëk në fushën e shkencave humane shqiptare, ende nën veprimin rrafshues të epokës së diktaturës së proletariatit dhe të gjykimit po aq rrafshues të tranzicionit të gjatë post-komunist.

Romani "Liria ime" i Mehmet Krajës mund dhe duhet të lexohet si katarsis për dhe mbi lirinë e munguar e të ëndërruar, të ngjyer me gjakun e më të guximshmeve në gjenerata të tëra, të përljer me mëkatet e shumicës aspiruese të saj. Në të vërtetë, ky roman përthekon brenda vetes katarsisin shpirtëror të një shoqërie që përjeton agoninë e përjetimit të lirisë, asaj individuale dhe kolektive, prandaj ky katarsis vështirë të realizohet në planin kolektiv, nëse së pari nuk kemi përjetimin e katarsisit personal, individual.

Në këtë pikëshikim, liria i ngjason një çibani të mbirë në trupin e një shoqërie të tërë dhe vetëm nevoja e vetëpastrimit, katarsisi do mund ta pastronte qelbin moral e shpirtëror të saj. Të gjithë personazhet sikur janë shkëputur nga një udhëtim i pafundmë dhe fatkeq në kërkim të lirisë, rruga e tyre është devijuar sa për të treguar se dashuria për liri është "mallkimi" që i ndjek deri në fund, dhe ky "mallkim" mund të hiqet vetëm nëse përjeton katarsisin individual, prandaj ata i rikthehen vazhdimisht e vazhdimisht të kaluarës, reminishencat e së cilës arrihen lehtësisht e pa sforcim përmes kapërcimeve të natyrshme nëpër kohë, të atilla sa nuk çuditësh më sesi mendimet e personazhit mund të shkojnë aq shpesh në kohë e në vende të ndryshme, të kthehen në realitet e të shkojnë pastaj sërish në të shkuarën, pa krijuar kurrfarë barriere në kuptim. Ballafaqimi fare pa komplekse me të kaluarën duket si një lloj shpëtimi nga vetvetja, nga palumturia e tyre ngjitëse, nga luftërat e tyre të humbura që pa filluar fare. Në fund të fundit nëse në një mënyrë ose në një tjetër e kanë përjetuar ferrin tokësor, çfarë mund të kishte më tepër se kaq?

E ferri i tyre nuk është ai i konceptit filozofiko-letrar të Sartrit, pra, tjetri, ferri në të cilën i ka zhytur autori është liria iluzore dhe gati-gati e pamundur e njerëzve, të cilët e kanë ëndërruar dhe aspiruar gjatë e sigurisht në mënyrat e tyre e për të cilët kthehet në pamundësi pikërisht atëherë kur e prekin me dorë. Prandaj, nëntë rrëfimet mund të lexohen edhe si nëntë rrathë ferri, pasi secili rrëfim bart me vete një lloj "nxehtësie" ferri të marrë nga fatet e përmbysura të protagonistëve.

E kur vjen fjala te nëntë rrëfimet, aq sa e përbëjnë romanin, mundet vetëm të pohojmë të dukshmen, atë se "Liria ime" e Mehmet Krajës nuk është lloji i romanit tradicional, me një subjekt që rrëfihet apo lexohet fund e krye si një tërësi organike, autori-një romancier i majave, këtë herë qëllimshëm ka zgjedhur të bëjë thyerje të fortë të zhanrit, duke bërë bashkë histori e personazhe të ndryshme të cilët faqe pas faqeje me një gjuhë të pasur dhe hijeshuar me gdhendjen dhe elegancën e filigranit, do të vizatojnë estetikisht portretin jo dhe aq të bukur të lirisë së shumë ëndërruar. E, "eksperimentimi" nëse mund ta quajmë kështu, me zhanrin del të jetë i suksesshëm: autori arrin që përtej çdo imagjinate të lidhë bukur e në mënyrë të përsosur rrëfime të palumtura e të trishta njerëzish të veshur me petkun e heronjve të panjohur e të humbur margjinave të historisë, të cilët nuk i lidh kurrëgjë me njëri-tjetrin veç fatit të përmbysur brenda një lloj tragjediteti absurd që i çon në një vetmi më të thellë e më të kobshme se edhe vetë vdekja.


Narratori është ai që i lidh mes veti, jo aq si personazhe që e njohin njëri-tjetrin apo se japin e marrin me shoku-shokun, por si fate njësoj tragjikë, njësoj të palumtur, njësoj të vetmuar, njësoj fatkeqë në këtë vetmi rraskapitëse e munduese. Rrëfimet dhe personazhet bartin shtresime kuptimore të shumta, sidomos shtresime psikologjike e filozofike, të cilat ngjasojnë me përsiatje të cilat plotësojnë kuadrin e tërë romanit, duke e shndërruar atë bindshëm nga nëntë rrëfime të palidhura me njëri-tjetrin në një rrëfim të vetëm që tregon palumturinë, zhgënjimin dhe vuajtjet e njeriut të pasluftës, të luftës apo para luftës e që nuk ka kurrfarë rëndësie nëse është jeta e vetë narratorit, ajo e Hysen Ramës, Selim Krasniqit, zonjës Drita, Muharrem Marmelushës, Bujar Sylës, Halil Demajt, Agim Kozgorit, Habib Çerkezit, njeriut me identitet të humbur, aktores së dikurshme apo qoftë edhe e një qeni.

Pasi e lexon romanin "Liria ime", kupton atë që e ke ditur gjithmonë, se liria nuk arrin t'i

Romani "Liria ime" i Mehmet Krajës, Onufri

## NJË RRËFIM TRONDITËS PËR NJERËZ TË PALUMTUR

Nga Albana Beqiri



bëjë të lumtur njerëzit, bota është e mbushur plot me njerëz të palumtur edhe pse ata janë njerëz të lirë, të cilët lirinë e kanë përfituruar që nga lindja dhe kurrë nuk e kanë pasur ideal apo qëllim jetësor, si ta zëmë e kanë pasur shumica e personazheve të romanit të Mehmet Krajës.

Në një lexim të kujdesshëm të romanit, sheh se narratori që nuk është gjithmonë i pranishëm, por shfaqet herë pas here, është megjithatë një lloj protagonist, po aq fatalist sa edhe personazhet e tij, gjithmonë shfaqet në momente kyçe jo aq për të qenë filli lidhës i historive të rrëfyera, sa edhe një katalizator i tyre, rrëfyer i besueshëm i mendimeve të fshehta të personazheve, qëmtues i dhembjes që ata mbajnë ndër vete, njohësi më i mirë i peshës së rëndë të vetmisë së tyre. Janë kështu nëntë jetë njerëzish të Kosovës, të cilët në luftë me vetminë dhe me palumturinë e tyre, shenjojnë në të njëjtën kohë edhe jetën e narratorit. Jeta e tyre është njëkohësisht edhe jeta e tij dhe jeta e tij është në një mënyrë edhe e tyre. Psh, në rrëfimin për Muharrem Marmelushën nga Prizreni, narratori shfaqet më shumë, sikur shkrihet e bëhet një me


rrëfimin për personazhin e tij. Ani pse i distancuar qartë, ai sërish sikur jep e merr me personazhin, përjeton bashkë me të, i njeh luftërat e tij të fituara e njeh edhe luftën e tij me vetveten, me dëshpërimin dhe me vetminë. Te figura e këtij ushtaraku të zvjerdhur fizikisht e moralisht luftërave të huaja, narratori bën kapërcimin e madh, që në krye kur deklaron se është i lodhur nga lufta paqësore e LDK-së i jep rrëfimit tone sarkastike, duke e thelluar ta quajmë kushtimisht talljen me vetveten, por edhe me personazhin për të cilin do të rrëfejë, sepse pikërisht nga kjo mërzi me opsonin paqësor del se ata të dy nuk kanë vetëm një luftë për të bërë, por shumë të tilla, njërin nga të cilat Muharrem Marmelusha e bën në prani të narratorit. Natyrisht që e humb, nuk është luftë që do mund ta fitonte.

Por, rrëfimi i parafundit, ai i njeriut pa identitet, ku narratori duket të jetë më i kufizuar për shkak se njeriu pa identitet është tërësisht i pavetëdijshëm e për të nuk ka kush të rrëfejë, është rrëfimi që në fund të fundit e shndërron rrëfimitarin në kryepersonazh. Pasi arrin të shkrijë organikisht e ta kalojë

pa sforco atë kufirin e hollë mes reales dhe ireales, narratori del të jetë i njëjti me personazhin pa emër e pa histori: një tufë lulesh mbi varrin e njeriut pa emër ka në shënim emrin e narratorit! Këtu historia merr fundin më të paimagjinueshëm dhe misteri e mbështjell përfundimisht rrëfimin për vdekjen e kryepersonazhit dhe krejt në fund mund të thuhet se gjatë gjithë kohës narratori kishte përshkruar vdekjen e tij. Me këtë akt final përmbillet jeta e tij, e copëzuar në jetët e personazheve të tij të palumtur.

Të nëntë rrëfimet, përfshi këtu edhe atë nga perspektiva e një qenushi bartin përvoja të forta e shenjuese jetësore, (rrëfimi i qenit psh. në më të shumtën e herëve bart përvojat e zonjës së tij, aktores dikur të famshme), të cilat nuk kanë edhe aq shumë nevojën e imagjinatës që të gravohen artistikisht, por autori përmes gjuhës së kondensuar dhe shtresimeve shumëdimensionale në të cilin e fut tekstin letrar arrin t'i kthejë këto përvoja artistike në letërsi, e cila të kënaq dhe të përmbush estetikisht. Frizat e gjata janë gjetje befasuese në mënyrën sesi strukturohen brenda një të tille gjen jo vetëm shtresime të shumta, mendime të lidhura organikisht me njëri-tjetrin, apo edhe dy tre situata që po ashtu shkrihen çuditërisht ndër vete si me qenë një e vetme e që funksionojnë si një tërësi shumëkuptimëse rrëfimore. Gjuha është shterur e përpunuar deri në atë pikë sa prej saj janë shtrydhur të gjitha esencat kuptimore duke u njehsuar lehtësisht me tekstin letrar si një tërësi unike, që siç pohuam më sipër kënaq estetikisht.

Të mbështjellë me petkun e universalitetit, megjithatë personazhet, qofshin kryesorë apo rastësorë duket sikur mbartin një mision: të plotësojnë kuadrin e jetës së shqiptarit kudo që ai të jetë, për të treguar se refleksi i fortë nacional sikur i është stampuar në ADN e të cilin nuk i ikën dot në asnjë vend të botës, kudo që të fshihet apo largohet me idenë se nuk do të kthehet më kurrë në atdheun e tij, që për shumicën e të cilëve është një vend ku përveç kujtimeve të vyshkura të së shkuarës, mund të gesh edhe një varr ku të vendosësh një tufë lulesh. Shumë histori nuk rrëfohen deri në fund dhe kjo është një gjetje interesante, sepse pikërisht përmes të pathënës thuhet më shumë, nënkuptohet më shumë. Personazhet janë kryesisht personazhe të humbura brenda jetëve të tyre, personazhe me ëndrra të vrara, ideale të tradhtuara, me trauma që i kanë rrënjët thellë në momente apo situata të tmerrshme, ata janë në ngarendje të përhershme për diku që shpesh nuk e dinë as vetë se ku apo çka është, por gjatë kësaj ngarendjeje zhbirojnë pse jo edhe pavetëdijshëm në skajet më të errëta e të fshehta të qenies njerëzore, çka bën që në ato rrëfime të gesh e të prekësh gjithçka. Në to gjen ideale të tradhtuara nga ata që thirren në emër të tyre, vrasje, dhunime, jetë dyfishe, spiunë e bij spiunësh që enden në tmerrin e një jete me damkën e atit spiun, të moshuar që në muzg të jetës duan të rrëfijnë historitë e tyre jetësore qoftë të shkruara si dorëshkrime prej 540 faqesh apo si drama që përfundojnë veç në një faqe të vetme e që pretendojnë se ato janë dorëshkrime për historinë e botës, gjen e prek të vërteta e fakte historike që dhembin, dështakë që nuk kanë arritur të bëjnë asgjë të vlefshme në jetën e tyre, përpos gjërave



që ia kanë shtuar dozën e palumturisë, gjen e prek po ashtu absurdin e luftës e sidomos atë të paqes, tmerrin që mbulohet përmes petkut të lumturisë së rrejtshme, vetminë që përpin gjithçka e më lehtë nga të gjitha jetë njerëzore, prek dhimbshëm shpërfytyrimin nga ideologjia dhe nga indoktrinimi ideologjik, përkeqjen në emër të luftës e të fitores, gjen aty po ashtu realitet të dhembshëm e fiksion brenda një situatë të vetme, gjen pra gjithçka që e bën të prekshme jetën njerëzore. Personazhet enden lehtësisht në botë sa reale aq edhe imagjinare, ata flasin me veten, flasin me të shkuarën dhe kujtimet e tyre, flasin dhe rrëfejnë për palumturinë e tyre dhe të botës duke të mbajtur të lidhur fort pas rrëfimit. Kështu krijohet edhe dinamika e brendshme, e cila dominon gjatë gjithë kohës.

Gjithçka nis në aeroportin e Prishtinës e gjithçka përfundon aty. Halil Demaj pas dy javëve në Prishtinë (të vetmeve që nga dita që kishte lënë Prishtinën për të ikur drejt Maqedonisë si refugjat), ndërsa largohet drejt Irlandës ku jetonte që 20 vjet, sheh vetëvrasjen e një qenushi. Kjo vetëvrasje përmbyll gjithçka, i jep fund iluzionit për një jetë të lumtur e të dinjitetshme.

Halil Demaj nuk e di se po shkon drejt vdekjes së tij, drejt atij momentit kur një ish-spiun, që e kishte terrorizuar gjatë gjithë jetës, duke e marrë në pyetje e kërcënuar, duke e cenuar madje edhe në nder (kishte shkuar me të shoqen e tij), tani si dëshmitar i mbrojtur i gjykatës speciale e gjen deri në Irlandë e në fund fare në mënyrën më absurde ia merr edhe jetën. As Bujar Sylaj nuk e dinte se insistimi i tij pa ndonjë motiv të vlefshëm për të zbuluar nëse vrasjen e Jusuf Gërvallës e kishte ideuar e urdhëruar i ati spiun, do e çonte drejt vdekjes, të cilën do e bënte realitet një moskuptim fatkeq, as Selim Krasniqi nuk e dinte se pas gjithë atyre traumave dhe përjetimeve të rënda, gjithë asaj vetmie që e ndante me veten, me hijen e tij apo me ndonjë zog, do të kthehej në vrasësin e të shoqes, duke mbuluar kështu gjithë mosguximin, paburrërinë apo pafuqinë e tij për të shpëtuar mixhën nga vrasja në oborr të shtëpisë apo për të shpëtuar të shoqen nga përdhunuesit - tre burrat që ia vranë edhe mixhën, as Muharrem Marmelusha nuk e dinte se pas gjithë atyre luftërave të fituara do të humbte luftën e vërtetë, të parën luftë të tij, atë me vetveten e që pas aq shumë e shumë vrasjeve, djegieve e rrënimeve në luftëra të huaja nuk do e mundte dot demonin brenda vetes që e kishte fillin në një ditë kur në fëmijërinë e tij të largët e në vendlindjen e tij po aq të largët pa sesi tre vete ia vranë të atin, ai po ashtu nuk e dinte se vdekja e tij do të ishte po aq e palavdishme sa jeta, do përfundonte me fyt të çarë nga e shoqja, zonja Mo, as Agim Kozgori nuk e dinte se do përfundonte me këmbë e duar të thyera vetëm pse donte dikë po aq të palumtur e po aq fatkeq sa ai, vetëm njeriu pa identitet e dinte se po vdiste dhe e pranoi vdekjen, ashtu si vetëm qenushi i aktores Aferditë bëri aktin më sublim: u vetëvra me vetëdije të plotë. Të gjithë këta personazhe mund të lexohen në mënyrat e veta heronj dhe antiheronj, ata ishin aty ku bëhej historia, por të zënë deri në fund me palumturinë e tyre, të zdërrhallur në absurdin e fatalitetit të tyre nuk ishin në gjendje as ta perceptonin si të tillë historinë, se për ta përjetuar atë as që bëhej fjalë. Ata mbetën deri në fund njerëz të pafat, të panjohur për njëri-tjetrin, që ndërliqen mes veti me një fill të padukshëm e që duhet të jetë një lloj njeje e padukshme e fatit, e cila i përbashkon në fatalitetin e jetës së tyre.

Parë kështu, të gjithë funksionojnë si pjesë e një të tërë. Krejt romani është një mozaik në kërkim të jetës, dhe të nëntë rrëfimet e tij janë pjesë e këtij mozaiku, të gjithë bashkë bëjnë plotninë e tij.

Për fund, "Liria ime" është një rrëfim artistik tronditës i njerëzve që s'kanë ç'të bëjnë me lirinë e cila nuk përmbush as për së afërmi barrën dhe peshën e stërmadhe të iluzioneve, ëndrrave dhe aspiratave të shumë e shumë brezave.

Liria për ta ka qenë kryq a gur Sizifi që siç kanë ditur dhe mundur e kanë mbajtur mbi shpinë, derisa kur e prekën realisht kuptuan se nuk është kurrëgjë tjetër veçse zgjatim absurd i palumturisë së tyre permanente.

## DISKURS MBI STRUKTURËN E NJË TEKSTI POETIK

Nga Vangjush Ziko

Gjuha është mjeti themelor nëpërmjet së cilës realizohet një tekst letrar. Fjalët janë ato të cilat, të lidhura reciprokisht me sendet apo dukuritë e ndryshme krijojnë një tekst. Ky tekst na parashtron një botëkuptim të caktuar mbi botën reale.

Në shkrimet apo komentet, që bëhen për një tekst të vargëzuar, shpesh herë i mëshohet vetëm vlerësimit apo analizës së "përmbajtjes ideore". Kjo do të thotë se vlerësohet vetëm përmbajtja e shkrimit duke mos e përfillur apo duke e anashkaluar analizën e "përmbajtjes artistike" të tij.

Kjo mënyrë interpretimi i paraqit lexuesit masiv një model të gabuar, të thjeshtëzuar të poezisë dhe të vlerava artistike të saj. Ky është një gjykim apo interpretim i mangët i një teksti poetik, mendim i cili dëmton, në radhë të parë, shijen e lexuesit ndaj vlerave të pozisë.

Një krijim poetik i vërtetë ka strukturën e vet, i cili përbëhet nga përshkrimi, meditimi, gjykimi. Kjo strukturë në tërësi realizohet nëpërmjet strukturimit dhe vëllimit kuptimor artistik të tekstit poetik.

Po marr si shembull poezinë e poetit Niko Kacalidha:

### GJETHI PAGAN

Harroi perënditë e drurëve dhe bridhte në oborre.  
U shkëput nga besimi i parë për perëndinë e blerimit.  
Nyja e këputjes ishte kërthiza që e lidh me prillin.  
Zgjohet natën në alučinacionet e yjeve.  
Bie fle përmbys në të gdhirë në polenin e blirit.

Dhe këputet dhe vdes në dinastinë e drurëve.

Në të flenë vetëm gjarpërinjtë se perënditë kanë ikur.

Që në titull të poezisë të bie në sy antonimia, që ngërthen togfjalëshi "gjethi pagan".

Fjalori na thotë se gjethi është pjesë e rëndësishme e bimës, që i shërben për funksionimin e saj; ai është i gjelbër dhe me forma të ndryshme.

Fjala "pagan" lidhet me paganizmin, me kultin e besimit të njeriut në lashtësi në shumë hyjni.

Kemi të bëjmë, pra, me një një çift antonimik, me dy fjalë që nuk kanë lidhje organike me njëra-tjetrën.

Ky tekst poetik ka dy lexime krejt të ndryshme.

Po të marrim, thjesht, leximin "botanik" teksti na përcjell me kuptimin e vet të drejtpërdrejtë një fenomen natyror të zakonshëm nga "dinastia e drurëve": çeljen, gjelbërimin, shkëputjen nga dega, endjen dhe tharjen e gjethit.

Leximi i dytë na sugjeron një lexim tjetër, lexim poetik.

Roman Jakobson shkruan: "Poetikja është e pranishme, kur fjala me kompozimet e saj, me semantikën e saj, me formën e brendshme dhe të jashtme përfiton gjithçka edhe vlerën në vetvete - në vend që t'i qëndrojë në mënyrë indiferente realitetit".

Fjala "gjeth" në këtë poezi ka fituar një peshë dhe një vlerë të re, "gjethi" e ka humbur funksionin e vet natyral.

Në leximin e parë kemi një parashtrim të një përmbajtjeje të thjeshtë dhe të rëndomtë, një tekst botanik, shkencor. Fjala perceptohet si fjalë e zokonshme



e fjaforit, e të folurit tonë të zakonshëm aspak emocional.

Në togfjalshin "gjethi pagan", fjala "gjeth" ka përfutur një kuptim metaforik. Gjethi është "shpirtëzuar". Kemi kështu përqasjen e procesi natyror me një proces shpirtëror, pra, shkëputjen nga një lidhje, nga një origjinë. Kjo na shpie në një tjetërsim kuptimor dhe emocional të fjalës "gjeth".

Gjethi "shkëputet nga kërthiza", "endet nëpër oborret", kllapitet në "alučinacionet e yjeve" dhe "vdes", "në të flenë gjarpërinjtë" dhe "perënditë (e tij) kanë ikur" prej tij.

Autori me këtë tekst të vargëzuar poetizon një fenomen shpirtëror, që ka ndodhur historikisht dhe pikërisht, tragjizmin, largimin e njeriut nga origjina dhe nga besimi i vet i mëparshëm.

Struktura e një teksti poetik, pra, është një strukturë e ndërlikuar, një strukturë komplekse krijuese. Teksti artistik është një diskurs, një arsyetim kompleks. Të gjitha pjesët e strukturës së tij ndërthurin elemente të arsyetuara dhe të gjykuara estetikisht dhe filozofikisht.

Filosofi strukturalist M. Fukault thekson se historikisht ka sisteme të ndryshme të ndërlidhjeve të gjuhëve të ndryshme. Një nga këto lidhje është ajo e gjuhës së filozofisë me gjuhën e filologjisë.

Teksti i kësaj poezie është shndëruar në një strukturë të organizuar semantike. Ai është shndërruar në një mendim kompleks artistik dhe filozofik. Teksri i poezisë është rikonstruktuar figurativisht dhe estetikisht.

Poezia "Gjethi pagan" është një krijim i vërtetë poetik.

Gjuha e veprave letrare dallohet thellësisht, jo vetëm nga gjuha e folur, por edhe nga gjuha e teksteve filozofike apo shkencore, e shkrimeve gazetareske ose teksteve të ndryshme devolguese.

Nuk është poezi një tekst i vargëzuar, që na përcjell thjesht një ngjarje apo një mendim a emocion të çfarëdoshëm.

Pa kundërvënien midis fjalës së thjeshtë dhe kuptimit të figurshëm të saj, nuk ka lëvizje, Poetikja lind vetëm kur ndërpiet vitaliteti i zakonshëm, natyror i fjalës dhe lind një cilësi e re e figurshme e saj.

Studjuendsi J. M. Llotman, një përkrahës i analizës strukturaliste të tekstit poetik, shkruan: "Në qoftë se sasia e informacionit, që ngërthen gjuha poetike dhe gjuha e zakonshme është e njëjlojtë, atëhere gjuha artistike e ka humbur të drejtën për të ekzistuar, ajo në fakt asgjësohet".

Për poetin, por edhe për lexuesin, ka rëndësi dhe vlerë jo vetëm përmbajtja, por dhe forma, struktura dhe gjuha poetike e një krijimi letrar artistik.



Është gjë e rrallë që njeriu të jetë politikan dhe dashur për masat e gjera. Ndërsa të jetë ministër dhe më pas të largohet nga pozita me dëshirën e tij, në vende si yni, ku zyrtarët nuk e kanë statusin e "ish-it" derisa të japin shpirt, është diçka edhe më e çuditshme dhe e rrallë. Pastaj, tërheqja nga politika për shkak të dëshirës për t'iu përkushtuar letërsisë, mund të thuhet se është mrekullia vetë.

E gjithë kjo ndjenjë habie buron nga jeta dhe veprimtaria e romancierit dhe poetit shqiptar Besnik Mustafaj, ish-ministri i Punëve të Jashtme të vendit të tij. Për shkak të veçantisë së tij, ai u kthye në personazhin publik të parë që tërhiqte vëmendjen. Megjithatë, Mustafaj – i cili u ul të premtën e kaluar (26 janar) për herë të parë përpara audiencës në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Kajro - e trajton të gjithë këtë me një thjeshtësi të admirueshme, pavarësisht se toni i tij nuk e fsheh krenarinë për prodhimtarinë e tij letrare.

Ai vetë, me përlulesi, e përmbledh këtë çështje duke thënë: "Konflikti i brendshëm midis letërsisë dhe politikës më ka shtyrë që të zgjedh atë që më përshtatet më shumë. Sepse letërsia është si një zonjë e rëndë që nuk pranon të dytë. Unë jam tërhequr nga politika, pavarësisht se nuk kam humbur në zgjedhje dhe as nuk jam akuzuar asnjëherë për asgjë. Çështja ime mbeti e pakuptueshme për publikun e gjerë. Në fakt, fama mu rrit më tepër pas tërheqjes nga politika."

Autori i "Daulja prej letre", i cili është përkthyer në gjuhën arabe dhe botuar nga Dar Al-Hiwar në vitin 2022 dhe më herët përkthimi i "Një sagë e vogël nga burgu", i cili është botuar nga Alan Publishers në vitin 2021, i përngjan më shumë një burri në një prej fshatrave të Deltës së Nilit, me fytyrën e tij rrumbullake e bardhoshe.

Ndërsa me veshjen e thjeshtë dhe çantën e shpinës, me të cilën mori pjesë në takimin e Kajros, ai i ngjan një qytetari të zakonshëm, të cilin mund ta hasësh nëpër korridoret e institucioneve shtetërore në vendet arabe. Kjo duket se lidhet me thjeshtësinë, spontaneitetin dhe mungesën e rezervës së tij në të folur, pavarësisht karrierës së tij të mëparshme diplomatike, pasi ai ka qenë gjithashtu ambasador i Shqipërisë në Francë, përpara se të mbante një post ministror, përgjatë një nga periudhave më delikate të vendit të tij.

Kjo ishte për njeriun Besnik Mustafaj. Po në lidhje me shkrimet e tij? Edhe këtu habia nuk ka fund. Mustafaj, i cili flet rrjedhshëm frëngjisht, ndoshta aq sa një francez, shkruan vetëm në shqip, pavarësisht ofertave joshëse që ka marrë nga botuesit francezë për të shkruar në gjuhën e tyre, pasi kjo do t'i mundësonte – siç i kanë thanë – përhapje më të gjerë, rrjedhimisht edhe përmbushje më të madhe letrare dhe materiale.

Lidhur me këtë, në intervistën e tij për Al-Arabi Al-Jadeed ai thotë: "Shkrimtari në gjuhën e tij është si peshku në ujë. Vetëm gjuha amtare të jep mundësinë të notosh lirshëm. Të hysh në një gjuhë të huaj është si të jesh brenda një kutie xhami, në një akvarium. Ata që shkruajnë në një gjuhë tjetër, duke braktisur gjuhën e tyre amtare, nuk e kuptojnë se rëndësinë parësore që ka për një shkrimtar të kuptohet dhe që pëlqehet nga ata që flasin gjuhën e tij."

Nga simpoziumi i Panairit në Kajro, Mustafaj tregon për një tjetër ngjarje që e ka shtyrë të zgjedhë për të shkruar shqip gjerësisht. Gjatë një interviste për një kanal televiziv francez, gazetarja intervistuese i kishte përmendur se Milan Kundera, me origjinë çeke, kishte zgjedhur në gjysmën e dytë jetës së tij si shkrimtar të shkruante në frëngjisht. Mustafajit nuk i kishte mbetur zgjidhje tjetër veçse t'i përgjigjej asaj në mënyrë spontane: "Gjithçka që Kundera ka shkruar në frëngjisht më duket më e dobët,

# BESNIK MUSTAJ, NJË SHQIPTAR QË E NJOHIM DHE NA NJEH

Nga Mahmoud Atef

Me rastin e botimit në arabisht të romanit "Dëmtuar gjatë rrugës", shkrimtari Besnik Mustafaj ishte i ftuari i nderit në edicionin e 55-të të Panairit Ndërkombëtar të Librit në Kajro. Me këtë rast u organizuan disa veprimtari, ku më kryesori ishte simpoziumi me temë: "Besnik Mustafaj – rrugëtimi i një shkrimtari midis politikës dhe letërsisë". Mediat në mbarë botën arabe i kushtuan një vëmendje të veçantë këtij simpoziumi dhe më gjerë personalitetit të shkrimtarit tonë. Pas "Një sagë e vogël" dhe "Daulja prej letre", ky është romani i tretë i Besnik Mustafajit që botohet në arabisht.

ExLibris zgjodhi për lexuesit e vet shkrimin e botuar me 31 janar në shtojcën kulturore të gazetës së madhe "Al Araby", e cila del në Londër dhe shpërndahet në mbarë botën, përfshirë këtu edhe vendet arabe.



Besnik Mustafaj duke dhënë autografe për lexuesit në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Kajro

si e shkruar nga dikush tjetër në krahasim me atë që ai kishte shkruar më parë në gjuhën çeke."

Mustafaj shton: "Të nesërmen mora një telefonatë nga Kundera, në të cilën ai më qortoi me shumë mendjemadhësi, duke më thënë: Një buzëqumësht si ti do të më japë këshilla mua! Gjithçka që munda të bëja ishte t'i përgjigjesha: Nëse deklarata ime ju paska zemëruar, do të thotë se është e vërtetë. Kështu ma mbylli telefonin në

fytyrë. Unë isha vërtet buzëqumësht. Isha 35 vjeç."

Më tej ai shpjegon: "Sa për mua, më pëlqen të shkruaj me fjalët që më nevojiten, jo vetëm me ato që di. Gjuha ime amtare është ajo që më jep këtë hapësirë dhe mjedis të lirë që nuk do ta gjej askund tjetër."

Mustafaj ishte i ftuar në Kajro për të promovuar veprën e tij të fundit të përkthyer në arabisht, romanin "Dëmtuar

gjatë rrugës", i cili është botuar nga shtëpia botuese siriane Dar al-Hiwar" dhe përkthyer nga Adnan Muhamed. Ashtu si pjesa tjetër e romaneve të tij, ai trajton ndikimin e periudhës diktatoriale gjatë sundimit komunist në vendin e tij, e cila ka zgjatur plot 45 vjet.

Lidhur me rëndësinë e përkthimit të librave të tij në arabisht, ai i shpjegoi Al-Arabi Al-Jadeed se ka shumë vlera të përbashkëta midis vendit të tij dhe rajonit të vendeve arabe, veçanërisht se Islami ka hyrë në Shqipëri qysh në fillim të shekullit të pesëmbëdhjetë. Kjo sepse vendi i tij ka qenë nën sundimin e Perandorisë Osmane, ashtu si dhe rajoni i vendeve arabe. Ai shton gjithashtu se edhe pse në romanet e tij merret ekskluzivisht me dramën shqiptare, dhimbja njerëzore në letërsinë e tij është universale.

Po në lidhje me dhimbjen palestineze, kur ai njihet për përkushtimin e tij ndaj çështjeve humanitare? Mustafaj iu përgjigj Al-Arabi Al-Jadeed se çështja palestineze është një tragjedi e madhe. Ai shton: "Ajo që ndodhi më 7 tetor është pa dyshim e rëndë nga ana e Hamasit. Por në vazhdim Izraeli e ka tejkaluar atë që mund të njihet si e drejta e tij për t'u kundërpërgjigjur." Më pas ai shpjegon, duke theksuar: "Çështja Palestineze nuk mund të zgjidhet përmes një lufte, e cila po duket asgjësuese për popullin palestinez nga ana e Izraelit".

Ashtu si Mustafajit nuk i mungon përkushtimi për të mbështetur atë që është humane, ai gjithashtu nuk e harron respektin e tij për komponentin mysliman, i cili është tashmë pjesë e identitetit të tij historik. Ai shfaqet megjithatë i shqetësuar pse rrymat politike gjithnjë e më me peshë në Europë shohin një kontradiktë thelbësore midis Islamit dhe qytetërimit evropian. Ai thotë: "Ne jemi në vendin tonë myslimanë evropianë, as refugjatë, as emigrantë. Ne nuk vuajmë nga ndonjë ndjenjë inferioriteti apo superioriteti ndaj pjesës tjetër të Europës. Nëse duam t'i bashkohemi Bashkimit Evropian, ne do të hyjmë në të me të gjitha shtresat e identitetit tonë, duke përfshirë atë myslimane."

Pyetjes për mungesën e shkëmbimeve shqiptaro – arabe, Mustafaj i jep një përgjigje plot seriozitet, por ku nuk mungon sarkazma, se vendi i tij, ashtu si edhe vendet arabe shikojnë në mënyrë pothuaj ekskluzive nga Brukseli dhe Uashingtoni, duke harruar sa i rëndësishëm është për zhvillimin e tyre bashkëpunimi me ato vende, me të cilat ato kanë edhe elementë të përbashkët kulturorë.

Përktheu dhe përgatiti për botim:  
Fatrit Beqiri



Kopertina e romanit "Daulja prej letre" në arabisht.



Fig. 3: Kopertina e romanit "Një sagë e vogël" në arabisht



Kopertina e romanit "Dëmtuar gjatë rrugës", botuar në arabisht me titullin "Në emër të nënës dhe të birit"

«Jeta është e lehtë symbyllur»  
«...nëse s'është për të gjithë, ai s'është Atdhe»

Në fjalët paraqitëse për librin e Astrit Lulushit, prozatori dhe studiuesi shumëplanesh Dashnor Kokonozi citon shprehjen e Horace Gril, «Shko në Perëndim, rritu bashkë me vendin.»

Pas librit «Ndjenjë realiteti», lexuesi do të shtonte «shko në Perëndim, rritu dhe provo të kthehesh ndryshe në vend-Lindje.» Astrit Lulushi më në fund e «vizitoi» Atdheun, pas 35 vitesh.

Dhërat e huaj për këdo kanë shërbyer «bankë-provë» për njeriun si qytetar të botës. Historia shqiptare është inspiruar e ri-dimensionuar gjithnjë prej mërgatës, prej individëve që kanë mbajtur ngritur antenat për zërin e botës.

Njerëzit e mëdhenj të kulturës shqip (prej Buzukut, Budit, Bogdanit e Rilindësit, natyrshëmri që rezistoi edhe me shkollimet evropiane në vitet '30) kanë ardhur prej të kulturuarve e arsimuarve shpirtërisht ndryshe prej countrymen-ve që edhe kur u dërguan për studime në Perëndim (Francë) nuk arritën të njohin as veten.

Si Shtëpi e mbyllur, lyster me të kuqe, Shqipërisë iu desh ta kishte një aradhe mendjesh të hapura, të mos mbetej «as Lindje as Perëndim», gjer edhe kur shpalli muze një «Shtëpi me Gjethes!»

Me «dhera të huaj» kuptojmë ikjen prej mjedisit aty, ndierjen ngushtë në një gjuhë të lexuari, daljen prej rrethit vicioz të mendimit uniform, gjer tek ideja se edhe planeti vetë është realitet për tu braktisur si imazh i izoluar.

Dherat e huaj nisin të rikthejnë mesazhin që pritej për aftësitë e shqiptarit verifikuar në botë, pas mbylljes totale. Me status e banim të ri, mes faktorësh të tjerë, merr tjetër dukje e thelb tjetër, që kurrë s'do kishte mundur të çelte e shfaqte fruta në vendlindje, nëse do kish mbijetuar.

Astrit Lulushi kthehet nëpërmjet librash, atje nga ku iu desh «të ikte natën» ujërash të ftohtë. Pa e pasur kurrë ndërmend Kthimin si revansh të Ikjes, «historia» s'do t'i interesonte më si *E Shkuar*, nëse s'do kishte lidhje me *Të Sotmen* që inspiron të mbetet *E Nesërme* në dheun / dhimbje lindore.

Nëse perifrazojmë një frazë të tij, në krye të librave të Astrit Lulushit do të shkante mbishkrimi: «Nëse s'ke dëshirë të dish e të mendosh ndryshe, nëse s'je gati për të ndryshuar, s'ke pse e shfleton këtë libër».

Shqipëria e kohës «me qeveri pa pëlqimin e të qeverisurve» shihte si të dyshimtë çdo të huaj, shpallte armik çdo shqiptar që mendonte për andej matanë dhe padyshim që jetonte jashtë. Tanimë dhimbja ka marrë trajtë tjetër: Shqipëria e sotme ende s'është gati si Atdhë Real për tërë qytetarët e saj. Edhe pas dekadash lirie formale, i gëzohemi etjes së qytetarëve për tu larguar nga vendi.

Për dikë që ka ikur dhe bën të kthehet ndryshe, heshtja është e pamundur: «Mënjëherë pas rënies së diktaturës, të gjithë u bënë 'të djathtë', askush nuk fliste a të gjithë heshtnin për filmat, këngët, pikturat, skulpturat, librat, gjithë ky art i detyruar, i realizuar pa frymëzim gjatë periudhës së errët; bustet e pikturat u mbyllën bodrumeve, ndërsa emrin e diktatorit askush nuk guxonte, të paktën moralisht, t'ia zinte në gojë për të mirë...!»

Ajo kohë, që më në fund u quajt diktaturë nga thujtë të gjithë, për të cilën deklarohet se ka rënë pa kthim, duket se ka humbur vetëm kreun e dikurshëm. Ne të tjerët jemi thujtë po ata. Ia vlen të na kujtojnë për këtë...

«...Kohët kanë ndryshuar pak, mendësia edhe më pak... Vështirë të quhet lajthitje kur lihet jashtë qoftë edhe një figurë... që ka lënë emër të nderuar nëpër botë, që

Dy fjalë për librin «Dëshmi dhe kujtesë» të autorit Astrit Lulushi, SHBA, ish gazetar i VOA

## SHKO NË PERËNDIM, RRITU DHE PROVO...

Nga Faruk Myrtaj, Toronto, Kanada

Dy fjalë hyrëse të librit «Dëshmi dhe kujtesë», botuar nga Qendra Traditë-Art-Libra, Tiranë, 2023

ka punuar e është flijuar vetë e me familje për kulturën shqipe. Është fjala për eruditin e diasporës, profesor Isuf Luzajn (1913-2000)».

Ngrirjen e vëmendjes tek idolët e vjetër, te ngjarjet e kujtimet e kohës pa ngjarje, te humania e kohës pa humanizëm, te letërsia pa njeriun si qenie njerëzore, A. Lulushi e vëren si veçori të periudhës pa diktaturë:

«Njerëz të lindur në kafaz, e kanë vështirë të dallojnë ndryshimin... Kjo sjell këmbënguljen e tyre për të vlerësuar pikërisht ata që ulin kokat se ndjejnë turp kur kujtojnë punët e tyre të dikurshme, sot të ripunuara...»

Të justifikohesh se këto punë «duan kohë», s'e 'gjërat kanë radhën e tyre', do të thotë se diçka tjetër ka përparësi për ty (paraja, pushteti, vetja?!). Lulushi e sheh të nevojshme artikulumin e pyetjeve të tilla, të cilat e kanë përgjigjen vetiu. Në sistem lirie, përgjegjësia merr përmasë individuale.


Pse s'po bëhemi dot? Është pyetje që e themi të gjithë. Do duhej që sekush të përgjigjet për veten e tij. Por ne merremi me shqiptarin vetëm kur vërejmë se nuk është bërë ende qytetar; merremi me deputetin, politikanin apo shtetarin, kur provojmë se ai s'është dot i tillë. Shpallemi

pro apo kundër tij, kur ai shkon e hedh gurë te zyrat e shtetit. Shkrimtari, gazetari, intelektual, prononcohen vetëm kur shpjegimi bëhet absurd, zgjidhja kërkohet për «nyjen gordiane».

Zyra nuk është prona jote, i nderuar pushtetar, është vendi i punës ku je deleguar për të shërbyer për një periudhë.

Gazeta, s'është thjesht e drejta dhe mundësia për të folur, por edhe provë e qytetarisë, mundësia për ta pohuar atë dhe atdhetarizmin. Titulli intelektual s'është nxitimi për të marrë dekorata apo çmime, gara mes rivalësh, beteja si sedërllinj ballkanik, por përgjegjësia për të ndërtuar një atdhe për të gjithë...

«S'mund të bëhen pronarë të gjithë, shprehet Lulushi, por askush s'duhet të jetë i shtypur apo skllav, botë pa dhimbje s'mund të ketë, pa vuajtje të panevojshme po. Tragjedi gjithmonë do të ketë për sa kohë-jeta s'është e përjetshme, por mjerimi mund të zhduket, padrejtësi do ketë por tirani s'duhet; intoleranca do zërë vend në mendjet e disave, por mirësjellja a mirësia është veti njerëzore, prandaj është e mundur që një ditë të mbizotërojë jetën e përditshme, por jo pa arsien, fuqinë e mendjes...Dhe arsyeja, jo rastësisht, është individuale...»



Duket sikur të gjithë e dimë se pas verbërive partiake s'shkohet, por pas tyre shkojmë!

E dimë se prej tranzicionit fitojnë vetëm fragmente afër partive, por s'pyesim: përse lulëzon militantizmi?

Këto të gjitha dihen, por shtypi merret me viktimat si viktimat, jo si krijesa të tërë kësaj shoqërie që i largohet të vërtetave. Të gjithë mjaftohen të përfitojnë diçka sot, pa le t'i dalë flaka lagjes, por jo shtëpisë sime...

«Shumë njerëz, përfshi ata që ende kanë plagët e diktaturës - se askush s'është përpjekur t'ua mjekoj, dhe të tjerë që e ndjejnë veten fyer a poshtëruar prej saj - se askush s'ka kërkuar ndjesë publike, mendojnë se demokracia ku ata jetojnë nuk i bind të paktën për një gjë... Si rregull, njeriu gëzon të drejtën e pronës, por kjo pronë është zaptuar ose i është dhënë një personi tjetër me arsyetimin se aty ka punuar a jetuar, në kohën kur pronari i vërtetë... dergjej burgjeve a baltrave të internimit...»

Autori nuk e fsheh anshmërinë: edhe pse e la atdheun dikur, asnjëherë s'ka ikur prej tij; nëse s'është për të gjithë, ai s'është Atdhë; nëse s'ka vend për qytetarin, shqiptari do marrë udhët e botës, që sigurisht s'janë të lehta dhe që s'risht tek udhët e vendlindjes do kthehet në shpirt...

«Me gëzim festohet çdo përvjetor i rrëzimit të shtatores së diktatorit, vëren Lulushi, por që një tiran vërtet të bjerë, njerëzit duhet të sigurohen që piedestali brenda vetes së tyre të jetë shkatërruar... Më keq akoma, kur statusi i të favorizuarve duket i përcaktuar: «kush ishte është...»


Kriteri i këqyrjes së fjalëve dhe veprimave vjen vetiu: «Kush kufizon fjalën sot, gjuhën njerëzve do t'ua priste, nesër. Kush s'pranon mendimin ndryshe ndryshon vetëm në kohë, nga ata që i quanin opozitarët tradhtarë...»

Njerëzit pa kulturën e nevojshme s'janë në gjendje të dallojnë. «Jeta është e lehtë me sy mbyllur», këndonte John Lennon, na kujton «Ndjesi realiteti». Po të mundim, le të ndjejmë...

Astrit Lulushi vështron përtej dukjes: «Kush përpiket të mësojë, përqeshet a përçmohet, shoqëria ka krijuar zgjidhje të shpejta, rrugë të shkurtra si televizioni, kompjuteri e interneti... Ka njerëz që ngjiten në Pushtet se besojnë se tjetri ka nevojë vetëm për aq informacion sa të shpjegojë a mbështesë pikëpamjen e tyre...»

Janë një varg personash, e personazhesh në shënimet e Astrit Lulushit, shqiptarë e të huaj, që shfaqen e zhvendosen bashkë me kohën e tyre, kultura shqiptare thirret në paraqitjet e saj sa më dinjitoze, pandashëm nga fjala si kumt, letërsia si fisnikërim. Mes realitetit si privim e dhimbje për autorë apo figura publike shqiptarësh në vendin e tyre,

Librat e Astrit Lulushit janë një varg shkrimesh, esesh, shqyrtime, analizash ku autori shfaqet si njohës i thellë, por edhe parathënësi se ç'mund të ndodhë, nëse nuk ndodh ç'dëshirojmë. Nëse për lexuesin autori i ka plotësuar mungesat e dikurshme *in propria persona*, çfarë vazhdon të sjellë pohon të anasjellën. Gjithkujt i mungon diçka, gjithkund mungon diçka, sikur thotë me këtë lloj kthimi në vendlindje. Le të ndihim veten edhe tek tjetri...



QAL

ESM: Një biografi të shkurtër në vetë të parë?

Faruk BASHA: Kam lindur në Tiranë, më 9 shkurt 1940. Im atë ishte emigrant nga Kosova, ardhur në Shqipëri në vitin 1928, në periudhën e rrëmbimit të pasurisë shqiptarëve dhe dhënies së tyre kolonëve serbë. Në këto kushte, pasi mbaroi gjimnazin dhe u gjend përballë një rinie gjithnjë e më agresive serbe, u detyrua të kalonte kufirin për të gjetur strehë në Shqipëri. Qe me fat, sepse me ndihmën e shtetit shqiptar siguroi bursë për studime në Akademinë Ushtarake në Modena dhe, më pas, në Parma. Pas kthimit, shërbeu në ushtrinë shqiptare. Nëna ishte vajzë nga familja tiranase patriote dhe intelektuale. Këlliçi, larguar e sapolindur me familje në Turqi, dhe kthyer në moshën 8 vjeçare në Shqipëri. Xhaxhai i saj, Mytesim Këlliçi, ishte një rilindës i njohur. Kryemyftiu i Tiranës, Durrësit dhe Kavajës, pjesëmarrës i ngritjes së flamurit të pavarësisë më 26 nëntor në Tiranë, pjesëmarrës në Kongresin e Lushnjës në 1920-ën; kurse babai i saj, Masar Këlliçi, gjyshi im, u zgjodh deputet në parlamentin e parë shqiptar të vitit 1921. Ishte dashamirëse pasionante e librit dhe e filmit. Ajo kishte aftësi të mrekullueshme në ritregimin e ngjarjeve që lexonte apo që shihnte, duke bërë për vete të gjithë ata që e dëgjonin.

Në një mjedis të tillë linda dhe u rrita unë. Fëmijërinë e hershme e kalova gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe, ca pak vite pas përfundimit të saj, ndoqa shkollën shtatëvjeçare. Studimet e mesme i vijova në Politeknikumin "7 Nëntori" në degën e mekanikës, përkundër dëshirës për degën elektrike. Kisha dëshirë të madhe të studioja për operator filmi që kërkonte shkollë të specializuar jashtë shtetit. Mirëpo studiova pranë Institutit Pedagogjik "Aleksandër Xhuvani", në degën matematikë-fizikë. Duke e kuptuar se kinematografia do të ishte arti më me ndikim në popull, shteti komunist, pa marrë parasysh dëshirat e të rinjve në prag të studimeve universitare, planifikoi dhe dërgoi me bursa shtetërore në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e Evropës Lindore, disa studentë të caktuar prej tij, për të ndjekur studime kinematografike në akademi arti dhe departamente të artit skenik. Një bursë të tillë të endëruar, unë nuk arrita ta fitoja, për arsye biografie. Fillova punë në vitin 1959, si mësues fizike në një shkollë të mesme të Tiranës, pa lënë mënjane pasionin dhe ecurinë e dijeve për artin e kinemasë.

ESM: Për herë të parë emrin e Faruk Bashës e gjejmë te filmi "Vitet e para". Nisja dhe rrugëtimi i parë në Kinostudio. Si e kujton këtë fillim gjysmëshekulli më pas?

Faruk BASHA: Jeta ime, në çdo pjesëz të saj, nuk mund të shkëputet nga fotografia dhe kinemaja, që nuk mbetën thjesht pasion. Lidhja ime me aparatën fotografikë dhe filmin nis që në fëmijërinë e hershme dhe pasionin për to e kishte ndezur nëna ime, që jo vetëm lexonte shumë e ritregonte bukur, në varësi të moshës sime, por, nuk më ndau nga vetja kur shihnte filma. Tani, nga largësia e kohës, më duket sikur gjithçka që kishte të bënte me filmin, më ndiqte vetvetiu. Fare i vogël dhe krejt rastësisht u njoha me aparatën e projekcionit. Po kështu, isha rreth 12 vjeç, kur në rrethinat e Tiranës po xhiroheshin disa skena të filmit "Skënderbeu" të regjisorit të njohur, Sergej Jutkieviç. Kjo ishte njohja e parë me sheshin e xhirimit, ku mbeta i mrekulluar dhe këtë çast kam marrë vendimin për t'u bërë kineast me çdo kusht dhe asgjë tjetër. Po në këtë moshë më ra rasti të shfletoja koleksionin e revistës italiane "Cinema illustrazione" të viteve 33-34 e në vijim, gjithashtu, kam shkrepur aparatën fotografikë të huazuar, duke realizuar foton e parë.

Në vitet 1961-62 shërbeva si fotoreporter për revistën "10 Korriku". Një artikull që e shkrova rreth filmit "Debatik", më bëri të njihem me emrat e operatorëve Dhimitër Anagnosti e Viktor Gjika, të sapoardhur nga studimet jashtë shtetit. Detyrën e fotoreporterit e vijova edhe në revistën "Ylli",

## Fragmente nga një intervistë e gjatë me kinooperatorin Faruk Basha

# KUJTIM SPAHIVOGLI FIGURË SA MADHËSHTORE, AQ EDHE TRAGJIKE

Nga Enver S. Morina

revista politiko-letrare-artistike më e madhe dhe më me emër e asaj kohe në Shqipëri. Prita mbi pesë vjet për t'u hapur një vend pune në studio. Ndërkohë, dikush më thoshte që nuk mund të kisha të ardhme në studio, sepse kishte një numër shumë të vogël filmash. Dikush tjetër më thoshte: "Fillo njëherë. Për të hyrë në studio është zor, për të dalë është shumë kollaj". Asokohe në Kinostudio bëhej vetëm një film dhe kishte nevojë vetëm për një asistent. Megjithatë, nuk ndërrova mendje. Këmbëngulja në ëndrën time.

Me pak përvoja dhe me dëshirën për të punuar në fushën e kinemasë, në 4 prill 1964, fillova punë si ndihmës-operator në Kinostudion "Shqipëria e Re". Dijet e para praktike i fitova duke punuar pranë kineastëve Piro Milkani, Dhimitër Anagnosti, Viktor Gjika, që kishin kryer studimet në Pragë e në Moskë.

ESM: Fillimisht keni bashkëpunuar në filmat kryesorë artistikë të kohës, si "Vitet e para" (1965), "Komisari i dritës", (1966), "Oshëtimë në bregdet" (1966), "Duel i heshtur" (1967) dhe "Horizonte të hapura" (1968) si asistent-operator. Bashkëpunimi me regjisorët Kristaq Dhamo, Dhimitër Anagnosti, Hysen Hakani e Viktor Gjika?

Faruk BASHA: Për mua ishte fat që punova me operatorët e sapoardhur nga shkolla të mira kinematografike të Budapestit, Moskës dhe Pragës. Prej tyre mora dijet e para praktike dhe teorike në biseda të shumta dhe të shpeshta, në vështirësi të gjetjes së materialeve për këtë art. Ndonëse kishin bërë shkolla të ndryshme kinematografike, dallohej individualiteti i tyre artistik, gjë që pasuronte dijet e mia. Pasi miratohej skenari i një filmi, caktohej edhe grupi i punës. Që në çastin e parë, fillonte të shkruhej skenari tekniko-regjisorial, gjatë përgatitjes së të cilit, regjisorin, në konsulencë me operatorin, krijonin platformën kinematografike të filmit që do të xhirohej. Anagnosti dhe Gjika kishin një të mirë të madhe, sepse diskutonin me zë të lartë për mënyrat e ndryshme të xhirimit,

që ishte një shkollë praktike më vete për ne të rinjtë.

Por krahas punës me ta dhe me kamerën, rritjen time profesionale e mbështeta në lexime të pandërprera dhe në studimin autodidakt të revistave dhe librave të autorëve të huaj për probleme të fotografisë, të filmit, të estetikës dhe të krijimit të tyre, që mudohesha t'i siguroja, jo pa zor, sipas ulje-ngritjes së gjendjes politike. Që kur zbulova për herë të parë revistat kinematografike në gjuhën italiane, nuk hoqa dorë prej tyre. Koleksionet e revistave kinematografike në rusisht, italisht, frëngjisht e anglisht që ndodhen në bibliotekën time të madhe, me gjithë vështirësitë e kohës dhe të sistemit, fillojnë që në vitet 60. Bashkë me leximet dhe vetëmësimin, kërkesat dhe pyetjet e mia, që në nisje të punës, ndaj Milkanit, Anagnostit, Gjikkës, Erebarës, Dhamos etj., për të perfeksionuar mjeshtrinë e operatorit, bënë që të krijohet hap pas hapi individualitetin tim.

ESM: E veçantë e asaj kohe ishte angazhimi i regjisorit dhe pedagogut në rolin e aktorit tek "Oshëtimë në bregdet". Kush është Kujtim Spahivogli për Faruk Bashën?

Faruk BASHA: Jo vetëm në atë kohë, por edhe sot mjaft regjisorë dhe pedagogë janë të angazhuar edhe me role nëpër filma. Kujtim Spahivogli është një figurë sa madhështore, aq edhe tragjike. U njoha me të gjatë xhirimeve të filmit "Oshëtimë në bregdet", që përbënte filmin e tretë të karrierës sime të saponisur si asistent. Bisedat e këndshme me të rreth artit e kulturës bënin që orët të kalonin duke mësuar përmes muhabetit; qenë orë të paharrueshme. Këmbëngulte të futesha në degën e aktrimit, por jo: ëndrra ime ishte të bëhesha operator. Kujtimi ishte aktor i shkëlqyer, regjisor teatri i paarritshëm, pedagog i mrekullueshëm, orator fjalëmbël, bashkëbisedues i shumëkërkuar. Por ah! Këto cilësi të mrekullueshme dhe arritjet në lëmitë ku zhvilloi veprimtarinë artistike, e bënë të futej në burg, I sëmurë e i braktisur, i harruar nga të gjithë prej frikës, ky regjisor,




aktor, dramaturg, pedagog, eseist, i lindur me talente mbi gjithë të tjerët, u shua fushave të Myzeqesë, duke shkaktuar tronditje të madhe tek të gjithë ata që e njohën si njeri dhe si artist.

ESM: Më tej operator kryesor në filmat e njohur, si: "Plagë të vjetra" (1969), "Mëngjeze lufte" (1970), "Malet me blerim mbuluar", (1971) etj. dhe, njëkohësisht, operator i disa filmave dokumentarë dhe kronikave. Mund të na thuash ndryshimet që ndodhën, sidomos në kapërcim të dekadës së dytë të Kinostudios nga viti në vit 1971, 1972 kur dhe u hetua një ndërhyrje e ashpër pas edicionit të 11-të Festivalit të Këngës në Radiotelevizion?

Faruk BASHA: Kinematografia është arti me ndikimin më të gjerë në popull. Për këtë arsye, shteti komunist i dha rëndësi zhvillimit të kinematografisë, që ishte një art i ri tek ne. Fillimisht u xhirua një film në vit, sepse kaq qe mundësia e aparaturave, e kuadrove dhe fuqia ekonomike. Me kalimin e kohës, numri i filmave erdhi duke u rritur dhe, shumë prej tyre pëlqeheshin si atëherë, madje edhe sot. Veçanërisht, pas revolucionit kulturor, kur u ndalua tërësisht shikimi i filmave të huaj, sipas modelit kinez, me qëllim që të jepeshin më shumë shfaqje, ndonëse Shqipëria është një vend i vogël, u blenë mjaft aparatura dhe u arrit të prodhoheshin rreth 12-13 filma artistikë në vit, veç dokumentarëve e kronikave.

Kinemaja u bë ndihmësi më i madh në propagandë e partisë. Prandaj filmat ishin shumë të kontrolluar, duke filluar që në fazën e shkrimit të skenarit, kështu, gabimet ishin të kufizuara, sepse ndreqja fillonte që në skenar. Veç kësaj, teorikisht, filmi duhej të kontrollohej nga këshilli artistik i studios, mirëpo, sipas fazave të ndryshme të politikës, organet drejtuese të Kinostudios, për të shpërndarë përgjegjësitë, kërkonin edhe mendimin e klasës punëtore, të organizatës-bazë të partisë së rajonit, etj. Nëse kishte mendime të tjera nga ato që shpreheshin në film, bëheshin korrigjimet e nevojshme, deri në rixhirime skenash. Shpesh kontrollat ishin ekstremiste dhe banale. Për shembull, në filmin "Përtej mureve të gurta", aktorese Esmë Agolli, që ishte e ulur në radhën e parë në një nga skenat e filmit, i dukeshin pak më shumë se gjuhët, gjë që u konsiderua shfaqje e huaj. Për këtë arsye u detyruam të rixhironim planin, duke hequr "shfaqjen e huaj".

Në fund, filmi shihej nga organet më të larta të partisë, të cilat jepnin vullën e shfaqjes së filmit në publik. Pra, ishin një sërë hallkash kontrolli deri në çuarjen e filmit te shikuesi i zakonshëm. Kjo ishte mënyra e punës në Kinostudio, prandaj nuk mund të them se pati ndonjë ndikim tjetër pas ndërhyrjes së ashpër të instancave të larta, që lidhej me edicionin e 11-të të Festivalit të Këngës në Radiotelevizion. Në shtrëngesa të këtij lloji, filmi herë shkurohej dhe herë zgjatohej, duke hequr apo shtuar skena që i shkonin më për shtat politikës së çastit. Rastiste që këto prerje të ishin më interesantet në film, por ishte politika e kohës së cilës duhej t'i ruheshe. Pati ndonjë rast që filmi u pezullua fare, si p.sh.: "Heronjtë e Vigut", filmi dokumentar "Të dielat në Tiranë", dokumentari "Gjirokastra", për mendimin tim një film poetik mjaft i arrirë. Në këtë kuadër, ndonjë regjisor u dërgua për edukim pranë klasës punëtore, por këto qenë raste sporadike. Ndoshta duhet thënë se, për





të qenë më lehtë brenda kornizave të kërkuara dhe më pak të gabueshme, temat e filmave, në shumicën e rasteve, ishin nga lufta nacional-çlirimtare ose nga historia. Shumë pak filma ishin me temën e ditës.

ESM: Gjatë njëzet viteve realizuar filma , si: "Në fillim të verës", "Tomka dhe shokët e tij", "Vajzat me kodele të kuqe", "Asgjë nuk harrohet", "Treni nisat në shtatë pa pesë", "Flutura në kabinën time", "Balada e Kurbinit" dhe të tjerë. Kinemaja përgjatë këtyre viteve?

Faruk BASHA: Përgjatë këtyre viteve, filmi shqiptar arriti kulmin e tij. Nga sasia relativisht e madhe e filmave, u pa e nevojshme që të realizohej Festivali i Filmit Artistik, me qëllim që të vlerësoheshin filmat nga pikëpamja artistike dhe të inkurajoheshin protagonistët. Në Festivalin e Parë, filmi "Në fillim të verës" mori kupën e festivalit si filmi më mirë i prodhimit të disave viteve të Kinostudios.

Mes 14 -të filmave artistikë që prodhoheshin në një vit, sigurisht, pati filma mjaft të arrirë dhe të tjerë më të dobët, por, e rëndësishme ishte që bëheshin filma me tema të ndryshme. Rreth viteve 80, veç filmave me temë nga e kaluara apo nga lufta çlirimtare, u kërkuar të shtoheshin numri i filmave me temë nga aktualiteti.

Në vitin 1981, kryeministri ynë vrau veten, gjë kjo që ndikoi tek unë për shkak të lidhjes së sime shoqeje me të fejuarën e djalit të tij. Qe fat që nuk më hoqën nga puna, por sigurisht, më mënjanuan. Isha në kulmin e aftësive profesionale. Për një periudhë 3-4 vjeçare nuk xhirova fare. Mirëpo, falë njohurive që lidheshin me njohjen e aparatave të kuadrore të kombinuara, më futën në grupin që do të zgjidhte dhe blinte këto aparatura, si njohës dhe specialist i vetëm i efekteve speciale. Në të njëjtën kohë, për shkak të zhvillimit të proceseve të reja në kinemanë e filmit të animuar, u lejova të punoja si kameraman dhe teknikien i efekteve speciale dhe trukeve në filma me kukulla, filma vizatimorë ose filma me regjisorë dhe operatorë të rinj, duke u ofruar përvojën time. Edhe këtu puna jonë u vlerësua duke fituar çmimin e parë në Festivalin e Filmit Vizatimor, po kështu edhe filmi "Zogu pushbardhë".

Me ndryshimin e drejtimit të studios, 1984, ndryshoi disa edhe qëndrimi ndaj meje. Viktor Gjika, duke mos gjetur asgjë me shkrim lidhur me urdhrin e dhënë ndaj meje, për periudhën 1981-84, më dha të drejtën për t'iu rikthyer xhirimit të filmit artistik. Veç xhirimit të filmave, risia në personalitetin tim në këtë fazë të zhvillimit të kinemasë lidhet edhe me specializimin për kuadrot e kombinuara dhe efektet speciale në film. Në vitin 1989 drejtori bëri gjithçka që të specializohesh më tej në Francë për kuadrot e kombinuara. Unë nuk jam drejtori i fotografisë në filmat që ju përmendni në pyetjen tuaj, si: "Flutura në kabinën time" (1988) dhe "Balada e Kurbinit" (1990), por kam realizuar një seri efektesh speciale te këta filma dhe në të tjerë, efekte të vështira atëkohë, por të lehta sot, me zhvillimin e teknologjisë.

(...)

ESM: Lidhjet me Kosovën? Takimi i parë me Kosovën? Njohja e kinematografisë dhe e filmit që krijohet në Kosovë?

Faruk BASHA: Kosova. Kosova. Do të më pëlqente të përdorej Dardania, emri i vërtetë i lashtë i tokës ku u rrit im atë dhe ku jetojnë gjithë njerëzit e mi me mbiemrin Basha. Kosova ka qenë e pranishme që në çastet e para kur fillova të kuptoj nga bota. E njoha atë përmes bisedave të përditshme me gjyshen, Celebie, në duart e së cilës u rrita, dhe me tim atë, rreth asaj toke të begatë: për njerëzit e saj, bukuritë, për malet madhështore, për natyrën e shëndetshme dhe të mrekullueshme, për tokën pjellore, për pyjet e burimet e madhërishtme e për çfarë jo. Më vonë, libri "Nëna Kosovë" i Samim Visokës më bënte të shihja me sytë e shpirtit atë tokë të vaditur me gjak heronjsh. Takimi i parë me Kosovën, thoni ju. Fillimisht u njoha me njerëzit e mi

më të afërt, axhat. Ishte viti 1972, isha 32 vjeç, kur filluan të vijnë vizitorë nga ish Jugosllavia dhe, fillimisht, xhaxhai i madh erdhi si turist. Grupi bëri turizëm një javë sipas programit për të parë ndryshimet që kishte bërë Shqipëria socialiste dhe pastaj i lejuan që të qëndronin disa pak ditë pranë njerëzve të afërt. Po u panë dy vëllezërit, ndarë që në vitin 1946, dhe unë u njoha me një nga njerëzit e shumtë të gjakut tim. Më pas pati lëvizje të herëpashershme, shumë të kontrolluara nga sistemi demon, por shpresonim më mirë në të ardhmen. Më vjen mirë që shkoi baba, i cili gjithë jetën u dogj nga malli për Pejën dhe për njerëzit. Po ishte qesharake, si e shoh tani nga largësia e kohës, fakti që kur e përcollëm dhe kur e pritëm, si kisha dalë unë me gruan, kishin dalë për ta përcjellë edhe ata babën deri në kufi. Mes kufirit ishte zona neutrale që shtrihej mbi një urë të zbratur, sepse nuk kishte asnjë lëvizje. Vizitorët dhe pritësit qëndronin 50-60 metra larg njëri-tjetrit dhe nuk lejohej as të bëje përsëritje me dorë. Fëmijët, që nuk kuptonin, ngrinin dorën instinktivisht. Si kaloi kufirin dhe u bashkua me ne, baba, pa bërë asnjë shenjë, na tregoi sipas renditjes njerëzit me radhë, duke na folur pranë veshit. Takim shumë i dëshiruar, por tejet e trishtë forma. Kishte ndonjë rast që ndonjë oficer kufiri më njerëzor, lejonte t'ua bënim me dorë fshehurazi. Përcjellësit ishin shumë, ne vetëm tre. Pranë kishim edhe valixhet me dhurata, përmes të cilave të afërmit dhe miqtë tanë atje, kishin dashur të tregonin dashurinë ndaj nesh. Ato valixhe u hapën dhe u kontrolluan një më një.

Vetë e kam pasë takimin e parë me Kosovën, Prishtinën, më saktë, në vitin 1981, i ftuar për të qenë në Festivalin e Këngës; qemë tre vetë: dy kompozitorë dhe unë, i kërkuar me emër nga Riza Alaj, drejtori i përgjithshëm i atëhershëm i Radiotelevizionit të Prishtinës, me të cilin kishim një lidhje farefisnore të largët. Po kjo është një histori më vete. Ashtu dimri, që të binte borë me aq shumicë edhe në Tiranë, nuk ishte parë ndonjëherë.

Kur sosëm në kufi, bora vinte mbi gju dhe dukej e pamundur të vijonim më tej. Po këmbëngula, s'mund të lija të më ikte rasti i shumëpëritur dhe, më shumë duke e shtyrë makinën, dolëm në rrugë të pastruar disi në anën tjetër të kufirit. Nuk ka pas më borë si atë dhjetor. Festivalin e gjetëm të filluar. Një e papritur tjetër e këndshme. Më njeh Pranvera Badivuku, kushërira jonë, pjesëmarrëse në festival, vjen e më takon (unë nuk e njihja, veç si emër) dhe ajo lajmëron axhën në Pejë. Erdhën të më njihnin e të më takonin mes asaj ftohtësie të motit e asaj bore, mbi dhjetë të afërm. Këto ditë, gjithsej 4, kisha merak të vizitoja, përveç njerëzve të mi, edhe Kosova-filmin; gjatë kësaj vizite më shoqëroi drejtori i fotografisë, Fatmir Bajrami. U njoha me kolegë të ndryshëm, mes të cilëve Afrim Spahiun, miqësia me të cilin zgjat edhe sot. Në Kosovë ka mjaft fotografë e operatorë, tanimë profesionistë. Disave u kam dhënë mësim në Prishtinë, në Institutin e Fotografisë dhe të Filmi "Gjon Mili", drejtuar nga Afrim Spahiun, disa të tjerëve u kam dhënë mësim në Akademinë e Filmit dhe të Multimedias Marubi, në Tiranë, drejtuar nga Kujtim Çashku. Ata kontribuojnë në zhvillimin e ecjen përpara të kinematografisë në Kosovë, por jo vetëm.

Kurse në Pejë, po këtë kohë ndenja vetëm dy orë. Me ndryshimin e kushteve politike, në Pejë shkova në vitin 1995, duke u futur nga Mali i Zi, që njihje pasaportat shqiptare. Ishte një takim me mbresë të pashlyeshme: po njihja të gjithë njerëzit e mi, me të cilët ishim vetëm disa orë larg.

Sa i përket njohjes së kinematografisë së Kosovës mund të them se, kur u përmirësuan disi marrëdhëniet me ish-Jugosllavinë, u bë edhe ndonjë veprimtari kulturore, si shkëmbimi i ansambleve popullore, orkestra simfonike e Prishtinës, shkëmbim profesorësh të universitetit etj. Në këtë kontest u zhvillua edhe java e filmit jugosllav; mes të tjerëve ishte filmi "Mbledhësi i puplave", film i njohur ndërkombëtarisht që u prit me shumë dëshirë

dhe entuziazëm edhe në Tiranë, për më tepër, se aktori kryesor ishte Bekim Fehmiu.

ESM: Për vizitën e aktorit Bekim Fehmiu në vitin 1972 gjithandëj?


Faruk BASHA: Qe një çast i keq për mua gjatë vizitës së aktorit të madh, Bekim Fehmiu. Them kështu, sepse e takova dy ditë para se të nisesha për një turne në Kinë me trupën e Teatrit dhe të Baletit Kombëtar. Drejtorja ftoi një grup kineastësh, rreth 15 vetë, të Kinostudios për t'u takuar me Bekimin, mes të cilëve isha edhe unë. Atë ditë u takova dhe atë ditë u ndava me të. Më njihje me emër. Madje, një çast qëndruam vetëm për disa minuta, sepse personi i dytë që ndodhej pranë nesh, u thirr nga drejtori. Ai vuri re disa pankarta në tabelën e reklamave të filmave të studios, në qendër të të cilave ishte pankarta e filmit "Skënderbeu". Tregoi interes të menjëhershëm dhe shkoi drejt saj. Duke ditur interesin dhe dëshirën që kishte për një film mbi Skënderbeun, i them me shaka, por jo pa dëshirë për t'u realizuar: "A po e xhirojmë bashkë një film për Skënderbeun?" "Ah, me dashtë Zoti, ma ktheu." Të nesërmen u nisa për Kinë. Bekimi bëri një turne rreth një javor, duke u njohur me sukseset e socializmit. (...)

ESM: Keni bashkëpunuar me regjisorë, si: Kristaq Dhamo, Piro Milkani, Dhimitër Anagnosti, Viktor Gjika, Gëzim Erebara, etj., me aktorë, si: Piro Mani, Sandër Prosi, Roza Anagnosti, Robert Ndrenika, Edi Luarasi, Vangjush Furrxi, Timo Flloko, Yllka Mujo, Viktor Zhusti, Ndreka Luca, Rikard Ljarja, Reshat Arbana, Sulejman Pitarka, Violeta Manushi, Naim Frashëri etj.

Faruk BASHA: Në një shesh xhirimi, për herë të parë, jam ndodhur kur po xhirohej filmi "Skënderbeu". Isha rreth 12 vjeç. Nga ai çast nuk iu ndava më sheshxhirimeve kur kishte plane që bëheshin në Tiranë apo rrethinat e afërta të saj. Dhe në këto ecejake isha njohur me regjisorët dhe operatorët e paktë të atyre viteve: Hakani, Anagnosti, Gjika, Milkani, Erebara. Prej dikujt merrja zemër të përpjekshme për të hyrë në studio, prej dikujt hidhërohesha. Por erdhi 4 prilli i 1964-ës, çast i mezipritshëm prej meje, kur shkela në Kinostudio si ndihmës-operator pas shumë përpjekjesh. Nuk kisha shkollë kinematografike, por ndihma e Taqos, e Viktorit, e Piro dhe studimi autodidakt bënë të mos e ndjeja mungesën e përgatitjes në shkollë të artit të kinemasë. Edhe shkolla që kisha kryer qe ndihmë e madhe...

Për punën me Naim Frashërin, aktorin e mrekullueshëm, dua të them se nuk mund të harroj çastet e xhirimit në filmin "Plagë të vjetra". Kishte luajtur te filmi "Skënderbeu", te filmi "Tana" me sukses dhe, pas disa vitesh qetësie nga filmi, u zgjodh të luante rolin kryesor te filmi "Plagë të vjetra". Mungesa në ekran prej ca vitesh dhe rikthimi në teatër i shkaktoi një emocion të papërmbytshëm, që u detyruam të ndërprisnim xhirimet për pak kohë, për të pirë një kafe e një cigare, deri në një përmirësim të gjendjes emocionale të tij. Edhe aktorët e mëdhenj nuk e kanë të lehtë të xhirojnë. Fatkeqësisht sëmundja e zemrës ia preu jetën dhe rolet e tij në filma janë të pakta, por kanë mbetur të paharrueshme dhe si pika referimi për aktorët e rinj.

\* Intervista është realizuar përmes e-mail-it, dërguar së pari bashkëshortes Luljeta Basha-Zhubi. Përgjigjet kanë arritur në fillim të qershorit 2021. Po ashtu Faruku më ka shkruar: "Për pyetjet 13 dhe 14 mund të gesh e të zgjedhësh material te libri i Suzana Varvaricës, që jua dërgova me mbesën time, Lule Basha." Në prill të vitit 2021 më dhurohet libri album "Faruk Basha, rrugëtimi drejt ëndrrës" i autores Suzana Varvarica-Kuka. Në shtator 2021 në Tiranë takoj Faruk Bashën me zonzjën Nermin Basha. Shkëmbyem dy libra. Librin "Rr'nimi i Arbërit" dhe veprën e Julius Caesar "Mbi luftën civile" të përkthyer nga latinishtja nga Nermin Basha.



## 1. QENDRA KULTURORE SHQIPTARE AMERIKAE NË TEKSAS

do të shkruante:

"Kishim nderin dhe kënaqësinë të mirëpresim në Qendrën e Komunitetit Shqiptar Amerikan në Dallas, Teksas, shkrimtarin, poetin, dhe atdhetarin e shquar Visar Zhiti, për promovimin e romanit të tij të fundit "Këpuca e Aktorit". Zhiti është një figurë e jashtëzakonshme letrare që ka lënë gjurmë thelbësore në historinë letrare shqiptare.

Për promovimin e librit, patëm një panel të jashtëzakonshëm, shumë prej tyre të ardhur nga Çikago për të qenë pranë nesh. Në këtë bashkëbisedim të pasur dhe frytdhënës, u shprehën mendime të çmuara nga paneli: Dr. Xhabir Alili, Taip Beshiri, Jani Gjoni dhe Bekim Ademi. I falenderojmë panelistët për ndarjen e njohurive dhe për kontributin e tyre në këtë diskutim të pasur.

Gjithashtu, shprehim mirënjohje të veçantë për të gjithë pjesëmarrësit që ishin prezent dhe që ndanë mendime gjatë diskutimit.

Shpresojmë të shihemi së shpejti në ngjarje të tjera të ngjashme që të pasurohem edhe më tej me kulturën tonë shqiptare."

\* \* \*

Në ditën e parë të ardhjes, para takimit, shkrimtari Visar Zhiti do të shkruante një prolog të tij:

## 2. NË RRUGËN KU U VRA PRESIDENTI

Në aeroportin e Dallasit, jashtë na priste një diell plot dritë dhe ngrohtësi, që sikur e shtonte dhe pritja z. Adil Besiri, burrit nga Kërçova që na mori me makinën e tij të bardhë e të madhe për të na çuar në restorantin e tij dhe pastaj të na shëtiste nëpër qytet...

- Dua të shoh rrugën ku vranë Presidentin John Kennedy, - thashë unë me një padurim të dhimbshëm, por i mbledhur kohë më parë.

Dhe aty shkuam. Pikërisht te vendi ku kishte ndodhur atentati i shekullit, i hatashëm, mu në rrugë kishin vënë shenjat, 4 ikse të mëdha: XX XX, 2 ku nisi dhe 2 ku mbaroi ai tmerr dhe ende mister. Ndalëm t'i shihnim ashtu të verdha si dëshpërimi, si gjarpërinj, sikur të kishin shkruar Shekullin XX, si kryqe.

- Ja, dhe taraca nga u qëllua, - po na tregonte Adili. Një re aty sipër m'u duk si fantazma e atentatorit. Në katin sipër ishte dhe muzeu, s'e di a ishte hapur, po s'doja ta shikoja, mjaftonte ajo ndjesi e rëndë si me plumbat pezull në ajër si zogj të ngrirë...

Njerëz nga trotuari, fotografonin ikset e çoroditura në rrugë: XX XX, pashë dhe fytyra të nemitura, por tashmë e gjitha kjo ishte histori. Po unë doja një kryq tjetër në muzg, një kishë, të bëja kryq, të lutesha...

Rota makinash i kalonin përsipër atyre kryqeve në rrugë si gjithkund, zakonshëm, si harrimi, si pamëshirshmëria, asnjë makinë s'prishej befaz aty, s'plaste asnjë gomë... mbase ndonjë zemër...si imja...

Edhe rrotat e makinës tonë kaluan aty me shpejtësi. Ura të mëdha dhe perëndim dielli si flakë... Qiellgërvitëse të kaltra si qielli. Po kërkoni skulpturën e Syrit, t'i shpëtonim syrit të keq. Dritnajtë. S'kishte më kryqe rrugëve. As president të vararë... Njerëz të lirë. Ishte mbrëmja e po kësaj date, kur unë u lirova... dikur... larg... nga burgu... kurrë nuk do të mund ta besoja atëhere, madje dhe mund të dukej çmenduri, nëse do të në thoshin se në një qytet të madh në SHBA, në Dallas, do të shikoje vendin ku u vra Presidenti Xhon Kenedi, ngjarje që do të më trondiste në fëmijëri dhe mua, kurse më pas, - e ç'rëndësi do të kishte viti, - do të përurohej romani im "Këpuca e aktorit", këtu, te ky qytet, mes shqiptaro-amerikanëve...

Pse kjo rendje drejt dramatikës? Të kërkosh të shohësh vrasjen e madhe, misterin,

# "KËPUCA E AKTORIT" SHKON NË DALLAS, SHBA...

- Mozaik nga takimi i shkrimtarit Visar Zhiti  
në "Albanian American Cultural Center of Texas" -

të mos e ndash dhëmbjen...

Apo kështë është dhe letërsia, ashtu nisi, a nuk na tregon Homeri vrasjet në fushëbeteja të ashpra, ku gjaku i derdhur arrin deri në ditët tona si lumë? Te Shekspiri të vrasin miqtë në shtëpinë e tyre në kështjellë, në gjumë...

Pse donte Visari të shikonte vendin e vrasjes së Presidentit Kennedy, i cili në një ditë të bukur si kjo, nga vetura e tij e hapur përshëndeste i qeshur popullin në rrugë dhe u dëgjuan tre krisma... A thua ajo jehonë vrasjeje ndjehet dhe në romanin e Zhiti, ku nuk vriten president, por populli.

Ndoshta në takimin për librin do të marrim ndonjë përgjigje...

## 3. TAKIMI

...do ta hapte Zv/Presidenti i Qendrës Kulturore Shqiptare Amerikane, z. Bekim Ademi duke u uruar mirëseardhjen shkrimtarit Visar Zhiti dhe miqve të tij nga Çikago të Klubit Shqiptar të Librit, zotërinjve Taip Beshiri, Xhabir Alili dhe Jani Gjoni, ndërkaq falenderoi veprimtarin z. Adil Besiri për mbështetjen dhe theksoi rëndësinë e takimit, por dhe bukurinë e tij, na ka bërë bashkë shqiptarë nga Republika e Shqipërisë dhe Republika e Kosovës, nga Maqedonia e Çamëria e Mali i Zi.

Po edhe romani "Këpuca e aktorit" këtë frymë përbashkuese ka, me personazhet e tij të kësaj gjeografie trojesh, që lëvizin mes përpjekjes dhe luftrash... - do të thoshte konferencieri i takimit, dhe do të shtonte se është vepra më e recensionuar e këtyre viteve. Dhe do të vazhdonte:

## 4. PROFESOR. GJEKË MARINAJ,

shkrimtar, kritik novator dhe poet, i përkthyer në shumë gjuhë të botës dhe me shumë çmime, - ai u arratis nga Shqipëria në vitin 1990 nga shkaku i përndjekjes për poezinë e tij metaforike, tashmë të njohur, "Kujt", dhe vjen në SHBA, diplomohet për Letërsi në Universitetin e Teksasit në Dallas, ndërkaq do të jetë themelues i Shoqatës së Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë dhe kryetari i saj i parë. - dërgon nga jashtë vendit letrën e tij në anglisht për të pranishmit në takim, që do ta lexonte e reja Ekaterina Gjoni, ndërsa në shqip i riu Arbër Kapllani:

Mirëmbërëma,

Z. Visar Zhiti, i ngjashëm me Charles Dickens në magnum opus-in e tij, "Një

përrallë e dy qyteteve", është emblematiku i një periudhe të karakterizuar nga kontraste të forta dhe tranzicione të thella socio-kulturore.

Ishte një kohë e shenjuar nga bashkëjetesa e përsosmërisë dhe mediokritetit, mençurisë së thellë dhe marrëzisë së vajtueshme, besimit të zjarrtë dhe mosbesimit të përhapur, shpresës iluminuese dhe dëshpërimin të përhapur. Megjithatë, diskutimi ynë nuk i përket Londrës apo Parisit; përkundrazi, ajo shpallet në kontekstin e Tiranës dhe Çikagos.

Nuk flasim për drejtësi poetike, por thellohem në sferën e rrethanave të jashtëzakonshme njerëzore. Visar Zhiti mbajti peshën kryesore të dënimit komunist si një individ që kundërshtoi me vendosmëri ideologjinë e tyre, megjithatë në Shqipëri postkomuniste ai u ngrit në pozicione të shqura duke shërbyer dhe si Ministër i Kulturës.

Në thelb të këtij rrëfimi, Zhiti shfaqet si një protagonist që kërkon me zjarr të mirën e qenësishme brenda njerëzve dhe botës në përgjithësi. Ai është një poet që përmbahet nga shqiptimi i fjalëve përçmuese për bashkëmoshatarët e tij, për njerëzit e tjerë ose për jetën e mundimshme që ka përjetuar, të mbushur me bekime dhe mundime.

Personalisht kam pasur privilegjin ta takoj Z. Zhiti një herë në Nju Jork, ndonëse në rrethana më pak se ideale...

Për fat të keq, nuk kam pasur mundësinë të lexoj romanin e tij të fundit, dhe kështu nuk mund të ofroj një vlerësim të rolit të tij në arenën e fiksonit.

Megjithatë, unë jam zhytur në veprat e tij poetike dhe mund të pohoj pa mëdyshje se ai renditet ndër poetët e mi të preferuar në arenën e Letrave Shqipe. I shpreh mbështetjen time të plotë për të si autor dhe arrijteve letrare të tij.

Për shkak të preokupimit tim me detyrimet akademike, ndodhem jashtë vendit në ditën e promovimit të librit të tij në Dallas. Më vjen keq që nuk marr dot pjesë në këtë takim domethënës. Si rrjedhojë, unë dërgova këtë fjalë si shenjë vlerësimi për audiencën e vëmendëshme, të mbledhur për t'i qenë pranë këtij shkrimtari dhe poeti të lartë. Vullneti i z. Zhiti për të udhëtuar nga Çikago në Dallas, që publiku të njihet me përpjekjet e tij më të fundit letrare, është e lavdërueshme dhe i uroj atij dhe audiencës shkëlqim dhe sukses në veprimtari.

Si përfundim shpreh urimet e mia më të përzemërta poetit dhe gjithë të pranishmëve.

Sinqerisht,  
Gjekë Marinaj, PhD  
UT/Dallas

5. NGA BIOBIBLIOGRAFIA E AUTORIT:  
Konferencieri, Taip Beshiri, lexoi një CV të Visar Zhiti, copëza nga jeta dhe vepra e tij:

"Është një nga shkrimtarët më të shquar bashkëkohorë, po kështu dhe veprimtar në çështjet shoqërore të aktualitetit shqiptar. [...]

Visari lindi në Durrës, ku kreu shkollën fillore, ndërsa gjimnazin në Lushnjë, ashtu siç shpërngulej i ati i tij. Diplomohet për Gjuhë dhe Letërsi në Institutin e Lartë Pedagogjik të Shkodrës dhe që student dorëzoi për botim përmbledhjen me poezi "Rapsodia e jetës së trëndafilave".

U emërua mësues në fshatrat e Kukësit, jo shumë larg kufirit shtetëror me Kosovën.

Kritikohet ashpër për poezitë e tij, deri dhe në Komitetin Qendror nga udhëheqja komuniste, arrestohet me akuzën "e agjitacionit dhe propagandas"... "për shtrembërime ideore dhe nxirje të realitetit me poezitë e tij hermetike, të trishta dhe kundër realizmit socialist".

E dënojnë me 10 vjet burg, me heqjen e të drejtës së botimit dhe të drejtës elektorale.

Edhe i arrestuar në qeli, ku nuk lehohej letra dhe pena, krijoi poezi me mend, ndërsa në kampet-burg të Spaçit dhe të Qafë Barit, në kushte të tmerrshme brenda telave me gjemba, teksa punonin si skllëvër në miniera, shkruante fshehurazi nëpër fletoret, që të burgosur të tjerë, miq dhe të besuar, i fshihnin përmes rreziqesh ose i mësonin dhe përmendësh.

Ai ishte në revoltën e të burgosurve politikë në Qafë-Bari, që do ta përshkruajë në një nga veprat e tij të mëvonshme. Arriti të nxjerrë fshehurazi nga burgu gati të gjithë poezinë e tij.

Pasi lirohet, punon si punëtor krahu në fabrikën e tullave në Lushnjë pa asnjë të drejtë, as atë të ushtrimit të profesionit të tij, mësues

Ndërkaq në dosjen e Visar Zhiti është dhe dokumenti që ai nuk pranoi të bëhej bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit, policisë sekrete të diktatures, por përballoi përndjekjet dhe kërcënimet me tjetër burg.

Kur nisi lëvizja për demokratizimin e vendit, bëhet pjesë e saj, është organizator i protestave të para për liri në qytetin e tij dhe bëhet gazetar në gazetën e parë opozitare, "Rilindja Demokratike", ku artikujt e tij u vlerësuan për shpalosjen e së vërtetës, guximin, frymën paqësore dhe rindërtuese.

Bën disa specializime jashtë vendit, kryen një stazh në Itali në gazetën më të madhe italiane "Corriere della Sera" në Milano, boton artikujt dhe atje dhe do të marre masterin në Universitetin "San Buenaventura" në Romë.

Kthehet dhe vendosen në Tiranë bashkë me shoqen e tij të jetës, Eda Agaj Zhiti...

Visari emërohet drejtor në shëpinë botuese "Naim Frashëri", nga ku i erdhi dënimi i dikurshëm,

Boton librin e tij të parë me poezi "Kujtesa e Ajrit" në 1993 dhe vlerësohet më çmimin e parë kombëtar.

Do të kalojë me punë në diplomaci, 2 herë shërben në ambasadën e Shqipërisë në Itali, pastaj në Selinë e Shenjtë në Vatikan dhe e mbyll karrierën diplomatike në Washington DC, SHBA,

Kanë qenë zgjedhur dhe deputet dhe është emëruar dhe Ministër i Kulturës.

Visar Zhiti është poeti dhe shkrimtari që nuk e ndali asnjëherë të shkruarit, kudo që të ishte. Pothuajse në çdo vit do të dilte një libër i ri i tij, në Shqipëri e Kosovë, në Maqedoninë e Veriut, (e Jugut për ne, - thotë Visari), etj, Krahas poezisë do të botojë tregime, ese dhe romane.

Të gjitha çmimet letrare më të larta që jepen në Shqipëri i janë dhënë dhe Visar Zhiti. Përmendim disa me të fundit:



“Dorëshkrimet e fshehta të burgut”, “Botimet Onufri”, Tiranë 2022, mori çmimin kombëtar, ndërsa përmbledhja “Si shkohet në Kosovë”, botuar në Prishtinë në 2014, ka marrë çmimet që mbajnë emrat e dy poetëve tanë të dashur: Azem Shkreli dhe Ali Podrimja. Do të merrte edhe çmimin “Beqir Musliu” në Gjilan, atë të Panairit “Shkup 2007”, “Dega e Ullirit” në Ulqin 2019, etj. Me romanet memuaristike “Rrugët e ferrit” dhe “Ferri i Çarë” do të merrte dhe Çmimin e Madh në Tiranë.

Poezitë e Visar Zhitit janë futur në tekste shkollash, në antologji të ndryshme, edhe botërore.

Librat e tij janë botuar dhe në vende të tjera, është përkthyer në të gjitha gjuhët e Ballkanit, në rumanisht nga Dr. Luan Topçiu ka 5 libra, poezi dhe romane, po kështu dhe në ato sllave, kroatisht, serbisht, sllovenisht, malaziase, sipas përkthimit nga pazetari dhe studiuesi Smajl Smaka, ndërsa në greqisht, nga poetë të ndryshëm. Poezitë e Visar Zhitit janë dhe në gjuhët frengjisht, gjermanisht, polonisht, holandisht, hebraisht, flamine, arabisht, ukrainase, koreane, esperanto etj.

Visari ka shumë çmime dhe libra në Itali, të përkthyer nga Profesori arbëresh Elio Miracco, ndërkaq ai ka botuar në 2005 në SHBA përmbledhjen me poezi “The condemned apple”, përkthyer nga albanologu i shquar Dr. Robert Elsie, por dhe poezi dhe ese të botuara në shtypin amerikan, përkthyer nga shkrimtarja Ani Gjika. Vepra të tij janë dhe në Bibliotekën e Kongresit Amerikan dhe së fundmi doli në Kinë, në 2023 përmbledhja me poezi në anglisht dhe kinezçe “Gathering light”.

Mbi 50 tituj librash, vepra origjinale apo dhe përkthime të autorëve të shquar si Federico Garcia Lorca, Mario Luzi, Adonis, Sebastiano Grasso, Evgeni Jevtueshenko, etj, mbajnë emrin e Visar Zhitit.

Një juri botërore me anëtarë nga Europa, Amerika e Azia, “The International Best Poets and Translators Prizes” në Kinë e shpalli Poet i Vitit 2023.

- Visar Zhiti është:
- Anëtar Nderi i Festivalit Ndërkombëtar “Ditët e Naimit” të Tetovës, në Maqedoni
  - Anëtar Nderi i Perhershëm – Qendra Kulturore “Nënë Tereza”, Miçigan, SHBA
  - Anëtar Nderi – Shoqata mbarëshqiptare “Bijtë e Shqipërisë”, Filadelfia, SHBA
  - Anëtar Nderi i Shkrimtarëve Shqiptarë në Itali,
  - Anëtar Nderi i Shkrimtarëve Shqiptaro-Amerikanë, SHBA
  - Anëtar i PEN Klubit në Itali.
  - Anëtar i Akademisë Internacionale të Arteve të Bukura, të Letërsisë dhe Shkencës “Alfonso Grassi” në Itali,
  - Anëtar i Akademisë “Mahai Eminescu” në Rumani,
  - Anëtar i Akademisë Europiane të Arteve,

Është dekoruar brenda dhe jashtë vendit:

- Me Urdhërin “Mjeshtër i Madh”
- Presidenca e Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2012.
- Me Medaljen e Artë të Meritës – Akademia Angelico Costantiniana, Romë, 2016.

- Me Dekorata e Shoqatës së Shqiptarëve të Rumanisë, Craiova, 2019
- Me Medaljen e Artë “Shën Nënë Tereza” – na Presidentja Vjosa Osmani, Republika e Kosovës, 2022

Është “Qytetar Nderi”, titull i dhënë nga Bashkia e Lushnjës, në Shqipëri.

Emri i Visar Zhitit është i përfshirë në enciklopedi dhe në Fjalorë Enciklopedikë në Shqipëri, në Enciklopedinë e njohur “Piccolo Treccani” - Itali, në Mbrojtëritë e Bashkuar, SHBA, etj.

Tani familjarisht jeton në Chicago, në shtetin Illinois, në SHBA

**6.**

**DR. JANI GJONI, nga fjala e tij:**

Romani “Këpuca e Aktorit” i shkrimtarit Visar Zhiti është një vepër e rëndësishme dhe



e vlefshme në peizazhin e letërsisë shqiptare sot. Ajo është shtesa e fundit në tërësinë e veprave të sjella nga Zhiti përpara publikut lexues. Nëpërmjet këtij libri, autori trajton tema të gjëra dhe komplekse që reflektojnë përvojën e tij të jetës dhe mendime të thella të artikuluar në mënyre poetike për njerëzit, vendin dhe historinë e Shqipërisë.

Libri është një arketip letrar, i krijuar me mjeshtëri nga Visar Zhiti, që çon lexuesit në një udhëtim të larmishëm dhe tërheqës në horizontin historik dhe shoqëror të Shqipërisë. Struktura narrative e tij mpleks në mënyrë të përsosur elemente të mitologjisë, besimit dhe historisë moderne, duke ofruar një eksplorim shumëdimensional të përvojës njerëzore në shoqërinë tonë.

Libri ndahet në tre pjesë kryesore të cilat janë rrjedhim i natyrshëm i ngjarjeve në kohë të ndryshme, dhe që nga faqet e para, lexuesi zhytet në një botë magjepsëse, e ngjashme me epikat homerike të mëdha. Prania e personazheve si Hektori, Moisiu, Maria, Hëna, Donika, Nënë Tereza krijojnë një tablo të gjallë, që lidh të kaluarën e largët me kohërat moderne.

“Këpuca e Aktorit” është në mënyrë simbolike udhëtimi në kohë i Shqipërisë nëpërmjet karaktereve e ngjarjeve të goditura, të përshkruara me mjeshtëri. Ndërsa lexuesit vazhdojnë të thellohen, ata zhvendosen jo vetëm në të kaluarën e largët, por edhe në periudhat e turbullta të Luftës së Parë dhe Luftës së Dytë Botërore, ku fati i Shqipërisë dhe i popullit të saj varet në kufijtë e një realiteti delikat. Narrativa mjeshtërore e Zhitit nxjerr thelbin e çdo ere me detaje të kuptueshme për këdo. Përjetohen vështirësitë dhe sakrificat e individëve të kapur në marrëzinë e luftës, jetët e tyre të përpjekura me fatet e kombëve [...]

Autori shkel qetësisht tabutë e racave, kombësive dhe përkatësive tribale, duke ecur në territorin e egërsisë njerëzore, por pa e tejkaluar në kufinj të vulgaritetit. Gjuha e pasur e shkrimtarit dhe ngjyrat e fuqishme që përdor krijojnë një tablo dhe një përshkrim romantik të Shqipërisë në fillimet e saj në shekullin e 20.

Një aspekt i rëndësishëm i librit është stili i Zhitit, i veçantë dhe unik. Ai shpreh ide dhe emocione nëpërmjet fjalëve të thjeshta e simbolike, duke krijuar një atmosferë... Shqipja e tij është e pastër dhe e qartë, ai përdor imazhe të fuqishme...

Në përgjithësi, libri “Këpuca e Aktorit” është një vepër e thellë dhe e frymëzuar nga ndjenjat patriotike. [...]

Ky libër ofron një perspektivë mbi identitetin, artin dhe kuptimin e ekzistencës së njeriut, duke bërë që lexuesi të reflektojë dhe të mendojë në mënyrë racionale për çështjet e shumta që preken.

...karakteret jepen si pjesëtarë të një trupe teatrale, të cilët luajnë rolet e tyre në skenën e jetës. Për ta, jeta është një teatër i madh, ku secili prej nesh luan një rol të veçantë...

Tensionet dhe kontradiktat e identiteteve në liber, përfaqësojnë ndjenjat e humbjes,

ndarjes, frikës dhe dëshirës për të gjetur qëllimin në jetë. Duke ndjekur rrugën e tyre, ata përballen me sfida të ndryshme... Shkrimtari shprehet - se roli që kemi në jetë nuk është gjithmonë i vullnetshëm, por ndonjëherë imponohet nga pritshmëritë e jashtme dhe rrethanat në të cilat jetojmë. Për shkak të kësaj, karakteret përjetojnë konfliktin midis pritshmërive të jashtme dhe dëshirave të tyre të brendshme.

Një tipar tjetër interesant i formës është kalimi i shkrimit në korsiv - italik. Ky ndryshim edhe stilistikor krijon një lehtësi në të ndjerit të ndryshimit të mendimit nga një kohë në tjetrën. [...]

Një nga aspektet më të rëndësishme të librit është paraqitja e diktaturës komuniste që mbajti Shqipërinë në prangat e saj pas Luftës së Dytë Botërore. Pasazhet e qarta dhe gjuha evokative e Zhitit paraqesin një imazh të thellë të atmosferës së frikës dhe shtypjes që mbizotëronte në çdo hapësirë të jetës së përditshme. Duke u fokusuar në përvojat e personazheve, autori zbërthen ndikimin e thellë të sundimit totalitar mbi psikën njerëzore si dhe ankthin dhe luftën e brendshme që përballen individët. Frika e dhunës dhe propaganda djallëzore krijuan dyzimin e personalitetit të njeriut, pasojat e së cilës ndjehen akoma. Ndonëse nën diktaturë njerëzit nuk ndaluan të jenë humanë duke shprehur mirësinë, gëzimin, dashurinë, emocionet si tipare qenësore - diktati nuk e vrau dot njeriun.

Mardhëniet intime të personazheve nëpër sfida të ashpëra të diktaturës shpalosen qartë në libër si një revoltë natyrale që nuk pyet për kufinj të artificialë.

Autori paraqet panoramen e diktaturës në mënyrën më të plotë dhe objektive... Mbi të gjitha, ai i nxjerr në pah vlerat dhe bukurinë e shpirtit njerëzor, të cilat nuk mund të bllokohen as nga diktatura më e ashpër.

Post diktatura, pas viteve 1990, e rrëmben Shqipërinë në rrejdha e stuhi, në të cilat inertësia dhe nostalgjia e kohës së diktaturës trazuan për një periudhë jo të shkurtër jetën e shqiptarëve. Shoqëria përjetoj absurde dhe mashtrime nga njerëz të ndotur prej së shkuarës që u prezantuan si fytyra e së ardhmes, duke ngadalësuar e penguar zhvillimin demokratik të vendit.

Në romanin e Zhitit vijohet me brezin e ri, me fenomenet e dallgët që e tashmja po përballen, me ndryshimet gjeopolitike e shoqërore, me historinë e re moderne që po jetojmë. Kufijtë e shteteve pothuajse janë venitur, globalizmi me virtualitetin kibernetik ka çliruar mundësitë për komunikim të gjithanshem, lëvizja e lirë ndërthur jetën e Irisit, vajza shqiptare nga Çikago, një nga personazhet kryesore, në skenën e reja.

Ngjarjet natyrshëm shkojnë në kontinentin tjetër, SHBA, dhe kthehen, lëvizin nga një qytet në tjetrin, personazhet lundrojnë me emocione e ndjenjat e reja, tashmë pa diktat, në një hartë më të madhe. Natyrshëm personazhet përfundojnë në

Ukrainën e sotme konfliktuale. [...]

E gjithë ngjan si një monolog i gjatë i Hektorit, personazhit qendror, dhe na vjen si një film personal.

Në përfundim, libri “Këpuca e Aktorit” është një vepër e mrekullueshme letrare, me sy të mprehtë kritik e ndjenja të fuqishme njerëzore, që na ofron një pamje të pasur dhe tërheqëse të historisë dhe identitetit të Shqipërisë, duke e trajtuar atë me një ndjeshmëri, me delikatesën e penës dhe fantazinë hyjnore të shkrimtarit.

**7.**

**DR. XHABIR ALILI, nga fjala e tij:**

Unë poetin, shkrimtarin, humanistin, të persekutuarin politik, atdhetarin, diplomatit Visar Zhiti e kam njohur relativisht moti, nga shtypi, më vonë nga interneti, nga poezitë e bukura atdhetare për Kosoven, për shqiptarët, për lirinë, dashurinë dhe bashkimin... tash si sonte këtu, në Amerikë, na afroji, na miqësoi kuvendi, ku bashkohen shqiptaret - aty ku na bashkon dashuria për vendlindjen dhe atdheun.

Me disa njihemi, me të tjeret do të njihemi sonte. Na bashkon shkrimtari ynë i madh, Visar Zhiti, dhe romani i tij “Këpuca e Aktorit”.

“Këpuca e Aktorit” është si një libër historie kombëtare, i emocionit të saj, një libër psikologjie njerëzore, është një dramë dhe një komedi e atdheut, është një tragjikomedi... është të gjitha së bashku dhe me shumë!

“Këpuca e Aktorit” është një teatër i madh me skenë dhe pa skenë, teatër në të cilin aktori real dhe metaforik bën rrugëtimin në skenë dhe në jetë. Rrugëtimin me një këpucë, me dy këpucë o pa këpucë; këpuca si përkufizuese e hapit dhe e shpejtësisë së ecjes.

Me mbylljen e kopertinës së fundit, u hapen dyert e mendjes për meditim, për rrugëtimin individual njerëzor dhe atë kombëtar dhe për “këpucën” metaforike, që e mbathim në rrugët e jetës, me të vërtetë, por dhe si bekim dhe si mallkim...

“Çdo vend ka teatrin që meriton” - na thotë dhe na këshillon autori.

Libri është i këndshëm në lexim, ka tregime, ku ka miresi, ka dashuri, ka erotikë të njerëzishme, ka mençuri jete, ku mund të mësojmë, ka tradhti, ka humor të holle dhe ka plot thënie origjinale, që burojnë nga mendja dhe nga shpirti i autorit Visar Zhiti... ja, njëra tronditëse:

“Viti '97, vit kur armatosen shqiptarët, dhe u çarmatos Shqipëria” apo një tjetër komike: “Menya është libri i vetëm që lexojnë politikanët” etj, etj.

Jemi me fat që e kemi në mesin tonë autorin, por dhe protagonistin, aktorin, artistin - “Këpucën e Aktorit”, lexojeni dhe do të kënaqeni.

Falemnderit që ndatë kohë të jeni sonte me ne... jemi mirenjohes. Puna është e mire, se puna i duhet jetës, por kur ndan kohë për shoqërinë - është dhe kjo jetë!

Ndryshe nga sa është e zakonshme, Npërfundimi i leximit të veprës „Kompozitori Bojan Adamiç në Shqipëri“, të Profesor Vasil Toles, është një fillim, pasi e bën thujtë të detyrueshëm një kthim *da capo* mbi ballinën e librit. Aty gjendet portreti i një njeriu ende të ri në moshë, që interpreton mbi piano, pamja e të cilit të bën të mendosh mbi energjinë krijuese, që mbledh gjithçka te një njeri.

Gjithë sa ai zotëron, kryhet në një kohë të shkurtër, thua se Adamiç parandjen se mundësia e dytë nuk do të ekzistojë dhe rrethanat nuk do të përsëriten kurrë më.

Jeta dhe krijimtaria e tij artistike ndërthuret me historinë e rritjes së një kulture, që përpjket ta tejkalojë prapambetjen edhe përmes edukimit muzikor.

Nuk është hera e parë që shqiptarëve u propozohet tejkallim i realitetit përmes muzikës. Rast i mëhershëm është përpjekja e Fan Nolit, që punon për zyrtarizimin e jetës muzikore në Shqipëri - „hollësimin e shijes... me harmoninë e tingujve“ - duke i njohur këtij arti rolin qyteterues për një komb.

Ky rol dëshmohej edhe nga përpjekjet e Bojan Adamiçit në Shqipëri, shprehur përmes kritereve shkencore të historiografisë në librin që kemi në dorë. Studimi paraqet një reflektin kritik mbi kompleksitetin e marrëdhënies shqiptaro-jugosllave në një realitet të ri ndërkombëtar. Është periudha kur ideologjia komunare e „barazivëllazërisë“ gjallërohet, koha kur „miqësia“ përjeton kadencën e vet dhe kur arti, posaçërisht ai muzikor, kërkon hapësira lirie për t'u shprehur.

Objekti studimor i veprës qarkon zhvillimet e Shqipërisë në momentin kur Jugosllavia fqinje - shteti i parë me të cilin vendi ynë lidh marrëdhënie diplomatike pas çlirimit - ofron potencialet e veta për të ndihmuar shqiptarët në tejkallimin e mungesave dhe vonesave historike në ekonomi e kulturë, sidomos.

Modaliteti i ofertës, shkruar në kushtet e një kontrate mes perandorakes dhe provinciales, sjell në kujtesë esenë filozofike „Kombet e vogla e të mëdha“ të poetit, mendimtarit dhe politikanit sloven Edvard Kocbek. Teksti i këtij dëshmitari të epokave të errëta të kontinentit, bëhet shpjegues kur shprehet se „nuk ekziston dallim thelbësor midis gjuhëve apo kulturave të vogla e të mëdha, sikurse nuk ka dallim midis një kombi të pjekur dhe një individi të realizuar. Të dy duhet t'i tejkalojnë kompleksitetin e tyre..., në mënyrë që të bëhen të aftë për të jetuar në bashkësi të vërtetë me të tjerët“.

Me këtë mendësi europiane mbërrin në Tiranë Bojan Adamiç, në fillimin e një epoke ndryshimesh që, mbi parimet e drejtësisë, premtoi të vendosë rregull pas Luftës së Dytë Botërore.

Çfarë mund të kërkonte më shumë se kjo klimë një artist i ri në hyrje të një kohe për të cilën ai kishte luftuar? T'i jepej rasti të kishte planetin e tij. Kjo mundësi i kishte ardhur, ndaj dhe në të gjitha përpjekjet e veta Adamiç i ngjan solistit që, pasi ka marrë një „LA“ akorduese, shpalos veten si pianist, dirigjent, orkestrues, kompozitor, ekspert i muzikës, por dhe si regjistruar i vëmendshëm i ngjarjeve mes shteteve dhe i ndodhive njerëzore.

Dëshmitë e veprës - mbështetur në zëra të gjerë arkivistikë e bibliografikë - shumica e të cilave i shfaqen lexuesit për herë të parë, janë pjesë e kërkimeve sistematike të autorit për qartësimin e marrëdhënies së shqiptarëve me kulturën e tyre muzikore dhe hapjen e saj ndaj botës.

Më herët kjo marrëdhënie është dëshmuar përmes studimeve të tij etnomuzikologjike dhe monografive, por sfida modelore e veprës „Kompozitori Bojan Adamiç në Shqipëri“, nuk është thjesht narrativa mbi *Tjetrin*, por tejkallimi i *Vetes*, për ta bërë *Tjetrin* pjesë të historisë tëndë.

Mundësia e ndërtimit të *Vetes* pa *Tjetrin*, që tradicionalisht është vështruar si rezultat i përpjekjeve kolektive të vendasve dhe si akt rezistence të periferive ndaj qendrave, në këtë studim është tejkalluar, duke e

# KOMPOZITORI BOJAN ADAMIÇ NË SHQIPËRI

Nga Arian Leka

konsideruar „të huajën“ një proces pasurimi.

Në këtë aspekt, ndonëse jashtë referencave, vepra rri pranë përfytyrimit të filozofit Michel Foucault mbi *Tjetrin* real dhe imagjinari i cili, në një mënyrë a në një tjetër shndërrohet në përfaqësim kulturor, siç ndodh me kompozitorin sloven në Shqipëri, i cili i ka vënë vetes „vetes detyrë që ta kryej sa më mirë punën“.

Faktet ekspozojnë botën shqiptare në sytë e një *Tjetri*, si Bojan Adamiç, që vëren me realizëm se me instrumentistët dhe repertorin aktual, shpresa për një orkestër të nivelit evropian ishte utopi, por nuk duhej hequr dorë dhe duhej punuar „për një orkestër të vërtetë të së ardhshmes“.

Dëshmi të tilla provojnë se, kur vjen fjala për artin, Adamiç është i çliruar nga kompleksi i etnisë, pushtetit socio-politik dhe sundimit kulturor. Në këtë këndvështrim orkestra shndërrohet në institucion besimi dhe në një metaforë të Adamiçit, që besonte në zhvillimin e një Shqipërie të së ardhmes, jo vetëm në aspektin muzikor, ku ai ndihmoi me gjithë sa mundi, për të dhënë më të mirën.

Kufitë e njohjes së *Tjetrit* japin shkas edhe për takimin me Vetën, në përpjekjet e kulturës shqiptare për të ndryshuar përmes individëve dhe institucioneve, në një moment historik kur Perëndimi dhe Lindja konkurojnë sërish mes tyre për hapësirën politike, sociale e kulturore.

Teksti ofron analizimin e thelluar të gjendjes së Shqipërisë në ato vite, sidomos në aspektin muzikor, duke i shfaqur të plota kërkesat për ta kaluar këtë art nga gjendja „adagio“ e „amanëve turke dhe kanconetave italiane...“, drejt krijimit të një

muzike kombëtare“, që përfytyrohej si një „alegro“ optimiste, por ende jashtë urdhërit të realizmit socialist.

Modeli i hulumtimeve mbi kontributet e Bojan Adamiçit në Shqipëri, në studimin e Vasil Toles ndërthur disiplina të tilla si historia politike e shteteve, politikën dhe marrëdhëniet kulturore në Ballkan, historia e muzikës dhe e institucioneve politike e muzikore shqiptare, letërkëmbimi, qëmtimi bibliografik apo akivistika e dokumentit epistolar e fotografik, ofruar si fakt dhe artefakt.

Autori ka arritur te depërtojë në thelbin e tyre, duke i integruar si dije, për t'i bërë pjesë të një shkolle ndërdisiplinare studimi, pa të cilën organizimi i lëndës do të ishte jo i lehtë.

Falë kësaj optike, vepra sfidon hierarkitë e zhanrit dhe ekspozon tematikën, stile e teknika shkrimore me disa vatra, që hyjnë në dialog mediumesh me njëri-tjetrin.

Dokumenti zyrtar, si kujtesë shtetërore, plotësohet nga letërkëmbimi dhe ky fundit nga qëmtimi i ngulmet mbi atë që publicistika dhe memuaristika shqiptare ka regjistruar, si në rastin e prurjeve të Petro Markos lidhur me atmosferën e politizuar të kohës kohës apo shënimet e Lasgushit Poradecit mbi jetën koncertore në hotel Dajti e në Tiranë.

Është parimi kronologjik ai që i ka renditur dëshmitë sipas një sistemi dhe ky sistem e bën të lexueshme logjikën që e vendos kompozitorin sloven në qendër të narrativës mbi ndodhitë muzikore të një vendi si Shqipëria e viteve 1947-1948.

Falë këtij rendi hierarkik, lënda e gjerë dhe komplekse e këtij libri ruan drejtpeshimin. Asnjëanësia shkencore rri si kriter përballë dëshmisë, për të garantuar paanshmërinë si




ndaj mbivlerësimit ashtu edhe shpërfilljes së të fakteve, pavarësisht se nga cilat zona historike mbërrijnë. Prej tyre buron informacioni i begatë mbi gjithë sa meriton të jetë e historike në jetën e Adamiçit, duke filluar nga teksti i parë i tij, shkruar tri ditë pas mbërritjes në Shqipëri, më 5 maj 1947.

Dhe *Histori*, në përfytyrimin e studuesit Vasil Tole konsiderohet gjithë sa përftohet prej dokumenteve/akte dhe shënimeve tërthore, kur realiteti pasuron ngjarjet me ndodhitë e protagonistëve, duke i paraqitur ato si histori njerëzish, që trashëgojnë kujtesë dhe krijojnë rituale të reja.

Në këtë kuptim vepra ofron mundësinë që t'i qasemi realitetit nga dy kënde plotësuese: prej qëndrimit zyrtar - shprehur prej dokumentit të interpretuar dhe prej praktikave jetësore - shfaqur përmes letërkëmbimit të Bojan Adamiçit me Barbara Çerçiç - bashkëshorten e tij.

Trajtimi i epistolarit si pjesë të Historisë ka në themel metodologjinë që e koncepton historianin jo si gjykatës, por si vlerësues. Këtë barazlartësi ka ruajtur autori në qëndrimin e tij ndaj Adamiçit që, tekta jep koncerte nëpër qytetet shqiptare, „tërë kohën i veshur me kostum popullor... mëndafsh e flori“, kostumi i cili, sipas tij është „kostumi më i bukur kombëtar në botë“, ofron përshkrime mbi vendin ku jetojnë njerëz që si karakteristikë të përbashkët kanë se „të gjithë e duan muzikën“.

Prej këtej, Bojan Adamiç bëhet baketa që dirigjon jo vetëm kontributet e veta interpretuese: nga zë i parë në kor, te pianisti solo, aranzhuesi i këngëve partizane me frymë xhazi apo i krijimtarisë së kompozuar në Shqipëri.





Përpunimi i brumit të miteve dhe legjendave në magjen e prozës artistike është një dukuri botërore që ka luajtur një rol të rëndësishëm në përcjelljen e ngjarjeve dhe karaktereve në konvejerin e shekujve. Shkrimtari kosovar Rushit Ramabaja para gjysmë shekulli dhe shkrimtari i ri Ervin Nezha para dy vjetësh kanë provuar ta bëjnë këtë përpunim me këngën e Gjergj Elez Alisë. Me këtë sprovë Ervin Nezha ka dëshmuar se ka gjetur mjetin e vet më të përshtatshëm për të hapur shtegun e vet letrar në xhunglën e egër të krijimit, ka hedhur në tregun letrar mjegullën jo vetëm në titullin e librit, por edhe fund e krye legjendës, mjegullën si tipar të qëndrueshëm natyror të një qyteze malore, mjegullën si metaforë e kompleksitetit që krijon raportin e shqiptarit me pushtuesin dhe mes vetë shqiptarëve.

Vepra e Nezhas fillon me kalin dhe kalorësin që në dy fjalitë e para të saj, një përdorim që lidhet me kontekstin historik të legjendës për Gjergj Elez Alinë, kohë kur terreni pushtohet me patkonjtë e kuajve të luftës dhe fati i betejës përcaktohet nga forca e krahut që përdorte shpatën, shtizën, tarozgën apo topuzin. Ramabaja i qaset legjendës duke i dhënë mjaft hapësirë marrëdhënies mes njeriut dhe kafshës, rifillon që nga vdekja e Elezit, kur Gjergji ishte ende fëmijë, rrjedhimisht fasha dyditore e këngës shtrihet në vite dhe kali mbetet brenda tipareve legjendare. Nga katër elementët bazë të jetës autori përdor tre për rijetësimin e legjendës: fillon me ujin, vazhdon me ajrin dhe përfundon me zjarrin. Nezha operon ndryshe, parapëlqen vetëm elementin e katërt – tokën, ndryshe nga kënga, nuk ka ndonjë marrëdhënie të veçantë mes Gjergjit dhe kalit, njeriu nuk e ndan suksesin me kafshën, edhe pse në një mjedis me orë, zana, shtriga e shtojzovalle kjo do të kishte mirëkuptim. Kalorësit hipin e zbresin, ndërsa kuajt e përmbushin misionin e tyre me trokthin dhe hingëllimat në udhët e ngushta që zgjaten buzë humnerave.

Nezha është më i kursyer në kohë, i mjaftojnë vetëm një numër takimesh që limitohen ditë pas dite, nga kërkesa e gjeneralit për bisedime me dukën vendas, deri në skadimin e afatit dhe përmbylljen me ftesën kalorsiake për duel. Gjithsesi, nuk është një ngjarje rastësore, por një përpjekje e përhershme e pushtuesit venedikas për të vjelë taksat me hir a me pahir. Është zbritje me këmbë në tokë jo vetëm nga identifikimi i Naltinisë si vend dhe hedhjes dritë mbi peizazhin e tij, por edhe vështrim real i marrëdhënieve ndërkombëtare si proces i paraqitjes së kërkesave të njëjës palë shoqëruar me kërcënime, ashtu siç ndodh edhe sot me sanksionet. Kjo e çon autorin dhe lexuesin në retrospektivë për një ballafaqim të mëparshëm me gjeneralin Teodato Zorzi pa një prerje kohore në shiritin mijëvjeçar të Republikës së Venedikut, po sigurisht para se në skenën e historisë të ngjitet Kastrioti. Është një kurth i dyfishtë dhe i mençur që ngre Gjergj Elez Alia për robërit në një zonë që del jashtë kornizës së këngës, është çlirimi i parë i fantazisë së prozatorit për të zgjeruar trasenë mbi të cilën do të rinisë udhën legjenda, është demonstrimi i parë i mençurisë në interpretimin e materialit: “Njeriu ka lindur me një dashuri të madhe për veten dhe ndonjëherë kjo dashuri që shpërthen brenda në një çast dobësie, kur kërcënohet ekzistenca, bëhet perde edhe për krenaritë më të forta.” (f.13) Ka një largim të guximshëm nga legjenda kur dashi i pjekur, vajza e përdhunuar, kreshniku i vranë, krahina e djegur zëvendësohen me futjen e një prifti si ndërmjetësues për bisedime mes palëve sepse “administratori i ri i këtij territori nuk donte të qeveriste një tokë pa njerëz.” (f.20) Një gjetje e zgjuar e autorit është thirrja

“Erërat që trazojnë mjegullën” nga Ervin Nezha, Albas 2022

## LEGJENDA QË RINDIZEN DHE SHKËLQEJNË ME HIR

Nga Kosta Nake

në skenë e Monun Stazit, komandantit të kullës dhe krah i djathë i Gjergjit, por edhe një personazh i bindur nën urdhrat e autorit për të injektuar pikëpamjet e veta që aludojnë për ngjarje moderne dhe njerëz bashkëkohës. Shërbimi i djalit të ri pranë Gjergjit dhe motrës së tij Naisina, natyrisht mund të prodhojë një romancë, por ardhja për bisedime e gjeneralit venedikas Marko Gali dhe mjegulla e takimit të tij vetëm për vetëm me Naisinën, nuk mund të mos shkaktojë xhelozie të Monuni, gjë që e shtyn drejt një akti të nxituar që bie në kundërshtim me kodin e nderit në marrëdhëniet me të huajt.

Transformimi i këngës në prozë të gjatë do të kërkonte edhe degëzime legjendash që i ngjiten trungut kryesor, siç janë humbja e djallit në mjegull duke ndjekur një nuse, takimi i motrës së Gjergjit me fallxhore dhe bashkëpunimi me shtojzovalle, gëlltitja e një gogle dushku prej një vogëlushi që i shkaktoi mbytjen, pastaj nga varri i tij mbiu një filiz ku shkon motra që lindi më vonë dhe demonstroi dashurinë e motrës për vëllanë që kalon çdo dashuri tjetër. Edhe zëvendësimi i blirit me dushkun më duket si një prirje pozitive për të futur diçka nga vendlindja e autorit.

Kur je përballë një armiku që kërkon dhe nuk je i gatshëm t'i japësh asgjë, taktika e parë që duhet zgjedhur përpara përplasjes së pashmangshme është shtyrja e luftës së më gjatë që të jetë e mundur për ta shfrytëzuar çdo ditë paqeje për t'u përgatitur për ditën më të keqe. Shtyrja e javës së parë vjen si marrëveshje xhentëllmenësh, edhe pse gjenerali ka një mik, Abelerio Ponten, që shikon te kjo shtyrje edhe çmendurinë, edhe dashurinë. Marko Gali që kishte ardhur me një mision të përkohshëm, tundohet nga ideja e qëndrimit në Naltini sepse ka pesë arsye të mjaftueshme: miqësia që krijoi me priftin, përshtypja që i la takimi me vajzën e vogël që përqafonte vëllain-dushk, ndershmëria e banorëve vendas, ndjenja që i shkaktoi Naisina e bukur. Por mbresa më e jashtëzakonshme në sytë e gjeneralit ishte nderimi që tregonin vendasit për të vdekurit edhe kur ishin kufomat e armiqve duke kujtuar përdhosjen që i kishte bërë Akili trupit të Hektorit, kurse autori e përdor skenën e përcjelljes për të pasqyruar diçka nga gjama e cila më futi edhe mua në kthetra se më rierdhi përshkrimi që i ka bërë At Zef Pllumi te libri “Rrno vetëm me tregue.”

Vjen një çast dhe trysnia e legjendës bëhet e papërbalueshme. Plagët nëntëvjeçare të Gjergjit janë si një kështjellë e papushtueshme, si një lumë i pakapërcyeshëm, apo si një mal i pakalueshëm. Pritja ka një kufi dhe mund të kthehet nga tehu i mprehtë. Gjenerali i Venedikut i kërkon Gjergjit të heqë dorë nga pushteti dhe t'ia dorëzojë atij por ka dhe një kërkesë tjetër – Naisinën për grua me hir apo me pahir. “Kjo ishte pika që kishte derdhur gotën për Gjergjin.” (f.58) Autori kërkon një shpjegim të ndryshëm për atë hedhjen e menjëhershme të Gjergjit në këmbë duke e ftuar venedikasin në duel. Magjinë e shërimit dhe aftësinë për t'u përballur ia beson Naisinës e cila i ngjitet malit me dëborë për të gjetur trëndafilin e zi çudibërës. E mbajti lulen si kupë dhe hëna u mënjanua dhe prej saj filluan të pikojnë pika drite. “Pikat binin mbi lule, ndërsa hëna i ngjante një ene të verdhë, që vazhdonte të zbrazej, derisa një çast drita e hënës mbaroi.” (f.64) Kjo lule magjike bëri mrekullinë.

Ngjyra e kalit në këtë vepër përcaktohet si reflektim i një tradite të lashtë që e vendos vajzën-nuse mbi shpinën e një kali të bardhë dhe shkon më tej kur e kthen në mishërim të së mirës duke i kundërvënë kalorësin e hipur mbi kalin e zi. Naisina hip kalin e bardhë, kurse Monuni që i ndërlikon marrëdhëniet me venedikasin, edhe pse është krahu i djathtë i Gjergjit, hip një kalë të zi. Kjo antitezë rivjen me një forcë qartësisht të dukshme te dueli mes Gjergj Elez Alisë mbi kalin e bardhë dhe gjeneralit venedikas Marko Gali mbi kalin e zi.

Dueli kalorsiak vihet para dy sprovash që mund ta zhvlerësojnë. Monuni organizon një sulm të paautorizuar mbi venedikasin duke bërë që gjenerali Marko të mendonte se kishte besuar verbërisht te nderi i vendasve. Në se ai do të ishte vrarë, atëherë mund të interpretohej si shmangie e qëllimshme e duelit dhe pastaj Gjergjit duhej t'i këndohej një këngë turpi. Nga ana tjetër “Republikës së Venedikut i interesonte politika e saj e sukseshme dhe jo trimëria.” (f.72) Ky është një zhvillim interesant që i atribuohet tërësisht autorit dhe sjell atë mjegullën e ndërlikimeve të paralajmëruar që në titull: sulm i paparalajmëruar ndaj një misioni që ka zgjidhur rrugën e bisedimeve në vend të luftës, dënimi me vdekje të Monunit brenda një qerthulli kundërshtish, dorëzimi i vullnetshëm seksual i Naisinës te një njeri që nuk e pati dashuruar dhe do të varet, fshehja e dënimit për turmat dhe shpallja hero nga ata që e dënuan, përfshirja e priftit në bashkëpunim si pjesë e një loje të sofistikuar dhe së fundi një fund i ndryshëm nga ai i këngës – Gjergji nuk e gjen të motrën në shtëpi.

Dueli realizohet duke respektuar kodin e nderit, Naisina lë një trëndafil të kuq mbi varrin e Marko Galit, Gjergji që nuk vdiq nga plagët vdes nga lodhja e duelit, nga hidhërimi për vdekjen e Monunit dhe rrënimi i krahinës së tij, së fundmi edhe nga ikja e beftë e së motrës.

“Kah kërkova gjithkund bjeshkë e m'bjeshkë,

Kah verova gjithkund vrri e n'vrri,  
Kah mjerova gjithkund shpi e n'shpi,  
Kërkund s'ndesha m'Gjergj Elez Ali!”

Këto janë katër vargjet e fundit të këngës, por shkrimtari ka një përmbyllje të ndryshme. Ai është edhe analist dhe këtë e shpalos në epilogun e veprës. Një ushtri e huaj vjen për pushtimin e radhës disa vite pas vdekjes së Gjergj Elez Alisë, por largohet pas kryer asnjë aksion ushtarak. “Nëse nuk i sulmojmë, ata do të shkërmoqen vetvetiu... Kur ne të mos vijmë, ata do të hidhërohen, do t'i harrojnë të gjitha, do të harrojnë edhe veten dhe kur t'i harrojnë të gjitha, do ta harrojnë edhe atë, sepse ai thjesht nuk do t'u duhet më.” (f.83)





## VALLËZIM ME HËNËN

Nuk e di sesi e kishin fshatrat e tjerë, por ne në Gorë i njohim Perritë tona edhe me emër. Ishin tri: Ilina e Shishtavecit, Jelica e Brodit dhe Borjana e Borjes. Kanë qenë vajzat më të bukura të gjithë Gorës e u kishte shkuar zëri edhe tejmbanë nëntë bjeshkëve. Kur kërcenin ato, thoshin, dheu nën këmbët e tyre ngazëllente, lulet e livadhit, ku shkelnin ato, gjallëroheshin e shumoheshin, krojet e bjeshkëve, thoshin, e shtonin gurgullimën dhe i pëshpëritnin fjalë të ëmbla barit. Por edhe yjet, thoshin, ndaleshin për t'i parë, ndërsa gjarpri dilte nga guri për të dëgjuar këngën e tyre.

Dhe thonë pastaj që një natë, kur po kërcenin te lëmi i Vejselit, u foli Hëna, dhe ato e ftuan në valle, por ajo u vuri kusht që t'i bënin një palë rroba Gore, që edhe ajo të zbukurohej me to. Dhe e lanë të kërcenin natën, kur hëna të ishte e plotë.

Jelica nga Brodi, Ilina nga Shishtavecit dhe Borjana u takuan në Igraleshnik, nën Blirin e Madh. Nuk kaloi shumë kohë dhe shkrepit e livadhet e Gjalicës morën ngjyrë floriri, ndërsa retë mbi Kallabak u bënë flokënjë argjendi.

"Doli!", thirri Jelica dhe kërcëu si drenushat e bjeshkës së fshatit të saj.

"Mirë se të vijë!", tha Ilina, me zë të butë si pëshpërima e Rekës, që shkoi përmes fushës së Shishtavecit.

Borjana piu një gllënjë ujë, që e kishte mbushur në Topillo, çezma më e mirë e gjithë Gorës. Por të tria ishin në merak, sepse, sado që u përpoqën, nuk arritën të bënin rrobat për Hënë. Disa thonë ngaqë nuk ia dinin masën, të tjerët se nuk pranoi asnjë djalë të shkonte në Prizren për të blerë bojërat që të ngjyenin fjetet për të endur rrobat dhe ca të tjerë tregonin si më të sigurt se, kur Borjana vuri vekët për të endur rrobat dhe e pyetën çfarë po bënte, ajo, shumë e qetë dhe e sigurt, tha se po endte rrobat e Hënës; atëherë erdhi si rrufe e vetëtimë i ati dhe i theu e i dogji vekët...

"Ku janë rrobat e mia?", pyeti Hëna. "Nuk i bëmë dot!", iu përgjigjën të tria me një gojë.

"E po mirë", u tha Hëna, "lakuriq unë, lakuriq edhe ju."

Ato ngrinë nën dritën e bardhë të Hënës. Ndjenë të ftohtë brenda dhe jashtë, në shpirt e në zemër, e për t'u ngrohur filluan të kërcëjnë pa e çarë kokën, nëse do të ulej apo jo Hëna të kërcente bashkë me to. Hëna u ul në kurorën e blirit dhe drita e saj u derdh si ujëvarë argjendi mbi vajzat. Jelica filloi të zhvishej e para, pastaj Borjana dhe Ilina në fund. Kur u përshfaqën gjokset e tyre të bardha, Hëna e ndjeu veten ngushtë, ndjeu se iu mpak drita, prandaj u ul edhe më poshtë... edhe më poshtë... derisa ciku në pubisin e mëndafshhtë të vajzave që, në atë grimherë, po merrte ngjyrë të trëndafilte. Borjana zgjati dorën dhe e kapi, e tërhoqi lehtas dhe në valle u bashkuan katër hëna që ndriçuan sa një diell. Ishte një dritë pabesueshmërisht e ngrohtë, e ëmbël, e bukur dhe derdhej nëpër gjithë trupin e vajzave, nga balli te gusha, nga sytë te kërthiza, nga buzët te pubisi, nga gjokset te këmbët, që mbanin ritmin e asaj valleje të paparë ndonjëherë në botën e Tokës dhe as të Qiellit.

DY LEGJENDA NGA  
NAMIK DOKLE

Nuk e kuptuan sesi shkoi koha në atë vallëzim me Hënë, derisa dëgjuan gjelat e parë të Borjes, dhe pas tyre qentë e Oreshkës përballë, që po përndiqnin natën me të lehura. Hëna, sikur të mos kishte qenë asnjëherë mes tyre, ishte përsëri në qiell dhe i vështronte me kërkshëri.

Kur u kthyen në shtëpitë e tyre, vajzat u përballën me të njëjtën pyetje: "Ku ishte gjithë natën?"

"Zbritëm Hënë në tokë dhe hodhëm valle me të!", ishte e njëjta përgjigje në tri fshatra të Gorës. Ata që dëgjuan, u çmeritën. "Na qenkan përhënuar vajzat!"

Jelicën e përzunë nga shtëpia dhe ajo, derisa vdiq, brodhi me dhitë e egra të Brodit nëpër shkrepë e shpella. Askush nuk e mori vesh me çfarë ushqej, por një çoban delesh i atyre bjeshkëve bënte be e rrufe se e kishte parë duke mjelë dhitë e egra. Për Ilinën nuk u mor vesh si e qysh, por një pasdite e gjetën të mbytur në lumin e fushës së Shishtavecit, të cilin, që atë ditë e sot e quajnë "Reka e Ilinës".

Ndërsa Borjana, pas zallamahisë në shtëpi, nuk dihet pse pati një dëshirë të papërballueshme të fuste në gojë dy-tri qershi dhe, meqë në atë kohë piqeshin vetëm kokrrat e qershisë te shkëmbi mbi përroin e Xhaferrit, u nis e shkoi atje. Askush nuk kishte guxuar të ngjitej në qershi deri atë ditë, sepse ajo ishte rritur mbi një shkëmb të rrëpirët, që u kallte tmerrin edhe djemve më të guximshëm të fshatit tonë. Borjana, thonë, u ngjit vetë në shkëmb dhe këputi një degë

qershie, hëngri disa kokrra dhe pastaj ra teposhtë si thëllëzë e vrarë, por me krahë të hapur. Disa thonë që iu morën mendtë, të tjerë thonë që u hodh vetë, por më të shumtit tregonin se kishin parë Hënë që e mbajti në krahë derisa e zbriti në fund të humnerës dhe aty u shua si një yll që bie nga qielli.

## FOLI KOKA E PRERË...

A ishte më i bukur i Gorës.

Ajo ishte më e bukur se ai.

U dashuruan dhe u martuan; bënë një dasmë të madhe, sipas traditës së lashtë të krahinës. Në mëngjesin e dasmës, ende pa dalë drita, ai shkoi në oborrin e saj për ta zgjuar, me meloditë e curleve dhe lodrave, nga gjumi i fundit i vajzërisë dhe për ta ftuar atë natë në ëndrrën e parë të nusërisë.

Bënë dashuri vetëm një natë. Në mëngjesin tjetër i erdhi thirrja që të shkonte ushtar në ushtrinë e madhe të Sulltanit, që sundonte edhe mbi fshatrat, livadhet, pyjet, bjeshkët dhe lumenjt e Gorës. Nusja e re i përgatiti kalin për udhën e gjatë. Nëna i bëri gati bukën. Motra shkoi në bjeshkë që të mblidhte bar tërfili për kalin e vëllaut. Një këngëtar i bjeshkës, kur e pa, këndoi:

"Moj Morava, mjegull e përgjakur,  
Pse kaq herët lulet i ke vyshkur?"  
"Kaloj vajza mbi mua e zbatthur"

Barin e tërfilit duke mbledhur.  
Do ia çojë tërfilin kalit t'bardhë  
Rrug' e largët vllaut t'i shkojë mbarë..."  
"Ha, o kalë, o kali im i bardhë,  
Rrugë të gjata sot ke për të marrë,  
Në nëntë bjeshkë nuk ke për t'u ndalë,  
Nëntë lumenj t'përgjakur do kalosh,  
N'ato troje t'verdha do të shkosh..."

Trimi ngjeshi armët, i hipi kalit dhe hodhi vështrimin e fundit mbi sytë e përplotur të nënës, motrës dhe nuses së tij të re. Dhe u tha:

"Nëna ime, bëhu nënë edhe për nusen. Motra ime bëhu motër për nusen time. Dhe ti, e dashura ime, më jep besën që do më presësh e nuk do t'i hedhësh sytë mbi djem të tjerë, nuk do të dalësh te çezma e fshatit se ata të spërkatin me ujë e të turbullojnë mendjen, nuk do të shkosh te lëmi ku lozin vejanët se ata të tallin e të shushatin, as në shtëpitë e vejushave se të qeshin dhe të përflasin."

U nis e ato mbetën pa lëvizur, nëna si qyqe, nusja dallëndyshe e motra si trishtil i verdhë.

Kaluan tre vjet pa një lajm. Nëna u rrudh nga plakja. Motra u shëmtua nga dhembja. Nusja u mpak nga trishtimi e trarët e shtëpisë zunë të kalben nga lotët e saj. Në krye të tre vjetve djali u kthye nga lufta, me plagë në trup dhe në shpirt. Nëna doli në krye të shkallëve të shtëpisë. Mbushur pezmi dhe mlllef, i tha:

-Erdhe, o biri im i shkretë?!

-Pse më pret me ato fjalë, nënë e dashur?

-Nga lufta ndoshta vjen me lavdi, por këtu turpin do të gësh.

-Ç'thua, nëna ime?

-I the nuses të mos dalë te çezmja? Ka dalë sa ka dashur dhe është spërkatur me djemurinë për shtatë palë qejfe. I the të mos shkojë te lëmi i vejanëve? Ka shkuar dimër-verë, është shushatur dhe hallakatur. E porosite të mos takohet me vejushat? Drekë e darkë është takuar me to dhe fjalët e hallkut janë bërë sa birat e gardhit e thashethemet janë bërë mullar.

-Mos, moj nëna ime, çfarë më thua?! Lufta trupin ma coptoi, fjala jote shpirtin ma përvëlooi...

Nxorri shpatën, atë shpatë që kishte prerë koka ushtarësh armiq, e vringëlloi dhe i preu kokën nuses së tij, për të cilën e kishte përvëluar malli dhe kishte kujtuar çdo ditë të parën dhe të fundit natë që kaloi me të. Koka e nuses u rrokullis dhe ndaloi në shkallën e fundit.

Dhe foli koka e prerë:

"Ç'bëre, o shpirti im?! Si e preve kokën që aq shumë të deshi? Si m'i shkretove sytë e bukur që asnjë ditë nuk e ndalën të qarën për ty. Shiko trarët e shtëpisë që po kalben prej lotëve të mi. Pyete motrën tënde a ta kam mbajtur besën që të kam dhënë, a kam dalë te çezma me djemtë, te lëmi me vejanët a në oborret e vejushave. Unë të desha aq shumë, o pëllumbi im, vetëm një Zot e di sa të kam dashur dhe sa të kam pritur..."

E pyeti motrën dhe ajo i tha të vërtetën për nusen e tij besnike.

Mali u shemb, bjeshka u bë terr, dielli u shua dhe në sytë e tij mbeti vetëm koka e prerë që nuk fliste më. E ktheu shpatën nga vetja, e nguli tej e tej zemrës dhe tha fjalët e fundit në këtë botë:

-E mjera nënë! Nuk deshe dy dashuri, hap dy varre tani...



Patjetër që Ariani ishte një djalë mjaft i mirë. Serioz, simpatik, fjalëpakë e që i mbronte idetë për jetën me aq zjarr herë-herë, duke rënë në sy në kolektivin e mësuesve. Shkolla jonë ishte shkollë e madhe dhe kjo i bënte vetitë e cilësitet e Arianit të dalloheshin ndaj, secili kishte simpatitë e tij për atë. Ai e donte Sonjën, por ajo ngjante se kishte frikë prej tij, sepse asnjëherë nuk i jepte rast të kishte më shumë shoqëri e intimitet. Mesa morëm vesh ne, i kishte thënë Arianit, se ajo thajse ishte e fejuar. Nuk e dinim në ishte e vërtetë kjo, por kolektivi ynë, duke qenë kolektiv i madh i shuante brenda vetes marrëdhënie të tilla delikate me një lehtësi të habitshme.

Jeta rridhte natyrshëm, ndëkaq natyra e Arianit sikur ndryshoi, sapo ai zuri shoqëri me Liken, një djalë i mirë por shumë i lëvizshëm e me shoqëri të madhe. Ata të dy shiheshin shpesh bashkë e jeta e natës filloi të kishte ngjarjet e veta ditë pas dite, deri sa një ditë të bukur ia bëri bam dhe kush ishte heroi? ...Ariani

Është i tmerrshëm tha Iliri(Likja)! E këputi shoqen e mikeshës sime me një bisedë e takim. Ajo tani lë kokën pas këtij djali. Ndërkohë bënte me shenjë nga Ariani, në kohën kur ai ndodhej larg nesh. Është e pasur pa le. E ka dërguar me makinë deri tek shtëpia. Sonte do të shkojë në darkë ta marrë po në shtëpi. I ra asi këtij djali, vazhdonte Iliri. Gjithë njerëzit i ka me lekë. Mbi të gjitha është gjithë ai djalë. Apo jo? Hë si thoni ju? Po ti Sonja ke ndonjë vërejtje, se e shoh që se si më vështron? Çfarë pate, i kishte thënë Sonja? Cila është lidhja këtu, e kishte shkuar nga klasa, ku kishte mësim, me fletoret në dorë.

Ndodhitë erdhën njëra pas tjetres. Jeta e natës e kishte bërë të veten e mbi të gjitha të bënte përshtypje, se Ariani ishte aq i thjeshtë në jetën e ditës sa habiteshe se si ai ishte bërë kaq i tmerrshëm për pak ditë. Si është njeriu, flisnin kolektivi me njëri-tjetrin. E pati fatin e tij edhe Ariani. Epo nuk është kot ajo shprehja e vjetër popullore, se në fatin tënd nuk rri askush.

Si gjithnjë ai vishej po njësoj, por vihej re një lloj kujdesi i lehtë nga ana e tij dhe të gjithë ishin të mendimit, se më në fund ai ishte bërë i "tmerrshëm", i kishte plasur cipa kështu po mbushte kohën bosh të jetës së tij me femrat.

I ka thënë, se nuk mund të rri pa ty, vazhdonte Likja rrëfimet e veta. Ariani kalonte me indiferenca komentet, por kur qëllonte të ishte aty e t'i dëgjonte i thoshte Likes. Po leri o burrë, se nuk ka nevojë t'ua tregosh të gjithëve dhe të gjitha. Aman ,thoshte Likja. E di si më tha mbrëmë? Do t'i blej makinë Anit, (kështu e thërriste ajo Arianin sipas, Likes. Do ia blej, se është flori dhe një ...dashnor i rrallë, vazhdonte duke bërë një gjest në fytyrë Likja sa dukej se po maste kështu forcën mashkullore të Arianit. Po historitë vazhduan shumë gjatë. Shoqëria e Arianit me atë femër, sipas bisedave që bëheshin çdo ditë zuri të trashë shumë. Do të vij ta marrë me makinë në shkollë, tha një ditë Likja. Në çast Ariani u bë i gjallë, duke thënë se kjo nuk do të ndodhë kurrë, nuk do ta lejojë. Aty afër e dëgjuan bisedën dy tre mësuese e mes tyre ndodhej Sonja. I kishte hapur sytë e bukur, duke i ngjarë krejt i panjohur ky djalë që deri pak kohësh e mendonte si njeri aq të mirë e me moral dhe ja si shkoj puna.

Pse bën kështu ti, iu drejtua Arianit ajo.? Përderisa e do cili është problemi këtu? Të vjen keq ta njohim ne? Ndërhurja e saj e ngriti tjetrin në këmbët e para. Mos shpreh mendime vazhdoi ai! Je nga fundi për t'u dëgjuar. Kjo është jeta ime. Ajo e kishte parë gjithë inat nën efektin e fjalëve mbështjellë me një lloj zemërimi nën lëkurë. E gëzofsh pra, e kishte ikur pa e parë në sy!

Bisedës për këtë ndodhi nuk dihej si do t'i kishte vajtur filli sikur një ditë të bukur të mos kishte dalë varianti i ri.

Vajza që linte kokën pas Arianit, së shpejti do të nisej për Danimarkë, ku familja e saj kishte një shtëpi prej tre vjetësh. Ajo i kishte thënë Arianit të shkonte me atë në



## DASHURIA ËSHTË NJË LOJË

Tregim nga Preng Maca

Danimarkë. Nuk mund të jetoj më pa ty, i kishte thënë ajo. Më ke ndryshuar jetën, më ke nxjerrë gjumin nga jeta ime boshë. Je floriri im i pazevëndësueshëm! Ti më zbururon jetën! Eja me mua e mos mendo për asgjë në këtë botë, jetën e kemi të siguruar.

Shkolla ziente aq sa të gjithë e quajtën punë të kryer. Kush do ta linte një rast si ky t'i ikte nga duart? Çfarë fati thoshte, dikush tjetër! Ariani është djalë shumë i mirë. Ja nuk krekoset fare. Nuk ka faj i shkreti, është në hall. Mësuesi i matematikës e pyeti, se kur do të shkonte në Danimarkë, se kishte një kushërinë e tij i cili donte të fillonte punë si mësues gjeografie në vendin mbetur bosh nga ikja e shpejtë e mundëshme. E kishte parë me vëmendje, pastaj duke u skuqur i kishte thënë, se nuk kishte marrë akoma vendimin e duhur për këtë problem, akoma. Sonja i dëgjonte llafet e shkonte tutje e pa interesuar, por nganjëherë i dëgjonte bisedat për të me një kujdes si e si mos të zbulohet interesi i saj lidhur me çështjen e Arianit. Likja shpesh e binte fjalën tek fati i Arianit, duke e lavdëruar shokun e tij dhe fjalët e vajzës që donte, kur kishte thënë se Arianin e kishte rrujtë Zoti vetëm për atë.

Ariani mungoi atë ditë në shkollë e lajmi u përhap se ai i la "targën" shkollës. Sot niset, thoshte Likja... Është atje në Rinas... duke e përcjellë. Nuk di se si do të bëjë? I është mbushur mendja të rrijë. Idiota. Një rast si ky vjen vetëm një herë në jetë. Dedeja i drejti. Kushedi kush ia ka marrë mendjen, ndonjë vajzë shqiptare dhe i bie me shkëlqim Danimarkës...Jo jo nuk di ndonjë gjë të sigurt. Më ka mbyllë telefonin, idioti.

Drejtori pyeti për Arianin dhe shokët i thanë se kishte shkuar diku ngutshëm. Më ka marrë leje, se duhet të ishte sot në Rinas, por ju thashë që të zevëndësoni orët, bëhet fjalë për dy orët e fundit ka dy orët e fundit mësim. Kishin mbetur pa fjalë të gjithë. Puna kishte shkuar thellë. E dinte edhe drejtori. I tmerrshëm u bë ky djalë i urtë, personazh vip.

Të nesërmen ai erdhi. Dukej i zbehtë e pak i drojtur. Asnjë nuk i foli për atë që kishte fluturuar për në Danimarkë. Nuk shkova, nuk vendosa dot, kishte thënë ai. Nuk mund të jetoj në Danimarkë. Vendi im është për mua këtu, nuk mundem. Eh, bënë të tjerët. Obobo, mendoj mësuesi i matematikës! Më fiku që nuk pranoi të ikte! E kishte ditur fakt të kryer.

Sonja e pa nga larg, sikur po e shihte

për herë të parë e duke marrë nga klasa që atë orë të parë ishin afër i tha, se nuk duhej të mërziçej, se nëse ajo e donte do të bënte çmos ta merrte me vete më vonë atje në Danimarkë e largët. Nuk do të shkoj dhe pikë, ishte shprehur ai. Mos u nxeh, i kishte thënë tjetra, një mendim të thashë. Të faleminderit, i kishte thënë ai pa e parë në sy. Sonjës i ishin mbushur sytë me lot, ndërkaq kishte ecur drejt klasës. I shkreti, kishte menduar me vete. Është djalë i mirë dhe ja se si i shkoi jeta. Gjen një njeri që e do dhe befaf mbaron gjithçka. Iu kujtua se si i kishte thënë atë ditë asaj, se e donte, e pëlqente e do ia bënte jetën të lumtur. Ishte e para femër që donte dhe iu lut aq shumë ta mendonte edhe ajo të ardhmen e saj me atë. Jo, kishte gënjyer ajo, jam e lidhur. Kishte pasur frikë ta pranonte kërkesën e tij menjëherë, ndërkaq kishte përdorur një gënjeshtrë si një gomë shpëtuese për të dalë nga situata, por kishte menduar se nëse vërtet e donte ai do t'i fliste prapë asaj. Por ja si shkoi jeta e tij, ja sa keq tani. Thujse e shihte fytyrën e asaj vajze në avion mbështetur kokën në xhamin e dritares, duke kërkuar diku vendin, ku duhet të ishte ai të cilit i kishte falur jetën.

E kështu jeta vazhdoi. Ariani mbeti pa dashnore e mësimi vazhdonte rregullisht, por edhe shoqëria e harroi ose bënte, sikur e harronte ngjarjen që e kishte mbajtur tre muaj gjithë mësuesit me të papriturat e këndshme të asaj love story.

Sa shpejt ishte shëruar mendoi Sonja atë ditë, kur ai e ftoi për kafe. Iu dhimbs prandaj i tha po, por thellë në veten e saj ndjehej në një lloj jo vetëm mëshirë por edhe keqardhje, se ndoshta po të ishte treguar më e hapur, ndoshta do të ishte vajza e dashur e Arianit të gjatë e aq simpatik, me ato flokë të kaftë. Akoma i pëlqente ato sytë e butë, ku gjithnjë i ngjante se rrinte fshetur afëri i shpejtë i para do kohëve. Kaluan ato kohë mendoi e një diçka iu duk se i bëri trak në zemrën e saj. Vuri dorën tamam aty duke zbuluar befaf në veten e saj pyetjen: "A thua e kam dashur pa e ditur, ndërsa tani e trajtoj si humbje?" Dreq o punë si është jeta?" ...

Kafe, pyeti Ariani? Ajo e pa duke hequr flokët e zinj nga sytë sikur të thoshte, ti e di se kafe, pse bën sikur nuk e di.

Kafet erdhën...Si është ajo, a ke folur e pyeti Sonja? Nuk është, u ngatërrua ai. Si, pyeti tjetra, jeni ndarë? E bëri fytyrën në formën e një keqardhje të thellë e të

vërtetë. Akoma më keq, ia ktheu ai. Po hë, e ngriti kokën ajo, jeni grindur? Ata që duhen gjithnjë grinden, do të kalojë. Akoma më keq, foli ai pak me të lehtë. Kishte pranuar atë djalë akoma të lidhur e ishte bashkuar me atë në kafe, ndërsa ai donte t'i hapte zemrën e trazuar kushedi nga se e ... "A thua ishte fajtor ai?" Ai ia kish ngulur sytë. Edhe... vazhdoi ajo, nëse më beson, ma thuaj, sido që të jetë. Më vjen keq vërtet!

Ai e thithi kafën nga dy herë e pastaj u duk se do thoshte diçka të madhe, të rëndësishme. Bashkëfolësjë i bëri sytë e dhembshur për ta pritur lajmin sido që të ishte duke menduar fjalët e mundshme ngushëlluese për Arianin, siç duket të braktisur nga e dashura e famshme.

Akoma më keq, tha ai. Më vjen turp, më vjen vërtet turp! Ti ndoshta nuk do ta besosh. Më mirë e lemë këtë muhabet. Jo nuk ka pse të vij turp, i tha ajo dhe ia zuri dorën me dorën e saj mbi të tijën, që iu duk se po dridhej tashmë. Ma beso mua të lutem, nuk do t'i them asnjë, të betohem dhe do të të bëj mirë ty! Do të lehtësohesh e ndoshta të jap një këshillë...dashuria bën çudira. Nuk do t'i thuash njeriu, pyeti ai me ngulm? Jo premtoi ajo, për kujtimin e nënës që nuk e kam! Dhe ti nuk do zemërohesh e nuk do të tallesh! Oh Ariani foli ajo, duke i rrudhur vetullat e holla. Po ti nuk më paske njohur fare, kështu e?

Më dëgjo pra. Tjetra vuri duart në faqe dhe e pa drejt e në sy. Të gjitha ato për atë vajzë kanë qenë të shpikura. Asgjë nuk është e vërtetë... Të gjitha janë sajime të Likes...Unë i pranova, duke kërkuar të...Duke menduar, se ti do mendoje për mua. Për atë Zot të gjitha janë të sajura e vetëm ti je ajo vajza... Sonja të lutem...Sonja më dëgjo! Unë të çmoj shumë, të...kam menduar shumë!

Sonja herë zverdhej e herë skuqej dhe ...Pastaj qeshi, qeshi, qeshi e i ra faqeve të tij lehtë. Ah ti, shejtani im, thujse i shpëtoi fjala asaj. U gëzua shumë që gjithë kjo kishte qenë një lojë. Aman Ariani mos më gënjen, i tha ajo. Të betohem në Zot që kështu është, por të lutem më fal!

Po ajo puna e Danimarkës, pyeti ajo sikur zbuloi diçka të fshehtë në këtë sajese të tij? Ehë, po vazhdoi ai. Unë në fakt u lodha me atë histori dhe desh u zura me Liken. Ai ndenji i qetë e më tha, se do të ma rregullonte atë punë. Unë as që e merrja me mend se si do të mund ta mbyllte atë histori që po më merrte frymën, por ai...shpiku Danimarkën e unë u ndjeva i lirë nga ajo dashuri që nuk ishte e që po më merrte frymën çdo ditë e më shumë. Po tani a e beson apo jo?

Kaluan ditë e ata të dy u përfolën aq shumë e kolektivi e harroi dashnoren e Arianit e u mësua me lidhjen e tij të re. E çmuar Sonjën zemërmadhe pak mendjelehtë, thanë për vajzën që vendosi aq shpejt pas një lidhje të bujshme, si ajo e asaj vajzës e cila tani ndodhej në Danimarkë. A thua kishte ndikuar në prishjen e Arianit lidhja me Sonjën e bukur e të thjeshtë. Por kolektivi i madh i mësuesve e harroi shpejt të shkuarën e tyre, ndërsa ata aq të dashuruar e të lumtur dukeshin gjithë ditët. Ajo kurrë nuk e pyeti më për dashnoren e Danimarkës. Eh dashuria është si një lojë, tha një ditë Likja, kur ato të dy pinin kafe, sikur të ishin njohur të djeshmen e çdo dite. Ti mos fol, i thanë ato Likes! Për ty desh iku në Danimarkë Ariani i mirë. Eh, tha ai sërisht, dashuria është një lojë. Gjë e lehtë thanë ata me vete dhe nuk ia varën fort, ndërkaq që ai hipi në atë makinë e tij të vjetër e cila sikur mendohej para se të shkulej nga vendi, pastaj nisej seriozisht, por dukej ashtu si një lojë.

Aq shpesh e përdorte ai Like atë fjalën e famshme, se dashuria është një lojë, sa gjithë kolektivi filloi ta quante me atë varg kënge. Por vetëm dy vetë nuk e tallnin, por qeshnin përherë me shprehjen e tij dhe i thoshin shpesh. Pa hë Like, thujse atë shprehjen. Dashuria është si një ...lojë, vazhdonin të gjithë e bashkë më të gjithë edhe çifti i dashuruar tashmë e që jetonte çdo ditë fytyrën e mrekullueshme të një dashurie të vërtetë.

unë e kam një arsye për t' mos vdekur

për një lule  
për dy lule  
për tri lule  
për të gjitha lulet  
nuk ka asgjë më të sigurtë se vdekja

unë kam në gojë shijen e syve të tu

\*\*\*

është të mos e shohësh kopshtin arome  
portokajsh dhe trëndafilash  
ullijte e gjelbër verë dimër lumin e heshtur  
luginën e thellë kodrinat e ngrrohta ere diell  
fushën dhe qiellin gjer ne skaje  
gjer atje ku bashkohet me detin dhe detin  
vete  
të zgjohem në mëngjes dhe te mos shoh ty  
bri meje

\*\*\*

vetëm një lule kamelië  
me tregoi qe ti ekziston

fjala lindi me vone  
vetëm e vetëm prej teje

\*\*\*

zbriti vjeshta në pyje  
nga larg vjen ere dhe shi  
unë strukur në mendime  
a do vish përsëri

bien gjethet e vjeshtës  
nga pyjet vjen erë dhe shi  
unë për ty strukur ne mendime  
kur do vish përsëri

\*\*\*

nga lart poshtë nga poshtë lart si një peme  
e gjitha e imja dhe jo imja  
të vij përqark si një peme  
qartësi dhe mister  
e vërtete dhe e rreme  
e rremja zhduket  
dhe çfarë mbetet nga e gjithë kjo e vërtetë  
që je ti dhe unë

\*\*\*

ndodh ne anëdetin tim  
ne kopshtijet me portokaj dhe limonë  
me një dritë të zbehtë të largët  
që s'dihet nga vjen  
në një nate me shi te imët

njeriu zhytet në një ëndërr  
nga ku nuk zgjohet dot më

jetë thua apo ëndërr ishte

\*\*\*

kur ndodh të ushqej me thërime ndonjë  
harabel të vogël rrezuar nga pemët  
ndjehem si Zot

ti merr autobusin dhe ikën  
ti merr avionin dhe ikën  
ikjet tuaja ushqejnë trishtimet e mija

dhe vetja me duket si një harabel i vogël  
që Zoti më mban në jetë me thërime

Zoti im po ti si ndjehesh ?

\*\*\*

do ta mbajmë sekret nga njerëzit  
çelësin ne dere  
ti në krahët e mi  
thjeshtë do t'i tregojmë vetëm Zotit  
që jemi krijesat e tij



## AH, PIKËLLIMET E MIA PREJ HËNE

*poezi nga Xhelal Tosku*

\*\*\*

ah pikëllimet e mija prej hëne

do të këtë dhe mbrëmje me kundërmime  
deti

do këtë dhe net me kundërmime kopshtijesh

kamelia ime  
në cilin sup ti do vendosësh kokën dhe do  
qash

ah pikëllimet e mija prej hëne

\*\*\*

drita zbriti para se të vij unë në këtë bote

tani gjithkush tregon errësirën e tij

unë errësirën time  
nata errësirën e saj

shëndetit tim i bëjnë mirë  
nata dhe yjet

në djall shkofshi ju  
me gjithë ditët tuaja  
të bardha  
plot dritë

unë nuk e fsheh errësirën  
time

\*\*\*

mëkatet e mija ia kam rrëfyer patër Gjergj  
Fishtës  
e shoh gjithandej tek shkon i përkulur me  
mëkatet e mija në shpine

dhe mëkatet e mija shtohen

\*\*\*

bien kabanat e kishës në mesnatë  
dhe ti kaq e kaq vjet  
mbështjelle kokën me shami te zeze  
shkon e rrëfesh dhe i lutesh Zotit

shpëtim nuk ke  
shpëtim nuk kam

kush na ka mallkuar për dreq  
kush fajin na e ka  
kur vete vrapojmë pas fatit tone te keq

bien kabanat e kishës në mesnatë  
dhe unë se di çfarë më dhemb gjer gjak

### Njeriu i dorëzuar

njeriu i dorëzuar nuk ka shtëpi  
nuk ka atdhe  
nuk ka president  
nuk ka kryeministër  
nuk ka deputet  
nuk ka kryebashkiak  
nuk ka kryeplak  
nuk ka eter  
nuk ka bij  
nuk ka vëllezër  
nuk ka motër  
nuk ka mjek  
nuk ka infermier  
nuk ka as miq  
nuk ka as shoke  
dhe xhepat i ka bosh

për njeriun e dorëzuar  
vdekja ka fytyrën më të bukur se te gjithë

\*\*\*

mbi kuaj  
me trokth  
me galop  
kali im  
urdhrrat vijnë gjithmonë nga lart  
kështu ka qenë gjithmonë  
kush do bëjë të ndryshojë

\*\*\*

disa janë të mëdhenj sepse janë të mëdhenj  
disa ndjehen të mëdhenj sepse të mëdhenj i  
kane shpallur të tjerët  
Zoti është i madh sepse të madh e kanë  
shpallur njerëzit

sipër kokës time qielli  
nën këmbët e mija toka

unë një pikë  
edhe toka një pike  
varet kush na sheh

un e di që jam i vogël  
unë e di që jam një pike

\*\*\*

një lule e vogël Margarita  
e verdhe e bukur

një mundësi për t'i shkuar jetës gjer ne fund

mbaj mend vetëm mëngjesin  
ku ma zuri syri

\*\*\*

mendova se u rrëzuan hijet

askush nuk këndon më për malet e lartë  
për fushat e gjera  
për grunjërat për bukën

për draprin nuk flet me askush

po për çekanin që vazhdimisht na rri mbi  
krye  
çfarë thuhet

mua më kanë kryqëzuar hijet.

\*\*\*

nisa të dashuroj një grua qe kishte prirjen e  
fshehte për të jetuar mes të vdekurve  
i pëlqenin festat e fundvitit

kur iku prej meje me erdhi shume keq  
nuk mund ta shpëtoja dot

fillova te mendoj se katundi im është më i  
bukur natën  
sidomos kur bie shi.

ndoshta nuk është kohë e përshtatshme për  
të jetuar.

\*\*\*

Zoti im unë jam këtu në toke sipas formulës  
tënde misterioze që askush nuk e di dhe  
askush nuk ka për ta gjetur

këtu më thonë se unë jam i barabartë  
përpara teje  
dhe përpara ligjit

me kë me mbretërit  
me presidentet  
me kryeministrat  
me ministrat  
me deputetët  
me kryepolicët  
me policët  
me kryebashkiakët  
me luanët  
me tigrat  
me rinocerontët  
me hijenat  
me peshkaqenët  
me gjarpërinjtë  
me minjtë

me kë o Zoti im

\*\*\*

pylli im arome drurësh të zhveshur  
barishtesh të egra

manushaqja ime  
prej te gjitha luleve thonë  
vetëm ti lajmëron pranverën

jetës sime  
prapë nuk i dihet

\*\*\*

çfarë ishin ata  
ku shkuan

edhe në parajse  
edhe në ferr  
shkohet vetëm

edhe në ferr  
edhe në parajsë  
nuk hyhet i gjallë

kush janë këta  
këta ku do shkojnë

## SILUETË ME FLOKË

U afruan atypari, për të treguar seriozitetin e pandehmës se ajo siluete me flokë donte të ndante me ta diçka të fshehtë, si me thënë, intime.

Çudi, ndodh që njeriu i zakonshëm skicon ca vija skajeve të veta dhe afrohet të dëgjojë ç'po kurdiset rreth tij. Ulet në gjuhë dhe duke përfutur nga rasti merr frymë me gojë hapur më shumë për t'i treguar grupit që e vështron se frika nuk është e ndaluar në kësi rastesh të rralla.

Megjithatë, përfytyrimi i këtyre njerëzve, të cilët presin me padurim ta lënë vetëm, të braktisur mes bulevardit, nuk është i ngutshëm dhe nuk priret t'ua prishë hovin, pra t'i lërë në rrugë.

Herën e parë që ia kishte qejfi të dilte si një skicim i vetes ia kishte ënda të merrte dhe flokët. Kaq duhet për t'u prishur të gjitha planet e të jetuarit me kokëçarje dhe me frikën se do të njihesh me sytë e parë që do të shkëmbehesh. Sakaq, ndodhi.

Një turmë njerëzish iu vunë pas, në krye i prinin fytyra të njohura e zëra miqsh. Rrugicat e errëta po mbusheshin edhe ato (fytyrat), po i futnin hundët aty ku nuk duhej. Kaq u desh, dhe, me një të shtyrë gremçin e mendjes u zhduk. Humbi me një të lëvizur të kokës në errësirë, atje ku gjente paqen dhe i jepej çdo gjëje të thukët. U çlodh, u çmpu dhe pas disa orvajtjesh të frytshme u shfaq.

Kur po kthehej, natën vonë, e gjeti veten duke parë lloje të shumta yjesh, të cilat në një lloj kuptimi jo vetëm i bënë dritë, por më së shumti i përkisnin.

Tashmë mendja dhe shpirti i kishin konturet me ngallmime, nga njëra anë donte më të mençurën e botës së saj, nga ana tjetër donte më kafshëroren dhe të rëndomtën që kishte njohur.

Po mos e kryqëzoni kaq shpejt, nuk ishin burra, as dy njëherësh, por megjithatë, ky nuk është favor që mund t'ia ndreqë sado pak gjendjen ku ndodhet. Ajo i ka marrë parasysh skajet dhe grisjet që u janë bërë atyre. Jeton paralelisht me dysh, me njërin di të flasë me frymë rreth e qark, me tjetrin di të përjetojë çdo cast, duke u mbajtur pas parmakut nga dhimbja se arsyeja nuk do ta lejtojë ta ketë më.

Mbas përpjekjesh të shumta për ta kuptuar një siluete, jo rastësisht me flokë, nuk u arrit asnjë marrëveshje ose mirëkuptim, kjo për faktin se ata, domethënë të tretët, jetojnë në një shoqëri të largët, ishullore e të pabanuar me njerëz.

Pasioni për skicat dhe grafikët mbase nuk është aspak gjë e re, por të merresh kaq shumë me një zë që as e dallon dot se i cilit është, besoj se të bën mirë ta shohësh gjatë shpinën e duarve.

## NJË GUR KOKËS

Atëherë, unë, isha një strall i vogël që më morën me shkelma dhe më çuan duke më gjuajtur deri në qendër të qytetit, te sheshi para Bashkisë. Deri në zgjedhjet e tjera zor se do t'më lëvizë njeri nga vendi.

Çdo mëngjes shoh një polic i cili ruan ndërtesën e restauruar me fondet që kaluan në Këshillin Bashkiak dy-tre vjet më parë. Ai kur nuk e sheh njeri, shkon te kioska në të majtë të sheshit, blen një sanduicë dhe e ha duke u mbytur. Pasi lëpin buzët mirë e mirë zë e këndon "Leskovik, o gur i thatë, trima burrat, trime gratë."

Përreth njerëzit bëjnë ecejake me hallet e tyre. Nga dera kryesore del kryetari, zakonisht shoqërohet nga një grup i vogël njerëzish të besuar, të cilët e mbajnë një distancë prej dy metrash me të. Unë

## NUK E DI

## Tregime nga Esmeralda Shpata



shoh çdo gjë. I ndjek me përpikmëri të gjitha lëvizjet e të gjitha ditëve, me gjithë këmbënguljen e njerëzve për të më shkelur e gjuajtur me këmbë diku më tutje. Me vendosmëri gjendem në një cep të volitshëm për të parë më mirë, nga kjo pikëpamje e kam kokën gur. Qytetarët të entuziazuar presin që i pari i godinës të nxjerrë ndonjë thesar nga mendja apo nga dyert e fshehta të Bashkisë. Asgjë nuk ka aty.

Një ditë sapo doli dielli, dolën të gjithë punëtorët jashtë, më saktë e gjithë administrata dhe shikonin me admirim sesi një çift qensh të ngatërruar me njëritjetrin as nuk u fshiheshin syve njerëzorë, të paktën deri të lulishtja që u bë me fonde të veçanta, jo më shumë se para një viti, e miratuar unanimisht njëzëri po nga ky këshill. Nga të qeshurat u rrëshqitën gurët nga tëmthat, ec e gjeje ç'ka për të qeshur në atë çiftëzim qensh. Kjo që pashë nuk ka pse të vihët në dyshim, dhe kryetari e ka më mirë të marrë një gur e t'i bjerë kokës sesa të spekulojë mbi këtë ngjarje. Unë nuk jam një rrasë varri, për besë i kam parë të gjitha seç ndodhin në këtë qendër administrative. Gazmendi për qentë nuk ndalte. E qeshura iu qep dhe mureve, gati sa nuk ra në tokë ndërtesa.

Për drejt kryetari më pa. Nga çudia ngriu në vend, u bë gur kur e pikasi që unë e pashë seç fshihte në zemër për gjindjen përballë. As që i bëhet vonë fare për ta, merakun e ka me mua, si t'i gjejë këmbët që më sollën në qytet sepse pashë ç'bëhej me pushtetin. E di që s'do lërë gurë pa lëvizur për të më zhdukur si zallin në lumë.

## E KULLUAR

Kur po kthehesha në shtëpi, pas një ditë të lodhshme në punë më ndaloi Fana, në fakt u çudita, njiheshim, por nuk kishim shkëmbyer kurrë ndonjë fjalë.

Zili e pata pasur, veç shoqeve sillej, mërzhitesha kur nuk e shikoja për ditë e javë të tëra, ama sapo më shfaqej fytyra e saj i harroja të gjitha pritjet e vuajtjet e mia. Ka kaluar shumë kohë që atëherë.

Unë kisha ca muaj që isha larguar nga kjo botë, mbase kjo ia bëri më të lehtë të më dilte para syve e të më fliste.

-Ndjesë që ju dola kështu papritur, -foli duke iu marrë pak goja, - por nuk mund të mos e them atë që mësova për ju, për familjen tënde.

-Më falni, çfarë po kërkoni të më thoni se sinqerisht asgjë nuk po kuptoj?!  
-Më vjen keq vërtet, vazhdoi ajo, - iu luta Ebës, meqenëse është farefisi juaj, t'i tregonte të gjitha, kam kohë që e bëj këtë, që atëherë që u fol për vdekjen tuaj. Ajo e kishte të vështirë, nuk deshi të përzihej dhe gjërat rrodhën kështu, ti ike.

Nuk e di pse më buisën djersët dhe po shtrëngoja grushtet, zëri po më pengoj derisa doli pak i mekur nga buzët.

-Më thua, sii është puna?!  
-Oh, sa të vështirë e kam të të shprehem, po ja, më duhet t'ju them se gruaja juaj, - nisi duke çuquritur, -po ja, gruaja juaj nuk është.

Nuk di si t'ju shpjegoj më thjesht, gruaja juaj nuk ekziston me të vërtetë, ju bëtë gjithë atë zhurmë, bëtë një ceremoni madhështore, u martuat në kishë, ishit ngulur te altari dhe nuk shqiteshit që aty derisa morët bekimin.

Unë i ndiqja e përloitur të gjitha këto dhe

të urreja ty dhe veten që s'ishte dasma jonë, por iku kjo tani, tani ti je martuar me të, por ajo s'është me ty.

-Fana, të lutem, nuk e di ç'të ka gjetur, nuk di as si të të ndihmoj, por kjo që po thua është një lajthitje e pakëndshme, nuk dua të të fyej, ik të lutem!

Ika. Nxitova hapat për mos t'ia dhënë mundësinë të fliste sërish, rrëshqita në errësirë dhe mora rrugën drejt shtëpisë sime.

Hapa derën, ime shoqe rrinte ulur në një pup afër sobës, sapo më pa m'u afrua duke qeshur dhe më përqafoi. Doja ta hiqja mendjen nga biseda e çuditshme me Fanën, e putha në ballë gruan time dhe mbase mora një qendrim të qortueshëm.

-E paske mësuar, - më thotë ajo me fjalë të kursyera, - më duhet të të rrëfehem.

-A të kujtohet si u njohëm?! Në mes të të gjithëve, ti me një lëvizje të kokës më përzgjedhe mua, me gjithë këmbënguljen e mundimshme të vajzave, nuk i le gjërat siç ishin. U martuam. Mbështetur te shpinoret në kishë ti më preke mua që s'isha, s'ekzistojta.

Mendoj se po e parandien çfarë do të të them. Unë nuk jam. Meqenëse kaluam bukur për ca muaj, shkunde mendjen tënde të trazuar dhe nxitu për te Fana. Ajo nuk ka reshtur së shpresuari se ti do ta merrje fatin tënd. Nuk pres ngushëllime dhe keqardhje, tek e fundit unë nuk mundem të jem.

-Nxito! Ik tani, më duket se ke vdekur. Ta dish, as lindja e diellit, as selvitë e larta rrëzë kodrës që t'i kap syri sapo zgjohesh, as ëndrra që të lëshon e të fut një shkëlqim vitheve për t'u çuar nga shtrati e për të dalë nga dera, asgjë pra, asgjë nuk e ndreq dot më.

## NUK E DI

Rruja, atje kundruall botës, kërkon ta ruaj njëfarë dinjiteti.

Burri që më vështron nga cepi i saj, më duket i aftë për shumë të liga. Ai ecën si kafshë e bukur me këmbët e pasme, më përndjek dhe më nderon njëkohësisht me sy.

Shikimi im sullet nga frika se diçka mund të ndodhë midis nesh. Unë nuk jam e lirë, nuk do të mundem kurrë t'ia afrojmë mendjes atë që shkon në një vend me emër të çuditshëm dhe të pistë. Nuk e di, madje, në rrugën në fund të botës nuk qëndron asnjë burrë me vështrim të çuditshëm.

Rruja që lidh pamjen time me qendrën është gjithë baltë dhe, nuk e di. Vetëm për dinjitet nuk bëhet fjalë aty. Ajo ul supet e poshtëruar, sepse asnjë burrë i çuditshëm nuk ka ndaluar në cep të saj. Asnjë nuk është ulur mbi një gur, apo mbështetur pas një peme që të prodhojë mendime të liga.

Mëkatet e veprës dhe të mendimit do t'i rëndonin në zemër një gruaja që ndiqte me sy cepin e rrugës për të kaluar ai. Nuk e di këtë.

Mundet të jetë dikush nga ne gratë (mund të jem edhe unë) që i ngrejme gracka vetes. Mendimi im i shkëlqyer për të pasur pikërisht atë, më bën të prek mollëzat me mollëza.

Unë arrij t'i flas.  
E pyes me zë të hollë dhe i jap vetes një rëndësi të madhe për zbulesën.

Mundësia jonë për të puthur fjalët çdo natë krijohet. Me përjashtim të ca hollësive shumë elegante nuk ka ndonjë dialog për të lënë në paqe instinktet e mia prej gruaja.

Është paraqitur një rast. Nuk e di, por...  
Rrugëzgjdhjet nuk entuziazmojnë dot njerëzit.

Burri u kthye me fytyrë nga ne dhe më zgjodhi pikërisht mua.

Kisha kohë që kisha pritur një ndukës. Nuk e kuptoj, por mendimi për të takuar një të tillë ma kalon.

**KURRË MOS U LARGO QOFTË DHE PËR NJË DITË**

Kurrë mos u largo qoftë dhe për një ditë, sepse tjetër s'di ç'të them; një ditë është kohë e gjatë unë do të rri duke të prituri si një stacion i zbrazët ku trenat gjithashtu kanë ndaluar dhe flenë.

Kurrë mos u largo qoftë dhe për një orë, sepse një dhimbje e mprehtë vdekjeje do të na tresë të dy zjarri dhe tymi i tmerrshëm do të perfshijnë shtëpinë dhe unë përfundimisht do të mbetem pa zemër

Oh, silueta jote ka për të humbur anëdeteve me shkumë dhe s'do të pulitet qepalla jote në largësitë e pafundme kurrë mos u largo qoftë dhe për një sekondë, e dashur

Sepse në atë çast ti ke shkuar shumë larg nga kjo tokë unë do të endem planeteve duke pyetur si i çmendur, Kur do të kthehesh? Ke ndërmend të më lesh këtu përgjithmonë?

**UNË DUA QË TI TË JETOSH ENDE**

Unë dua që ti të jetosh ende Kjo është njëllor sikur të thuash se ti je mungesa Dhe ti më dëgjon nga tejjeta Por zëri im nuk mbërrin dot atje Është njëllor si te thuash se syte e tu kane humbur diku ne asgje Është njëllor sikur të thuash se një puthje ka vulosur gojën tënde Të gjitha gjërat janë mbushur me shpirtin tim Ti shfaqesh nga gjërat Që kanë mbushur shpirtin tim Ti je shpirti Një flutur e ëndërrës Ti je fjala; melankoli

Unë dua që ti të jetosh ende Të shfaqesh qoftë dhe në tejjetë Zërat më duken se sjellin vajtimin tënd Njëllor si një flutur që gugat si pëllumb Dhe më duket sikur më dëgjon mua Por zëri im nuk mbërrin dot atje Më lejo të vije dhe të jem në heshtjen tënde


Më lejo të flas nëpërmjet heshtjes tënde Kjo është e ndritshme si një llambë Dhe e thjeshtë si një unazë Ti je si nata Me qetësinë dhe konstelacionet Heshtja jote është si një yll I largët dhe i ndritshëm

Unë dua që ti të jetosh ende Kjo është njëllor sikur të thuash se ti je mungesa Largësia dhe dëshpërimi i thellë Ti mund të kesh vdekur Vetëm një fjalë, një e qeshur mjafton Dhe më bën të lumtur Po dhe lumturia nuk është e vërtetë

**GJITHMONË**

Nuk jam xheloz për ata me të cilët ke shkuar para meje.

Eja me një mashkull në krahët e tu eja me njëqind meshkuj në flokët e tu eja me njëmijë meshkuj midis gjinjve dhe kofshëve të tua

**PABLO NERUDA****Sonetet e dashurisë***Përktheu Roland Gjoza*

eja si një lumë mbushur me meshkuj të mbytur që vërshojnë poshtë në detin e egër drejt suvalave me shkumë të perjetshëm, drejt Kohës!

Silli ata të gjithë atje ku unë rri dhe të pres ne do të jemi gjithmonë vetëm ne do të jemi gjithmonë ti dhe unë fillikat në tokë për të nisur jetën tonë.

**SONETET E DASHURISË XVII**

Unë nuk të dashuroj nëse ti je një trëndafil kripe apo topaz Apo një shigjetë karafili që godet zjarrin dhe e shuan Unë të dashuroj si gjërat e errëta që sigurisht kthehen në dashuri Si sekret, midisi i hijes dhe shpirtit

Unë të dashuroj si toka që s'pa kurrë lulëzim Por tërhoqi tërë dritën për lulet e padukshme I përulëm dashurisë tënde me aromë absolute rritur nga toka, çelur nga errësira brenda trupit tim

Të dashuroj pa ditur kush je, ku jeton, prej nga vjen Të dashuroj me dëlirësi, pa komplekse dhe krenari Kështu të dashuroj se mënyrë tjetër nuk di

Po të them; ku jam unë s'ka jetë pa ty Kaq ngjitur dora jote në faqen time, dora ime Kaq ngjitur sytë e tu ku bie dhe fle

**MËNGJESI***(Sonete dashurie XXVII)*

Lakuriq ti je më e thjeshtë se një nga duart e tua E ëmbël, tokësore, e imtë, e tejdukshme, hamgjitëse Je dritë e hënës, shteg i mollës me lule Lakuriq ti je më e hollë se kallëza e grurit Lakuriq ti je më blu se një natë në Kubë Ke verë dhe yje në flokët e tu Lakuriq ti je hapësirë dhe e verdhë delikate Si vera në një katedrale ari

Lakuriq ti je e imtë si një nga thonjtë e tu E lakuar, fine, e trëndafilte, si agu që ende s'ka dalë Në ag tërhiqesh dhe ti në botën e nëndheshme

Nëse në atë tunel te gjatë ka veshje e pasqyrlira Dhe drita jote e pastër është ende e venitur, ti vishu, Po një dorë do të zhveshë lakuriq përsëri

**UNË NUK TË DASHUROJ PA E PËRJASHTUAR QË TË DASHUROJ**

Unë nuk të dashuroj pa e përjashtuar që të dashuroj E filloj nga dashuria për të mos të dashuruar Nga pritja për të mos të prituri Nga akulli te zjarri vdes dhe ngjallet zemra ime Unë të dashuroj se je e vetmja që dashuroj

Unë të urrej si djalli dhe të urrej sërish Të përulëm dhe s'di si t'ia bëj me ndryshimet e dashurisë Më vret kjo që nuk di, po ama të dashuroj verbërisht

Ndoshta drita e janarit mund ta ngrijë Zemrën time mizorisht Me rreze të gjejë çelësin dhe të më vjedhë qetësinë

Në këtë pjesë të historisë unë jam i vetmi që Vdes, jam i vetmi që vdes nga dashuria sepse unë të dashuroj Sepse unë të dashuroj me dashuri zjarri dhe gjaku.

**KËNGA E DËSHPËRIMIT**

E humbëm dhe këtë muzg Askush nuk na pa të kapur për dore Ndërsa nata binte e kaltër mbi botë

Unë kam parë nga dritarja Diellin që perëndonte si një festë Mbi majat e maleve të largët

Nganjëherë dielli digjej si monedhë Në dorën time të hapur

Gjithmonë vuaj kur të kujtoj Prej një trishtimi që më duket se e ndien dhe ti

Ku je? Kush është ai tjetri me ty? Pse s'flet?

E gjithë dashuria shembet mbi mua pa mëshirë Sa herë jam i trishtuar dhe ti je larg prej meje

Libri më shket nga dora kur e mbyll në muzg Dhe trikoja blu më fërkohet te këmbët si një qen i lënduar

Gjithmonë e më tepër ti largohesh nëpër ndajnatën blu Drejt errësirës që zhduk statujat.

**VDEKJA E NGADALSHME**

Ai që nuk udhëton ai që nuk lexon ai që nuk dëgjon muzikë ai që nuk e gjen bukurinë në shpirt, vdes ngadalë

Ai që nuk ka besim te vetja ai që nuk i le të tjerët ta ndihmojnë ai që e kalon kohën duke u ankuar për fatin e mbrapshtë apo për shiun që fillon dhe s'mbaron kurrë, vdes ngadalë

Ai që bëhet rob i zakonit ai që ndjek rutinën e përditshme ai që ecën me po atë hap të zakonshëm ai që nuk rrezikon dhe nuk ndryshon ngjyrën e veshjes së tij ai që nuk flet dhe nuk përpiket të fitojë përvojë, vdes ngadalë

Ai ose ajo që i rri larg pasionit që pëlqen të zezën në të bardhë që gjykon ftohtë dhe s'njeh emocionin shtyp ndjenjën e fortë që i bën sytë të shkëlqejnë i hapet goja për gjumë kur duhet të buzëqeshë që nuk i rreh zemra prej gabimeve dhe ndjesive intime, vdes ngadalë

Ai ose ajo që nuk i bën gjërat rrëmujë që nuk ndjen pakënaqësi në punë

që nuk rrezikon sigurinë për hir të pasigurisë kur ndjek një ëndërr të bukur që nuk heq dorë nga këshilla e arsyeshme, të paktën një herë në jetë, vdes ngadalë

Ai ose ajo që braktis një projekt përpara se ta fillojë që nuk bën pyetje për tema që s'i njeh që nuk përgjigjet kur e pyesin për diçka që di, vdes ngadalë

Le ta shmangim vdekjen çdo ditë e nga pak duhen përpjekje të mëdha për të mbetur gjallë dhe kjo nuk është aq e thjeshtë sa një frymëmarrje lumturia është një durim i gjatë

### ÇDO DITË TI LUAN ME DRITËN E UNIVERSIT

Çdo ditë ti luan me dritën e universit Puth lule dhe ujëra Je më shumë se kjo kokë e bardhë që e mbaj Midis duarve si një tufë me lule

Ti ke humbur që ditën kur u dashuruam Më lejo të stolis me ty pemën e Krishtlindjes Kush shkruan emrin tënd në letra prej tymi Midis yjeve të jugut? Oh, lejomë të kujtoj siç ishe përpara se të lindje.

Papritur era fryn me gjëmë në dritaren time Qielli duket si një rrjetë e mbushur me peshq hije Këtu vijnë e shkojnë erërat, prej të gjitha viseve Dhe shiu zhvesh rrobat e tij

Dhe zogjtë vijnë e shkojnë diku Era. Dhe era gjithashtu Fillikat kam mbetur përballë marrëzisë njerëzore Stuhia shkund me rropamë gjetheet e errëta Dhe i kthen poshtë të gjitha varkat që ishin ancoruar Natën e fundit në qiell

Ti nuk ikën. Ti je këtu pranë meje. Këtu! Ti do të më përgjigjesh për klithmën e fundit Strukesh prej meje nga një frikë e çuditshme Një hije kalon në sytë e tu dhe zhduket

Tani, në këtë çast, ti shfaqesh me një dorëzonjë në dorë Aromën e saj kanë dhe gjinjtë e tu Dhe ndërsa era trishtueshëm shkon duke masakruar fluturat Lumturia ime kafshon kumbullën e gojës tënde; Të dua!

Kushedi sa shumë dhembje ke ndjerë që të bëheshe e zakonshme për mua Për shpirtin tim të egër, vetmitar Për emrin tim që kudo përhapte emrin tënd Sa herë kemi parë yllin e mëngjesit që digjej dhe shuhej Në sytë tanë si puthje Dhe dritën gri mbi kokat tona që kthehej në adhuruese

Fjalët e mia shkaktonin tek ty tronditje Sa shumë e kam dashur Nënë e diellit- perlën e trupit tënd Gjersa besova se ti ishe universi. Unë dua të sjell lumturinë e luleve të malit

Boronica, lajthi të egra, shporta fshatarësh të puthjeve Unë dua të bëj me ty atë që bën pranvera me qershinë e bardhë dhe të kuqe.

### ODE PËR NJË GRUA LAKURIQ QË TË MAGJEPS

Me zemrën e pastër që e mbaj në dorë sytë së pari të adhuroj gjakut që tërbohohet i vë fre prej këtu fillojnë linjat drithëruese si duke lulëzuar të formave të tua dhe ti shtrihesh në vargun tim si në pyll, apo në suvalën me shkumë; parfum i tokës tingull i detit

Bukuri lakuriqë këmbët e tua, kofshët se pari i prek zëri apo puhia e agut


Veshët e tu predha të vogla me spirale që tërheqin gjithë shkëlqimin e oqeanëve të Amerikës dy gjinjtë e tu të fryrë, të plotë, tundues mbytur në një shkëlqim verbues dhe krahët gjithashtu qepallat e tua pastaj prej mëndafshi të misrit blu që zbulojnë apo fshehin dy peizazhe të mistershëm të syve të tu.

Vija e shpinës të ndan ëmbëlsisht ajo bie ngadalë nga dëlirësia te epshi që ngrihet mbi dy hemisfera fërgëlluese të një molle pastaj hapet në dy shtylla bukuria e lakuriqësisë tënde molisëse prej ari të shkrirë, prej alabastrit virgjin dhe unë në dy kofshët e lëmuara mendjen humb se aty pikërisht aty ngrihet pema e dyfishtë dhe merr zjarr simetria; lulja e zjarrit flakërin, qirinjtë përçark ndizen prej mishit fruti i fryrë i ngritur mbi vijën rrëqethëse ku bashkohet toka me oqeanet e Amerikës

Kurmi yt, sdi prej çfarë substancash u krijua agate, kuarc, kallinj gruri që u mblodhën me duar, u mbrujtën, u ngritën si buka nga ngrohtësia dhe u shfaqën kodrat e argjenduara luginat prej hëne dhe petali ëmbëlsia magjepsëse, aq velëse me thellësi dhe butësi prej kadifeje gjer në formën më të përkryer të vijave dhe formave delikate fine të gruas dhe përsosmëria fle e zgjohet aty.

Nuk bën kaq shume dritë në botë kurmi yt ajo i ngjan shkëlqimit verbues të borës agonisë së saj kur shkrin duket sikur ti digjesh nga brenda

Nën lëkurën tënde është e gjallë hëna.



## BILL KLINTON: Besoj se “Njëqind vjet vetmi” është romani më i madh i shkruar që nga vdekja e Uiljam Folknerit

#### Libri që jam duke lexuar

“Fundit i gjithçkaje” i Katie Mack. Fizikania teoriciene shpjegon pesë mënyrat si mund të marrë fund universi ynë në zgjerim, me shpresë se do të jetë një kohë e paimaginueshme jashtëzakonisht larg nga tani. Është mendjempreshtë, e qartë dhe optimiste. Një shoqëruar i mirë i librit të Brian Greene-it “Deri në fund të kohës”. Po lexoj edhe “Mendje të mbyllura fort: si po na ndan fundamentalizmi i ri” i autorëve Gary Saul Morson dhe Morton O Schapiro, studim gjithëpërfshirës i rritjes së dogmatizmit në politikë, ekonomi dhe letërsi, i kërcënimit që krijohet për demokracinë, ndërkohë që nevojiten mendje të hapura dhe kompromis.

#### Libri që më ndryshoi jetën

“Mohimi i vdekjes” i Ernest Becker-it. Më bëri të rimendoja rrënjët e frikës dhe pasigurive tona më të thella dhe pse shpesh e zhgënjëm veten me mënyrën se si i shfaqim ato.

#### Libri që do të doja ta kisha shkruar

“Njëqind vjet vetmi” i Gabriel García Márquez-it. Vazhdoj të besoj se është romani më i madh i shkruar që nga vdekja e William Faulkner-it.

#### Libri që pati ndikimin më të madh në mënyrën si shkruaj

Gjithmonë kam dashur të bëhem shkrimtar, por dyshoja se kisha aftësinë time për ta bërë këtë. Nga viti i fundit në kolegji deri në vitin e parë në studimet për drejtësi, lexova pesë libra që më bënë të mendoj se ia vlen të provoja: “Në veri drejt shtëpisë” i Willie Morris-it; “Rrëfimet e Net Tërnerit” i William Styron-it; “Nuk mund të kthesh sërish në shtëpi” i Thomas Wolfe; “Zjarri herën tjetër” i James Baldwin-it; dhe “Unë e di pse këndon zogu i mbyllur në kafaz” i Maya Angelou-t.

#### Libri që më ndryshoi mendjen

Pyetje e shkëlqyer. Mendoj se “Kasta: gënjeshtra që na ndan” e Isabel Wilkerson -it dhe “Mendo përsëri” i Adam Grant-it më detyruan të rimendoj se sa thellë janë të ngulitura paragjykimet tona të pashqyrtuara, jo vetëm në lidhje me racën, gjininë, klasën dhe fenë, por me kategori që na bëjnë t'i shohim të tjerët si inferior, më pak të denjë për t'u parë dhe dëgjuar. Më pëlqen më shumë mënyra e pajtimit dhe përfshirjes përmirësuese e Nelson Mandelës.

#### Libri i fundit që më bëri të qaj

“Sooley” i John Grisham-it. Lexojeni, do të doni të qani edhe ju.

#### Libri i fundit që më bëri të qesh

Libri më i fundit i Janet Evanovich-it. Personazhi i Stephanie Plum-it më bën gjithmonë të qesh.

#### Libri që më vjen turp që nuk e kam lexuar

“Ulisi”. Më pëlqen poezia irlandeze, proza dhe librat joletrarë. E dua Joyce-in, por gjithmonë dorëzohem dhe heq dorë para se ta mbaroj leximin. Vazhdoj të përiqem.

#### Librat që i bëj dhurata

“Meditime” i Mark Aurelit; “Kura në Trojë” nga Seamus Heaney; dhe “pushtimi social i tokës” i EO Wilson-it. Në mënyra të ndryshme, secili është plot mençuri.

#### Libri për të cilin do të doja më shumë të mbahesha mend

Deri tani autobiografia ime “Jeta ime”, për arsyet që Larry McMurtry pohon në recensën e tij: është një histori e jetës dhe e kohëve të mia; një përshkrim se si është të jesh president kur ndodhin kaq shumë gjëra në të njëjtën kohë, me shpjegime më të plota të ngjarjeve të tilla si rrëzimi i helikopterit Black Hawk, të cilat nuk i gjeni askund tjetër; si dhe sepse është një testament i asaj që besoj dhe pse.

Marrë nga: Librat e jetës sime, *The Guardian*

Përktheu: Granit Zela

Në arkivin e Márquez-it në Universitetin e Teksasit ruhet romani i pabotuar i laureatit të çmimit "Nobel", *Shihemi në gusht* – një histori e rrëfyer nga perspektiva e një gruaje të pjekur, e cila synon të fitojë lirinë e saj, në subjektin e së cilës muzika dhe pajtimi me paraardhësit janë elementet dalluese të këtij testamenti letrar.

Çdo shkrimtar, sado i njohur apo me prestigj qoftë, është një artist i pakuptuar. Kur Márquez-i ishte 25 vjeç, një botues i njohur argjentinas, pasi lexoi romanin e tij të parë, *Gjethuhia*, e këshilloi të kërkonte profesion tjetër. Në vitin 1961, romani i tretë i Márquez-it, *Ora e ligë*, mori një çmim të madh letrar, vetëm pasi Márquez-i pranoi kushtet e episkopit që ishte në juri: të hiqte shprehjet e pacensuruara dhe të ndryshonte titullin e librit, i cili ishte *Este pueblo de mierda – Ky fshat muti*. Po ky roman ngjalli edhe më shumë zemërim kur botuesit e pandjeshëm e përkthyen në spanjisht në Spanjë, me gjithë ato palavirat. Madje, duke qenë i njohur, Márquez-i ndjeu hidhërimin e refuzimit: 15 korrik 1981. Një vit para se të merrte çmimin "Nobel" në letërsi, redaktorët e *New Yorker* e njoftuan se nuk do t'ia botonin tregimin *Gjurmët e gjakut tënd mbi dëborë*, sepse ai nuk mund "ta detyrojë lexuesin të pranojë konceptin e tij të guximshëm dhe të mrekullueshëm".

Në vitin 2004, kur askush nuk e vinte në dyshim pavdekësinë e veprës së tij, romani i tij *Shihemi në gusht* u dënua me heshtje, me sa duket nga mendimi i një personi të vetëm. Që nga viti 2014, pas vdekjes së García Márquez-it, ai roman i fundit dhe paksa i papërfunduar është mbajtur në një arkiv që shumë pak lexues mund t'i qasen. Do të doja të shpjegoja pse është urgjente, e drejtë dhe e nevojshme që më në fund të botohet *Shihemi në gusht* dhe t'i japë përkryerjen që meriton trashëgimisë së tij letrare.

### Ajo është bukuria vetë

Romani *Shihemi në gusht* rrëfen dhjetë Rvitet e jetës së Ana Magdalena Bach-ut, një grua e bukur dhe e pjekur, lumturisht e martuar dhe nënë e dy fëmijëve. Shtëpia e saj është e tejmbushur me muzikë dhe ajo është një lexuese e pangopur. Bashkëshorti i saj, i cili është drejtor i konservatorit publik, është pasardhësi i babait të Ana Magdalena-s në atë post. Edhe fëmijët e çiftit janë të prirë drejt muzikës. Djali i saj 21-vjeçar është violonçelisti i parë në orkestrën e qytetit. Micaela, vajza e saj, është 18 vjeçe, e ka emrin e gjyshes nga nëna, është e aftë të luajë çdo instrument dhe të mësojë çdo melodi me vesh, por është një qenie e lirë dhe këmbëngul që të bëhet murgeshë. Ata jetojnë në një vend në Karaibe..

Historia përqendrohet në atë çka ndodh çdo vit, në një datë të caktuar – 16 gusht, në përvjetorin e vdekjes së nënës së Ana Magdalena-s. Për arsye të pakuptueshme, nëna kishte kërkuar që ta varrosnin në një ishull fqinj, ku mund të shkoje vetëm me traget. Ishulli duket si një kthim nostalgjik në Kartagenë, ku autori i romanit përjetoi çaste vendimtare: atje është tregu publik ku ai kishte ndier që kishte rilindur, atje është një lagunë fantazmore, "e populluar nga shapkat të kaltra". E vendosur dhe mendjemprehtë, Ana Magdalena e mori lejen të bënte çdo vit një udhëtim, e vetme, që të çonte lule te varri i nënës. Kjo aventurë unikale larg familjes përfshinte në vetvete një natë në

# VETMIA E FJALËVE: NË MBROJTJE TË ROMANIT POSTUM TË G.G. MARQUEZ-IT

Të mos botohet "Shihemi në gusht", romani i fundit i vërtetë i García Márquez-it, është si të lëmë jashtë – pa u kujdesur fare – kapitullin e fundit të "Njëqind vjet vetmi".

Nga Gustavo Arango, autor kolumbian

hotel, e vetme, zonjë absolute e kohës dhe sjelljes së saj.

### Fati i romanit

Dorëshkrimi i romanit *Shihemi në gusht* ndodhet në Harry Ransom Center të Universitetit të Teksasit, në Austin. Është pjesë e një thesari të madh dorëshkrimesh, dokumentesh personale, fotografish dhe letrash të blera në vitin 2014 nga familja e García Márquez-it. Së bashku me versionin më të fundit të romanit dhe bocat e disa kapitujve, është raporti i një profesori të porositur nga Agjencia Letrare "Carmen Balcells". Fati i veprës duket se është vulosur me atë opinion, që shërbeu si referencë për familjen e García Márquez-it për të vendosur që romani të mos botohej. Me një arrogancë që tradhton papërvojën e tij, autori i raportit ofron një sintezë të varfër të historisë. I vetëdijshëm se nuk mund të jetë plotësisht shpërfillës, ai i lejon vetes të lavdërojë si një detaj fatlum të subjektit faktin që Ana Magdalena hidhet në pabesinë e saj periodike, pavarësisht se ka një marrëdhënie të lumtur me burrin e saj. Bën një lavdërim të vakët dhe formal për stilin. Aty përmendet jehona e tregimit të Edgar Allan Poe, *Zemër tradhtare*, në pasazhin ku ndjenja e fajit duket se e shtyn protagonistin të zbulojë sekretin e saj. Por ai heq çdo mundësi botimi, kur e cilëson romanin si një histori të përsëritur dhe të zgjatur. Cektësia e tij vihet re më shumë kur mendon se *Shihemi në gusht* është një roman inferior ndaj *Kujtim kurvash të trishta*. Në raportin e tij ai nuk përmend asnjë roman tjetër të García Márquez-it dhe nga mënyra se si ai shpërfill rezonancat që ekzistojnë në të, mund të dyshohet nëse ai i njihte ato.

Le të jemi të qartë, as *Kujtim kurvash të trishta* dhe as *Shihemi në gusht* nuk janë romane të barabarta me kryeveprat e García Márquez-it. Nuk mund t'i krahasojmë me *Njëqind vjet vetmi*, *Vjeshtën e patriarkut* apo *Dashurinë në kohërat e kolerës*. Por këto romane të vogla janë fjalët e fundit të një autori që fitoi dhe meritoi respektin dhe vëmendjen tonë. Për më tepër, duke heshtur për përpjekjen e tij të fundit letrare, ne po e pamundësojmë García Márquez-in që



t'i japë karrierës së tij letrare një mbyllje dinjitoze dhe koherente.

Kujtimi i kurvave të mia të trishtuara është një homazh nostalgjik për kohën që García Márquez-i jetoi në Barranquilla në fillim të viteve 1950. Në të ai imagjinonte atë monopol respekti që do ta kishte arritur nëse nuk do të kishte ndjekur atë fatin endacak që e çoi së pari në Bogota, pastaj në Romë, Paris, Karakas, Havanë, Nju-Jork, Barcelonë dhe në Mexico City, që ishte shtëpia e tij për më shumë se gjysmë shekulli. Romani i tij i fundit i botuar deri më tani është plot merita. Referencat e tij letrare këmbëngulin të na tregojnë dashurinë dhe respektin që García Márquez-i kishte për letërsinë mesjetare spanjolle dhe Epokën e Artë që në moshë shumë të re. Është gjithashtu një homazh për romanin e Yasunari Kawabata, *Shtëpia e bukurosheve të fjetura*. Imazhi i virgjëreshës së fjetur është trashëgimtar i traditës së dashurisë trubadure. Por ky vampir mbi nëntëdhjetëvjeçar – që ushqehet me rininë dhe bukurinë – nuk ishte imazhi përfundimtar me të cilin García Márquez-i donte të mbyllte karrierën e tij letrare. Këtu qëndron rëndësia e *Shihemi në gusht*. Të heqësh dorë nga romani i fundit i vërtetë i García Márquez-it është si të lëmë jashtë – pa u kujdesur fare – kapitullin e fundit të *Njëqind vjet vetmi*.

Merita më e madhe e *Shihemi në gusht* është se për herë të parë García Márquez-i guxon të bëjë një grua personazhin kryesor të romanit të tij. Pas botimit të *Njëqind vjet vetmi*, studiuesit e veprës

së tij kanë theksuar kompleksitetin dhe qëndrueshmërinë e personazheve të tij femra. García Márquez-i ka thënë se nuk kishte qenë në dijeni të kësaj aftësie të tij deri atëherë dhe ia atribuoi atë faktit se e kishte kaluar fëmijërinë e tij të hershme në një botë grash, ku figura e vetme mashkullore ishte gjyshi i tij, koloneli Nicolás Márquez. Siç e dimë, nga gjyshja e tij Tranquilina Iguarán ai trashëgoi tonin e pasionit të largët me të cilin rrëfohen ngjarjet e jashtëzakonshme të *Njëqind vjet vetmi*. Me kalimin e kohës, García Márquez-i do të zhvillonte një marrëdhënie shumë të ngushtë me nënën e tij, Luisa Santiaga Márquez. Gruaja e tij, Mercedes Barcha, ishte edhe mbështetje edhe frymëzim. Në shumë raste García Márquez-i ka deklaruar se ndihej më rehat në shoqërinë e grave. Por lëndat që mori për personazhet femra në *Njëqind vjet vetmi* patën një efekt paralizues tek ai. Sikundër do ta pranonte më vonë, që nga ai moment, e pati më të vështirë të shkruante për gratë.

Vështirësia është e dukshme. Përveç somnambulës Eréndira, grave në veprat e García Márquez-it u mungon peshja e Úrsula Iguarán-it, Amaranta Buendía-s ose Pilar Ternera-s. Leticia Nazareno nga *Vjeshta e Patriarkut* tretet në disa faqe. Ángela Vicario e *Kronika e një vdekjeje të shpallur* është e heshtur dhe sekreti i saj mbetet i paarritshëm. Fermina Daza te *Dashuria në kohërat e kolerës*, Sierva María te *Nga dashuria dhe të tjerë djaj ose Delgadina nga Kujtim kurvash të trishta* janë pak më shumë se pjesë dekorative.

Heshtja për romanin *Shihemi në gusht* ka qenë, pjesërisht, për faktin se vepra e García Márquez-it ka qenë objekt i sulmeve nga një klan kritikësh që vepron si një lloj policie morale. Mungesa e *Shihemi në gusht* në korpusin e veprës së tij ka bërë që García Márquez-i të skualifikohet si përfaqësues i një tradite seksiste që duhet çrrënjësuar. Vetëm në këtë roman të shkruar në muzg e fuqisë së tij krijuese, García Márquez-i guxoi të mishëronte plotësisht një personazh femër: një grua e pjekur që arrin të arratiset nga burgu familjar dhe shoqëror për t'u bërë zot i trupit dhe lirisë së saj.

*Shihemi në gusht* dëshmon plasticitetin e gjuhës së García Márquez-it në fund të karrierës së tij krijuese. Është gjithashtu

një homazh për muzikën. Mbiemri i protagonistes na kujton kompozitorin (S. Bach), veprën e të cilit García Márquez-i thoshte se do ta çonte në ishullin e shkretë. Siç ndodh zakonisht për autorin kolumbian, romani është i mbushur me përvoja personale të kodifikuara dhe është i begatë me homazhe letrare. Rrëfyesi bën një inventar të plotë të leximeve të protagonistes në udhëtimet e saj në ishull. Referenca për Drakulën është një homazh për një nga romanet e preferuara të García Márquez-it (tjetri është *Konti i Monte Kristos*). Në kohën kur ndodh historia, pas leximit të *Ministria e frikës* nga Graham Greene, Ana Magdalena i përkushtohet leximit të letërsisë fantastike. Një detaj zbulues i romanit është ajo referencë për *Kronikat marsiane* nga Ray Bradbury. Historia e shkurtër e Bradbury-t, *Nata e verës*, është një homazh për natyrën misterioze – të pakuptueshme – të poezisë.

Ai përshkruan, me imazhe spektrale që duket se janë derdhur në romanin e García Márquez-it, aventurën e një poezie të Lord Bajronit (*Ajo është bukuri vetë*), të cilën banorët e Marsit e përsërisin të magjepsur pa e ditur origjinën apo kuptimin e saj. Personazhet në historinë e Bradbury-t kanë, si Ana Magdalena, sy të verdhëm. Poema e Bajronit, në njëfarë mënyre, është një përshkrim i asaj gruaje në të cilën “më e mira nga drita dhe hijet bashkohen në pamjen dhe në sytë e saj”.

Botimi me gjasë i *Shihemi në gusht* nuk do të thotë se nuk do të kritikohet. Asnjë libër nuk u shpëton pyetjeve. Kur u shfaq *Njëqind vjet vetmi*, dikush tha se ishte thjesht një plagjiaturë e *Në kërkim të absolutes* të Balzakut. Do të gjendet dikush të thotë se çdo përpjekje e një burri për të krijuar një personazh femëror është një gjest fyes dhe patriarkal. Erotizmi letrar është një shpat i rrëshqitshëm dhe duhet të presim se si do të kritikohen takimet e Ana Magdalena-s me të dashurit e saj.

Është një akt drejtësie që vepra García Márquez-it të mbyllet me një perspektivë femërore. Vendimi për të mos botuar romanin iu paraqit publikut si një provë e interesit të vogël të familjes së tij për të nxjerrë lehtësisht fitime nga trashëgimia e tij. Romani u cilësua si një vepër e papërfunduar që nuk i përshtatej pjesës tjetër të veprës së autorit. Por kjo mungesë e interesit për të përfutur nga trashëgimia e tij bie në kundërshtim me vendimin që romani *Njëqind vjet vetmi* të bëhet film.

Nëse bien në një mendje se në fund të jetës së tij García Márquez-i ishte më fleksibël me atë vendosmëri, pse të mos respektohen edhe fjalët e fundit që shkroi? Është e vërtetë që romani nuk ka pasur kurrë një version përfundimtar, por është fakt që García Márquez-i arriti ta përfundonte atë. Drafti i parë i kapitullit të fundit na tregon një njeri që lufton me forcat e fundit krijuese që i kishin mbetur. Është e mundur të përfytyrohet vështirësia e jashtëzakonshme me të cilën ai arriti të kapërcejë pengesat prej moshës së tij dhe shterimi ditë pas dite i aftësive të tij. Energjia e braktisi atë në stadin e fundit të procesit dhe ai nuk qe më në gjendje të mbronte librin e tij për sa kohë nuk u botua. Por përpjekjet e tij meritojnë respektin tonë. Pa ndonjë vështirësi kushedi dhe me ndërhyrje minimale, një redaktor dashamirës – i cili e njeh dhe vlerëson veprën e García Márquez-it – mund ta përfundojë atë punë. Pavarësisht se sa shumë ndryshime dhe tradhti mund të ketë, ato kurrë nuk do të jenë aq të shumta apo aq për të ardhur

keq sa koloneli Aureliano Buendía apo Remedios la Bella që do të kenë fytyrat e aktorëve të famshëm.


### Pasqyra e vdekjes

Përmbyllja *Shihemi në gusht* është ndoshta arsyeja kryesore pse romani duhet të botohet. Është shumë më domethënëse, për veprën e García Márquez-it në tërësi, që puna e tij kulmon me atë ribashkim me nënën e tij që është, në të njëjtën kohë, një reflektim mbi vdekjen dhe mbi privilegjin misterioz të të qenit gjallë. Në *Kujtim kurvash të trishta* personazhi që njerëzit e njohin si Mustio Collado nuk ka asnjë lidhje të vërtetë me paraardhësit e tij, ai është në thelb një karikaturë. Përveç tragjedisë së largët që përfundon *Nga dashuria dhe të tjerë djaj*, García Márquez-i u përpoq të injoronte vdekjen – gjithnjë e më reale dhe më afër tij – dhe vendosi t'i jepte fund të hapur dhe të lumtur *Dashurisë në kohën e kolerës* dhe *Kujtim kurvash të trishta*. Por *Shihemi në gusht* përfundon me sytë tanë të drejtuar kah vdekja, përtej, nga ku na shikojnë të vdekurit. Nuk do të ishte çudi nëse e ardhmja do të vinte për ta gjykuar atë pasazh të fundit të romanit si një nga më të mrekullueshmit në veprën e tij, kur Ana Magdalena (me emrin e saj bibliq) e sheh veten të pasqyruar në kufomën e nënës së saj dhe kupton fatin e tyre të përbashkët.

Kujdestari dhe varrmihësi e nxorën arkivolin dhe e hapën pa mëshirë. Në arkivolin e hapur, si në një pasqyrë, Ana Magdalena më pas e pa veten në krejt shtatin, me një buzëqeshje të akullt dhe krahët e kryqëzuar mbi gjoks. Dukej identike dhe po me atë moshë, si atë ditë, me vellon dhe kurorën me të cilën ishte bërë nuse, diademën e smeraldit dhe unazat e martesës, siç e kishte rregulluar nëna e saj me frymën e fundit. Jo vetëm që e pa ashtu siç ishte në jetë, me të njëjtin trishtim të pangushëllueshëm, por ajo ndjeu që e ëma po e shihte që nga vdekja, e dashur dhe e vajtuar prej saj, derisa trupi u copëtua në pluhurin përfundimisht dhe vetëm kockat e ngrëna nga krimbat mbetën, të cilat varrosësit i pastruan me fshesë dhe pa mëshirë i futën në qese.

Në fillim të atij mozaiku mrekullish të *Njëqind vjet vetmi*, ka një imazh të fuqishëm që dridhet dhe ne nxitojmë ta harrojmë, sepse mbajtja e tij në mendje është e padurueshme. Një vajzë e vogël mbërrin në shtëpinë e Buendía-s duke mbajtur eshtrat e prindërve të saj në një qese pëlhure. Është Rebeka, ajo që sjell me vete edhe murtagjen e harresës. Nga ai roman, shumica prej nesh, lexuesve, preferojnë të kujtojnë fluturat e verdha të lehta dhe larmingjyrëshe të Mauricio Babilonia-s ose peshkun e vogël prej floriri të kolonelit plak Aureliano Buendía. Në fund të rrugës, García Márquez-i donte t'i kthehej imazhit të asaj qeseje me kocka që të gjithë e tërheqim zvarrë. Ana Magdalena Bach-u, protagonistja e *Shihemi në gusht*, mbledh pelena dhe një qefin kur ribashkohet me kufomën e nënës së saj të vdekur. Ky ishte imazhi i zgjedhur nga García Márquez-i, mesazhi kumbues me të cilin ai donte t'i jepte fund karrierës së tij prej shkrimtari.

Marrëdhëniet e García Márquez-it me nënën e tij ishin të ngushta. Luisa Santiaga Márquez-i nuk ishte vetëm një ndërmjetëse me babain e tij, i cili e kishte të vështirë të pranonte që djali i tij braktisi karrierën si avokat për t'u bërë



shkrimtar (“Letër do të hash”, - i kishte deklaruar i ati, Gabriel Eligio García). Përpara se t'i nënshtrohej po asaj harrese, që do të mbërrinte edhe te djali i saj, Luisa Santiaga ishte një nga lexueset më të vëmendshme të librave të tij, qoftë edhe e indinjuar nga mënyra e tij e përshkrimit të të afërmeve dhe të njohurve. Shkrimtari e ndiente se prej saj kishte trashëguar qëndrimin largpamës, që e ndihmoi të lundronte dhe të gjente drejtimin në jetën dhe veprën e tij. Luisa Santiaga ishte madje ruajtësja e kujtimeve dhe shpirtit të tij. Një nga xhevahiret më të çmuara në arkivin e García Márquez-it në Teksas është një letër që nëna e tij i shkroi García Márquez-it më 7 mars 1983:

Gabito: Sot e prita telefonatën tënde më shumë se kurrë. Sepse sot është ditëlindja jote (e diel), si dita kur ke lindur në 9 të mëngjesit. Mendoj se nuk ke mundur të më thirrësh ose nuk ke qenë në Meksikë. Ja, uroj që Zoti të dhëntë shumë vite jetë, të kesh gëzimin të shohësh fëmijët e tu siç i shoh unë të mitë, por unë tashmë kam dhe nipër. Po të them që e lexova rubrikën e djeshme, më pëlqeu aq shumë sa, pa të gënjer, ndihem aq e lumtur dhe krenare, madje më shumë se me çmimin “Nobel” që more. Mbjaj mend një ditë, shumë vite më parë, duke folur me ty, t'u ankova se ti nuk ishe katoliku që unë doja të ishe. Atëherë më the se në jetën tjetër do ta kuptosh kur të më shohësh në pozicionin apo vendin ku Zoti më deshi. Do ta shohësh. Koha u kujdes që të më bindte për këtë. Unë i ndjek hap pas hapi veprimet e tua dhe besoj se nëse vazhdon kështu nuk ka dyshim se Zoti e shpërblen virtytin e dhembshurisë.

Gjëja që e bëri më të lumtur Luisa Santiaga-n se çmimi “Nobel” ishte audienca private me Papën, të cilën García Márquez-i e përmendi me rastin e vizitës

së Gjon Palit II në Amerikën Qendrore. Ndoshta në asnjë pjesë tjetër të veprës së tij, si në tre paragrafët e asaj rubrike të marsit 1983, fjala Zot nuk shfaqet kaq shumë herë.

García Márquez-i donte që romani i tij i fundit të ishte një dialog sekret me nënën e tij. Ai zgjodhi një grua për ta bërë këtë, sepse donte të festonte gjithçka që ishte brenda tij. Ai gjithashtu donte të shprehte pranimin e qetë të vdekjes dhe gatishmërinë e tij për të bërë hapin drejt jetës së përtejme.

Dy orë më vonë, Ana Magdalena i hodhi një vështrim të fundit dhembshurie së kaluarës së saj dhe një lamtumirë përgjithmonë të panjohurve të një nate dhe orët e shumta të ngurrimit që mbetën prej saj të shpërndara në ishull. Deti ishte si një oazë e artë nën diellin e pasdites. Në orën gjashtë, kur i shoqi e pa atë të hynte në shtëpi, duke tërhequr në mënyrë misterioze qesen me eshtra, nuk i rezistoi dot habisë.

“Kjo është ajo që ka mbetur nga nëna ime”, - i tha ajo dhe parashikoi tmerrin e tij. - “Mos ki frikë, ajo e kupton. Për më tepër, mendoj se ajo është e vetmja që e kishte kuptuar tashmë që kur vendosi të varrosej në ishull”.

Më i madhi nga 16 fëmijët e telegrafistit Arakataca-s dhe gruas së tij të devotshme e largpamëse e kaloi jetën duke reflektuar mbi vetminë dhe zbuloi se zgjidhja dhe përgjigjja e kësaj enigme gjendej në dashuri. Duke kërkuar dhe pyetur për dashurinë, ai u bë shkrimtari më i famshëm i kohës së tij. Ironia e historisë është se fjalëve të tij të fundit u është mohuar dashuria dhe për momentin, ato mbeten të dënuara me një fat heshtjeje dhe vetmie.

E përktheu Bujar Hudhri

Romani i panjohur i Markezit do të botohet  
në të gjithë botën, në të njëjtën ditë: 6 mars 2024

